

# HEJZA

Lazër Stani, shkrimtar

**KULTURA SHQIPTARE UNIKE DHE E PËRBASHKUAR NË  
GJUHËN SHQIPE**

Nën thjerrë

# KULTURA THEMEL I ÇDO SHOQËRIE

**Ndërsa prioritetet e qeverisë favorizojnë projekte infrastrukturore si interes i përgjithshëm, shqiptarët duhet të luftojnë për të siguruar që kultura e tyre të ketë vendin e merituar**

## Nga Avni HALIMI

Pushteti aktual në RMV (VMRO-VLEN-ZNAM) do të mbahet mend si ndër pushtetet e pakta në botë që "fitoren politike" do ta festojë me kredi (hungareze, prej 500 milionë euro). Qeveria ka vendosur që gjysma e kësaj kredie të shpenzohet për 274 projekte nga komunat e vendit. Tashmë dihen edhe fituesit si dhe projekteve të cilat, që të gjitha i përkasin zhvillimit komunal infrastrukturor. Kjo nishtë, e cila për herë të parë përfshin edhe komunat e drejtuara nga shqiptarët, është një hap i rëndësishëm në drejtim të barazisë rajonale. Megjithatë, një vërejtje e dukshme është se asnjë projekt i propozuar nga këto komuna nuk përfshin asnjë iniciativë për zhvillimin e kulturës. Ky anashkalim i qartë i nevojave kulturore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut ngrida pyetje të rëndësishme mbi vetëdijen kulturore dhe prioritetizimin e vlerave në shoqëri. Natyrisht, kjo është hileja e dytë shtetërore që u bëhet shqiptarëve.

## Fekalet që "vërshojnë" identitetin kulturor

Hileja e parë konsiston në vendimin e decentralizimit të kulturës, që do të thotë se me të gjitha qendrat dhe institucionet kulturore do të menaxhojnë vetë komunat ku shtrihen këto qendra! E sa qendra të tilla kulturore shtrihen në komunat që menaxhohen nga shqiptarët e RMV-së? Mbi 70 për qind e komunave shqiptare nuk kanë asnjë institucion kulturor në territorin e vet, ndërsa në komunat maqedonase ka edhe fshatra që kanë shtëpi të kulturës e muze të ndryshëm! Hileja e dytë konsiston në ndihmën qeveritare për rrugë e kanalizime komunale! Standardi jetësor është çështje e pushtetit qendror dhe jo e komunave, aq më pak e komunave rurale! Komunat shqiptare ekzistojnë tash e dy dekada, ndërsa vendbanimet shqiptare ekzistojnë edhe para se të krijohet shtet Maqedonia e Veriut. Se pse janë në kushte primitive edhe më tej komunat shqiptare, kjo e metë nuk mund t'i përshkruhet pushtetit lokal dhe tejkalimi i këtyre kushteve nuk duhet të lihet në duar të pushtetit lokal. Në tërë botën, segmente të caktuara jetësore lihen në kompetenca komunale, komunat i mirëmbajnë dhe ngrënë iniciativa e projekte për përmirësim të jetës, ndërsa shtrimi dhe zhvillimi i tyre mbetet barrë e buxhetit shtetëror. Historikisht, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë përballur me sfida të vazhdueshme në ruajtjen e identitetit të tyre kulturor. Edhe pse përfaqësimi i shqiptarëve është rritur në institucione, sfidat e vjetra si, marginalizimi dhe anashkalimi, vazhdojnë të ndikojnë në jetën e përditshme. Komunat që drejtohen nga shqiptarët, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar infrastrukturën, shpesh kanë lënë pas nevojat për zhvillimin e qendrave kulturore. Ndërsa komuna maqedonase shpesh kanë ndërtuar qendra kulturore, institucione dhe aktivitete që promovojnë trashëgiminë e tyre, shqiptarët ende nuk kanë një strukturë të tillë, përveç disa përjashtimeve. Kjo është një pasqyrë e qartë e një problemi më të thellë: mungesa e investimeve dhe prioritetit për kulturën shqiptare.

Komuna e Çairit, dikur mushkëria e qytetit të Shkupit, që shtrihet në zemër të

këtij qyteti, ndeshet me probleme të atilla të cilat në komunat maqedonase janë tejkaluar më se gjysmë shekulli më parë. Sipas kryetarit të kësaj komune, Çairi do të marrë rreth 2.8 milion euro, të cilat do të shpenzohen për rikonstruimin e ujësjellësit dhe kanalizimit fekal në lagjen e Dizhonit, po ashtu për rikonstruimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit fekal dhe atmosferik në rrugën Kovačka në lagjen e Sauk Çeshmës, etj. Nuk ka projektet që do ta shpluhurosin identitetin kulturor të shqiptarëve të kësaj Komune!

Shqiptarët që drejtojnë komunat e tyre ndodhen në një situatë delikate, ku shpesh ndihen të detyruar të prioritetizojnë projekte që sjellin përfitime të menjëhershme ekonomike. Kjo, natyrisht, është e kuptueshme në një kontekst ku shumë komuna përballen me nevoja themelore si rrugë, ujë dhe energji. Megjithatë, ky fokus i ngushtë në infrastrukturë po lë pas një aspekt thelbësor të identitetit dhe zhvillimit: kulturën. Te pushteti qendror ka një frikë të brendshme për të kërkuar dhe investuar në kulturë, të pala maqedonase ndoshta për shkak të besimit se kjo do të përshpejtoje ngritjen kulturore të shqiptarëve, ndërsa te shqiptarët se do të përjashtohen nga mundësitë për financim dhe mbështetje. Ndërsa prioritetet e qeverisë favorizojnë projekte infrastrukturore si interes i përgjithshëm, shqiptarët duhet të luftojnë për të siguruar që kultura e tyre të ketë vendin e merituar. Anashkalimi i kulturës është një temë që kërkon reflektim të thellë. Kultura është themeli i çdo shoqërie; ajo është ajo që formon identitetin dhe bashkëpunimin e një populli. Nëse shqiptarët në Maqedoninë e Veriut dëshirojnë të ruajnë identitetin e tyre dhe të zhvillojnë një shoqëri të qëndrueshme, ata duhet të kërkojnë me ngulim investime në kulturë, art dhe tradita. Është e domosdoshme që përfaqësuesit e komunitetit shqiptar të krijojnë një platformë ku kultura të jetë në qendër të vëmendjes. Kjo do të thotë të promovohen projekte që mbështesin artistët lokalë, të krijohen qendra kulturore dhe të organizohen aktivitete që nxisin ndërveprimin kulturor.

## Strategji për përkrahje ndërkombëtare në diskriminim kulturor

Qeveria e Maqedonisë së Veriut, e

mbështetur nga UNDP-ja dhe gjithë agjencitë e OKB-së, nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministrisë së Financave në Republikën e Sllovakisë, paska hartuar Strategjinë Nacionale për Zhvillim për periudhën 2024-2044, e cila, me 70 vota "për" u miratua edhe nga Kuvendi Republikan. Ky dokument i rëndësishëm, i aprovuar me konsensus politik, përcakton vizionin për zhvillimin nacional të vendit për dy dekadat e ardhshme. Strategjia në fjalë fokusohet në tre objektiva të mëdha: forcimin e konkurrencës ekonomike, transparencën e qeverisjes dhe përmirësimin e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore për gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Natyrisht, as ky dokument shumë i rëndësishëm nuk parashihet në asnjë paragraf zhvillimin institucional kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Sepse, në këtë fushë subjektet politike shqiptare janë pa vizion, janë të pafuqishëm për ta konceptuar identitetin kulturor dhe pa kurrfarë tagri për avancimin institucional të kulturës kombëtare të shqiptarëve të këtij shteti. Asnjë shqetësim partiak, asnjë iniciativë partiake, asnjë reagim dhe ankesë nga asnjë parti shqiptare nuk pati deri më sot në drejtim të institucionalizimit kulturor të shqiptarëve të këtushëm!

Asnjë aktivitet politik për t'ua bërë me dije edhe ndërkombëtarëve se, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, aspak nuk janë të kënaqur me statusin kulturor diskriminues i cili as për së afërmi nuk korrespondon me identitetin e vërtetë kulturor të shqiptarëve bazuar në trashëgiminë kulturore e shpirtërore mijëra vjeçare. Si rezultat i kësaj injorance, apo, thënë më butë, i qëndrimit nonshalant të të gjitha partive shqiptare për sa i përket jetës kulturore institucionale, është edhe kjo Strategjia Nacionale Zhvillimore, e cila, qëllimisht anashkalon shtyllën e civilizimit nacional, kulturën, sepse, kësisoj, nuk do të motivohen shqiptarët për të kërkuar pjesën e tyre për sa i përket zhvillimit kulturor. Pra, nuk ka as për kulturën maqedonase, sepse, ndryshe, do të kishte edhe për kulturën shqiptare! Kësisoj, me strategji dhe me përkrahje ndërkombëtare arrihet në heshtje deri te diskriminimi dhe mohimi i identitetit kulturor shqiptar. Kur një dokument kaq i rëndësishëm nuk adreson nevojat e një

pjesë të konsiderueshme të popullsisë, kjo nënkupton se ato janë përjashtuar nga proceset vendimmarrëse. Natyrisht kjo mundësohet edhe me pasivitetin absolut të subjekteve tona partiake si dhe me heshtjen e pakuptimtë të "elitës" shqiptare. Kjo pastaj shtrihet pyetje mbi efektivitetin dhe angazhimin e tyre në mbrojtjen e interesave të komunitetit që përfaqësojnë. A është ky një reflektim i dobësive brenda strukturave politike shqiptare, apo është një çështje e negociatave më të gjera ku kërkesat kulturore zëvendësohen me interesa të tjera? A mjafton të ngremë pluhur vetëm për zyrtarizimin e gjuhës shqipe dhe, nëse arrihet kjo, kemi kapur majat e kulturës kombëtare?

## Zhvillimi kulturor çelës i sukseseve të një shoqërie

Pa dyshim, një strategji zhvillimi duhet të jetë inkluzive, e cila merr parasysh diversitetin kulturor dhe etnik të vendit. Pa një qasje të tillë, zhvillimi ekonomik dhe social mund të arrijë rezultate të kufizuara, pasi do të përjashtojë një pjesë të popullsisë nga përfitimet e tij. Një zhvillim i qëndrueshëm kërkon harmonizimin e të gjitha kulturave dhe integrimin e tyre në narrativën nacionale. Është nevojë imediate dhe e patejkalueshme një reformë gjithëpërfshirëse që do të çojë në një njohje më të madhe të diversitetit kulturor, duke përfshirë një angazhim më të madh nga qeveria për të mbështetur institucionet kulturore shqiptare. Një qasje kritike duhet të nxjerrë në pah nevojën për një dialog të hapur dhe të vazhdueshëm mes grupeve etnike, duke përmirësuar kështu marrëdhëniet dhe besimin ndërmjet tyre.

Me qëllim që mos të na ndodhin strategji të tilla nacionale për hartimin e të cilave shqiptarët as që përfillen, duhet patjetër që të shprehim pakënaqësitë dhe shqetësimet tona përmes kanaleve të duhura dhe të angazhohemi për një të ardhme më të barabartë dhe përfshirëse për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një shoqërie më të bashkuar, ku çdo kulturë është e njohur dhe e respektuar. Duke e kalitur respektin e ndërsjellë pa dyshim që edhe mirëqenia dhe zhvillimi ekonomik, social e arsimor do të jenë më lehtë të arritshme.



Letër nga diaspora

# POROSIA E MADHE E MITRUSH KUTELIT

**Kutelit kërkoi që e mira të triumfojë mbi të keqen, e vërteta mbi gënjeshtren, dashuria mbi urrejtjen...**

**Neviana SHEHI/ Itali**

Në letrën e fundit për të shoqen, i madhi Mitrush Kuteli, kishte një porosi edhe për fëmijët e tij: "Të doni njëri tjetrin, të ndihmoni njëri tjetrin, të duroni njëri tjetrin! Mos vini re vogëlsirat, mos u grindni për vogëlsira, për asgjë. Hithni tutje inatin, se ay është burim i shumë të këqijave. Përpiqi të mos ju rritet mëndja. Inati dhe mendjemadhësia na kanë bërë dëme të mëdha. Na prishnë. Zemra juaj të mos njohë urrejtjen, grindjen, mërinë. Urtësi, butësi, zemërgjërësi! Hapni sytë për çdo hap që bëni në jetë. Jeta mund të priset nga një hap i gabuar, vetëm nga një hap. Pastaj vinë greminat. Kur t'ju vijë koha, martohuni. Të dëgjoni zërin e zemrës, po edhe të arësyes. Shpesh, zemra të shpje në udhë të gabuar, në goftë se nuk e drejton arësyeja. Mos i kërkoni shumë jetës, sepse jeta është koprace në mirësi. Mos ëndëroni ato që nuk realizohen dot. Mos u matni me hijen e mëngjezit, që sjell mendjemadhësinë. Do t'i kërkoni jetës aq sa mund t'ju japë".

Kjo porosi e madhe e Kutelit është shenjë e një njeriu që pati një shpirt të veçantë, që gjithmonë kërkoi e mira të triumfojë mbi të keqen, e vërteta mbi gënjeshtren, dashuria mbi urrejtjen. Kuteli do të



mbetet një nga figurat më të shquara të letrave shqipe, një nga themeluesit e prozës moderne, përkthyes dhe kritik. Ndonëse ishte ekspert ekonomie, ai u shqua më shumë si personalitet i letrave, të cilat ndikuan në fisnikërimin e shpirtit të tij aq bujar, siç e shohim në pjesën e letrës së mësipërme drejtuar katër fëmijëve të tij.

Kjo qartë tregon se çfarë ndikimi

pati letërsia në formimin e tij prej një intelektualit të rrallë në galerinë e personaliteteve më të shquara të kombit tonë. Në thelb, letërsia na ndihmon të bëhemi më të pasur shpirtërisht, më të informuar dhe më të ndërgjegjshëm për botën që na rrethon. Ajo është një mjet i fuqishëm për zhvillimin personal dhe shoqëror. Dhe pikërisht kjo u dëshmuar në rastin e Kutelit, i cili

pavarësisht kalvarit nëpër të cilin kaloi, insistoi që zemra mos ta njohë urrejtje, mërinë, duke këmbëngulur në butësi e urtësi. Duke trajtuar temat universale si dashuria, humbja, lufta, drejtësia, dhe liria, letërsia krijon një ndjesi të përbashkët humanizmi. Lexuesit ndihen të lidhur nëpërmjet ndjenjave dhe përvojave që përcjellin librat, dhe kjo ndihmon në shtimin e empatisë dhe mirëkuptimit ndaj të tjerëve. Në fund të fundit, letërsia na tregon që, pavarësisht dallimeve, jemi të gjithë pjesë e të njëjtit rrëfim njerëzor, duke na çuar përtej realitetit tonë të përditshëm dhe duke na ndihmuar të imagjinojmë një botë të mirë me përvoja të ndryshme. Pra, duke qenë pranë librit, ne sado pak reflektojmë mbi vetveten, vlerat dhe qëllimet tona. Letërsia mund të na frymëzojë të rishikojmë përvojat tona dhe të kuptojmë më mirë mendimet dhe ndjenjat tona. Meqë dinte disa gjuhë, Kuteli ishte njohës i shkëlqyer i letërsisë botërore, gjë që është mbase e natyrshme të konstatojmë se edhe kjo njohje do të ketë ndikuar dukshëm në fisnikërimin dhe madhësinë e tij shpirtërore. Një shembull që duhet të na ndihmojë edhe neve në dinamikën e përditshmërisë sonë, e cila po bëhet më e mbyllur, më nihiliste dhe më tjetërsuese...

Ana tjetër e medaljes

## SARTRI DHE NOBELI

**Sartri i shpjegoi opinionit botëror se vendimi i tij nuk ishte thjesht një "lëvizje impulsive". Fakti që nuk pranoi "Nobelin" erdhi nga zakoni i tij i jetës për të refuzuar të gjitha nderimet zyrtare**

**Grigor JOVANI**

Nuk di të ketë ndonjë çmim tjetër në botë, që të ketë pjellur një begati të tillë mosmarrëveshesh, dyshimesh dhe kundërshtimesh. Dhe të mendosh se ka një jetëgjatësi relativisht të shkurtër, për përmasat e tij, njëqind e ca vite. Për herë të parë u akordua në fillim të shekullit të kaluar (1901). Çdo vit dhe një histori më vete. Dhe do të duhej nga një Agatha Kristi për çdonjërin prej tyre, për të përshkruar pasionet, intrigat, dyshimet dhe parashikimet në lidhje me të kurorëzuarin e mundshëm. Ndërkaq, asnjë vit tjetër nuk ishte kaq interesant se sa 1964-a, viti kur një filozof dhe shkrimtar frëng, Zhan Pol Sartri, zbuloi se ishte ndër kandidatët kryesorë për ta fituar. Kush ishte Sartri në atë kohë? Po ta ndeshje në rrugë dhe të mos e njihje atë burrë të shkurtër dhe rondokop, me syze të trasha dhe me një grua si ai që e shoqëronte kudo e kurdoherë, do ta merrje për ndonjë nëpunës banke apo bashkie. Në të vërtetë, dallonte shumë nga të zakonshmit. Romancier, dramaturg, skenarist, kritik letërsie dhe veprimtar i njohur shoqëror, Sartri ishte njëri nga protagonistët më të rëndësishëm të filozofisë frënge të shek. 20-të, të atij vendi që pas grekëve të lashtë kishte nxjerrë filozofë më mendjendritur të botës. Jo më kot konsiderohej turbina kryesore e "hidrocentralit filozofik" francez të periudhës së para dhe pas luftës së dytë botërore, nismëtari dhe



forca lëvizëse pas ekzistencializmit. Kur filluan të dendësoheshin të dhënat se ai do të ishte fitimtari i kursës për "Nobelin" e atij viti, Sartri nuk humbi kohë. I shkroi menjëherë Akademisë Suedeze, për t'u deklaruar prerazi se e tërhiqte me të gjitha zyrtarizmat e duhura kandidaturën e tij. Duke injoruar faktin se nuk mund të bëhej asnjë tratativë midis Akademisë dhe kandidatëve (as që ishte dashur të ndodhte kjo gjer atëherë), Sartri ishte i

vendosur në kërkesën e tij. Por muret e heshtura të Akademisë Mbretërore nuk dëgjonin nga ai vesh. Përfundimisht "Nobeli" i 1964-ës iu akordua Zhan Pol Sartrit më 22 tetor të atij viti, për veprën e tij që ishte "e pasur në ide, me shpirt lirie dhe kërkimi të së vërtetës". I zemëruar, Sartri refuzoi të udhëtojë në Stokholm, për të marrë në dorëzim statujëzën e artë të Çmimit më të rëndësishëm letrar të botës. Mbretit suedez i mbeti ftesa dhe statujëza në dorë... Për Sartrin rëndësi

primare dhe vendimtare kishte mendimi i tij. Nuk mund të dilte kundër vetes, por njëkohësisht respektonte opinionin, i cili shprehej nëpërmjet punës fisnike të shtypit demokratik. Nëpërmjet tij, kryesisht atij suedez, sqaroi arsyet e këtij refuzimi. Sartri i shpjegoi opinionit botëror se vendimi i tij nuk ishte thjesht një "lëvizje impulsive". Fakti që nuk pranoi "Nobelin" erdhi nga zakoni i tij i jetës për të refuzuar të gjitha nderimet zyrtare. Është e njohur ndodhja gjatë luftës, më 1939, kur Sartri shërbeu në ushtrinë franceze si meteorolog, para se të arrestohej nga ushtria gjermane më 1940. Kaloi nëntë muaj si rob lufte dhe më 1945, kur shteti francez i akordoi një dekoratë të lartë për shërbimet e tij patriotike në luftë - "Legjionin e Nderit" (Légion d'honneur) - refuzoi ta marrë në dozim. "Kam bërë thjesht detyrën!", deklaroi atëherë. Këtë praktikë e vazhdoi gjatë gjithë jetës, ngaqë konsideronte çdo nderim, një vartësi prej atij që e jepte. Dhe ai, mbi çdo gjë, dëshironte të ishte i lirë dhe i pavarur. Veç kësaj, kishte bindjen se shkëmbimi i dijeve dhe kulturës midis Perëndimit dhe Lindjes duhej të bëhej midis njerëzve, pa ndërhyrjen e institucioneve. Në rastin e "Nobelit", Sartr deklaroi: "Shkrimtari duhet të refuzojë të shndërrojë veten në vegël, edhe kur kjo ndodh në rrethanat më të ndershme, si në rastin tonë. [...] Ky refuzim është natyrisht një qëndrim krejtësisht i imi dhe nuk përmban asnjë kritikë për ata që e kanë marrë këtë çmim..."

Lazër Stani, shkrimtar

# KULTURA SHQIPTARE UNIKE DHE E PËRBASHKUAR NË GJUHËN SHQIPE

**Me duket se shqiptarët, kudo që jetojnë, e kanë humbur edhe atë lidhje të sforcuar që qe krijuar me librin në kushtet e lirisë së munguar, kur leximi i librave ishte e vetmja mënyrë për të gjetur pak liri shpirtërore për veten**

## Shkëlzen HALIMI

Shkrimtari Lazër Stani (u lind më 17 janar 1959 në Pult, Shkodër) është njëri nga prozatorët tanë bashkëkohor më të shquar. Me përmbledhjet me tregime që i botoi deri më sot, ai e ngriti prozën tonë në nivelet më të larta poetike. Të këtyllë e kanë vlerësuar studiuesit dhe kritikët tanë letrarë më të njohur. Në vitin 1985 u diplomua në Fakultetin e shkencave të natyrës në Tiranë, në degën biologji-kimi. Prej asaj kohe u mor me letërsi dhe gazetari, eseistikë dhe kritikë letrare. Tregimet e para i botoi në fund të viteve tetëdhjetë në gazetën "Drita", organ i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve dhe në "Zëri i rinisë", gazetë që në ato vite botonte dhe krijime të avangardës. Deri me tani Lazër Stani ka botuar këto vepra: 1993, "Misteri i hijeve", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese të LSHA-së, 1995, "Shplakja e Santa Marisë", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese "Eurorilindja", 1995, "Me dymbëdhjetë çelësa", libër me përralla dhe legjenda të Veriut, Shtëpia botuese e LSHA-së, 1998, "Në Bregenc shkohet për të vdekur", vëllim me tregime, Shtëpia botuese "Albinform", 1999, "Feniksi i kuq", vëllim me tregime, Shtëpia Botuese, "Buzuku", Prishtinë, 2005. "Dënesje në dru", Shtëpia botuese "Ideart", Tiranë, 2014 "Kohë për nuse", botim i E. B. Fishta, 2016 "Rrugë pa krye" - ese letrare. E. B. Fishta. Lazër Stani është nderuar me çmime të ndryshme letrare, ndër më të rëndësishmet: Çmim kombëtar për librin e parë më të mirë më tregime botuar në vitin 1993. Ministria e Kulturës, rinisë dhe sporteve, Çmimin e vitit për librin më të mirë të botuar nga Shtëpia botuese "Eurorilindja" 1995. Çmim kombëtar për librin më të mirë të botuar me tregime në vitin 1996, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

**HEJZA:** Në fillim qe Fjala, fjala si mundësi komunikimi! Pastaj liria e krijimit. Erdhi harmonia e përkryer si dhe krijesat që zotëronin aftësinë për ta kuptuar rëndësinë e baraspeshës së çdo gjëje të krijuar. Popujt, ideologjitë, sistemet që e refuzuan këtë formulë jetësore, përjetuan degradimin, dekadencën, zhdukjen! Le t'i japim këtij definicioni një kuptim estetik! Cili do të ishte ai?

**LAZËR STANI:** Fjala është në zanafillën e çdo krijimi. Në Ungjillin sipas Gjonit, në paragrafin e parë, "Mishërimi i fjalës", shkruhet: "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi". Perëndia e krijoi botën nëpërmjet fjalëve. Dhe Perëndia tha: "U bëftë dritë!" Dhe drita u bë. Pra, sipas konceptit biblik Fjala i ka paraprirë krijimit të Gjithësisë, të Tokës dhe Qiejve, të Dritës dhe Errësirës, të Natës dhe Ditës, të gjithçkaje që ekziston. Edhe në konceptin shkencor të teorisë së evolucionit, fjala në vetvete është krijuese e njeriut. Pa fjalën njerëzit ende do të endeshin si kope të egra nëpër rrafshinat e kësaj toke, nëse do të kishin mundur të mbijetonin, çka e shoh me dyshim. Nëpërmjet fjalës njeriu krijoi vetveten, duke u bërë një gjallesë e ndryshme dhe superiore në krahasim me çdo gjallesë tjetër që ne njohim.

Unë për vete, nga ana tjetër, nuk bëj pjesë tek ata shkrimtarë që e mistifikojnë fjalën, që e shndërrojnë atë në qëllim në vetvete. Në procesin krijues fjalët vijnë natyrshëm, duke gjetur secila vendin e vet në strukturën e fjalës, të tekstit, pa u ndalur në një kërkim të stërmundimshëm



të fjalëve. Ka shkrimtarë që i përmbahen konceptit të Çehovit, sipas të cilit, "letërsia, para së gjithash, është gjuhë. Të tjerat vijnë vetvetiu". Nuk mendoj kështu, sepse ka shkrimtarë që kanë një gjuhë të begatë, përdorin një leksik të pasur, por nuk arrijnë të thonë ndonjë gjë, përkundrazi, krijojnë një inflacion fjalësh, duke e dhunuar fjalën në vetvete. Një piktor mund t'i përdorë të gjitha ngjyrat dhe nuancat e mundshme, por nuk është e thënë që nga kjo derdhje e pakursim të ngjyrave në kanavacë të krijojë një pikturë magjepsëse. Mundet që rezultati të jetë një kanavacë e ndotur me ngjyra, ashtu siç mund të jetë një tekst proze a poezie i ndotur me fjalë, por i zhveshur nga magjia e krijimit. Them se krijimi është një akt intuitiv dhe gjuha që e përcjell është një instinkt. Përpjekja për ta dhunuar këtë proces të natyrshëm krijon monstra, siç ishte letërsia e Realizmit Socialist, edhe pse diktaturat komuniste, nuk janë të parat që janë përpjekur ta dhunojnë fjalën, lirinë krijuese. Të gjithë sundimtarët e egër, që nga kohët e lashta e deri më sot, janë përpjekur ta dhunojnë lirinë e fjalës, sepse njeriu që ka humbur lirinë e fjalës, është njëri i nënshtruar, skllav i sunduesit. Shqiptarët e kanë vuajtur në kurriz të tyre këtë dhunë barbare, edhe në mesjetë, kur shqipja ndalohej të shkruhej, por edhe në kohët moderne të imponuar nga pushtuesit e huaj (Kosovë, Maqedoni) dhe sundimtarët vendas (në Shqipëri). Edhe sot kjo liri, nuk është në ditët e saj të mira, por nga ana tjetër shkrimtari është një qenie vetmitare, ka një lloj autonomie nga proceset e jashtme, dhe nëse është i vetëmjaftueshëm, di të jetojë në lirinë e tij, pa lejuar askënd që ta cenojë në këtë hapësirë të shenjtë.

**HEJZA:** I nderuari Lazër, pse vendosët të largoheni nga atdheu dhe të shkoni në Amerikë. Duhet të keni pasur ndonjë arsye shumë të fortë që të largoheni nga Shqipëria?

**LAZËR STANI:** Nuk ka qenë një zgjedhje e lehtë, vendimi për t'u larguar nga Shqipëria para pesë viteve, edhe pse kam ëndërruar të arratisem që në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, atëherë për arsye krejt të tjera. Pas viteve nëntëdhjetë besoja se Shqipëria shumë shpejt do ta gjente udhën e vet si një shoqëri demokratike, perëndimore në koncept dhe në përmbajtje, por isha gabuar. Më doli i vërtetë paralajmërimi që më kishte bërë një mik i familjes në malësi, në vitet tetëdhjetë. -Lazër, më thoshte Nika, atëherë në moshë të thyer, komunistët e kanë futur të keqen shtatë pash nën dhe. Edhe kur ta thejnë qafën nesër, do të duhen pesëdhjetë vjet që t'i dalë e keqja kësaj toke. Atëherë nuk e pata besuar, por tani them me vete, se jo pesëdhjetë, por as njëqind vjet nuk do të mjaftojnë për ta shkullur atë të keqe të ngulitur thellë. Shto këtu edhe të këqija të tjera që historia nuk na i ka kursyer dhe atë indiferencë të tmerrshme ndaj të keqes, që zë vend si bari i keq në tokën djerrë. Një shkrimtar amerikan me prejardhje greke, Harris Mark Petrakis, thotë se njeriu "duhet të ketë një stol ku të ulet e të mendojë. Kjo e ka bërë Greqinë një vend të madh". Ne sikur e kemi bezdi të menduarit. Dhe kjo e bën perspektivën të zymtë. Unë nuk them se kisha ndonjë arsye të fortë për të ikur, por as ndonjë arsye të fortë për të qëndruar nuk kisha. Aventura drejt të panjohurës më joshte, megjithë vështirësitë dhe rreziqet që mbart. Etja për të provuar diçka ndryshe, me sa duket ishte vendimtare në marrjen e këtij vendimi. Një mikja ime, Enedia Topi, me thoshte se ti emigrant ke qenë edhe në Tiranë, gjithnjë me je dukur si i huaj në atë shoqëri. Kjo ndoshta e bëri më të lehtë largimin, edhe pse isha në një moshë, kur njeriu e ka të vështirë të ndërmarrë aventura të tilla. Megjithatë, pesë vitet e qëndrimit tim në SHBA, kanë qenë një eksperiencë e jashtëzakonshme, pavarësisht vështirësive që janë të natyrshme për çdo njeri që largohet nga vendi i vet, që fillon të jetojë në një gjuhë

tjetër, në një shoqëri tjetër, të panjohur prej tij. Më kujtohet se në vitet nëntëdhjetë në një bisedë në mbrëmje vonë, miku im Sali Berisha, atëherë president, më pati pyetur: "Lazër, si mendon, a duhet që shkrimtarët të largohen nga vendi i tyre? Dhe papritur përgjigjen time shtoi: Unë mendoj se jo. Shkrimtari duhet të jetojë me gjuhën në të cilën shkruan". Mundet kjo është e drejtë, shkrimtari duhet të jetojë në gjuhën në të cilën shkruan. Por, ardhja në Amerikë, megjithatë, e pasuroi jetën time me eksperiencën të jashtëzakonshme, solli njohjen me shumë njerëz të rinj, të kulturave dhe kombeve të ndryshëm; grekë, italianë, polakë, rusë, francezë, spanjollë, hebrej dhe natyrisht amerikanë, europianë të natyralizuar këtu prej shekujsh. Unë ende nuk jam ndalur të bëj bilanc, të gjykoj nëse kam bërë mirë apo keq që jam larguar, por përpiqem të jetoj me ngazëllimin që të ofron çdo ditë e jetës, pavarësisht vendit ku ndodhem.

**HEJZA:** Në ndërkohë, derisa Ju jeni atje përtej Atlantikut, ndërruan jetë shumë miq Tuaj, shkrimtarë të shkëlqyer. Ndërroi jetë edhe nana Juaj. Si i përjetoni këto lajme të trishta dhe çfarë do të thotë për ju vdekja?


**LAZËR STANI:** Në jetën e tij njeriu humbjet i ka të mëdha, ndërsa fitoret të vogla, kur e kur qesharake, groteske, të papërfillshme. Humbja e parë tronditëse dhe e pakuptueshme ka qenë ikja e strëgjyshes time, kur unë isha pak më shumë se pesë vjeç. Atë ditë nuk mund t'i kuptoja njerëzit që nuk me dukeshin aq të shqetësuar nga ikja e stërgjyshes time në moshën nëntëdhjetë e nëntë vjeçare, ndërsa mua më dukej se është përmbysur bota, se kurrë jeta nuk do të ishte më e njëjta. Pastaj humbjet erdhën me radhë, gjyshërit, prindërit, shumë prej njerëzve të dashur. Unë jam larguar i vogël nga shtëpia, në moshën katërmëdhjetë vjeçare, kam jetuar gjithmonë larg prindërve, gjithmonë duke e ndërjerë mungesën e tyre, po kur e ke vetëdijen se ata janë, gjithmonë ndihesh i mbrojtur, si i struktur në xhepin e brendshëm të xhakëtës së tyre. Një ditë ata ikin dhe t'i ndihesh i vetëm, i zbuluar, i pambrojtur, edhe pse tashmë je bërë me thinja. Një ditë ime bijë, Lodia, më tregoi se kishte parë në ëndërr gjyshin, babain tim. Më kishte marrë aq shumë malli, tha, sa vetëm qaja në ëndërr. Qava në ëndërr, po vazhdova të qaj edhe pasi u zgjova. Julio Cortazar ka një tregim të shkurtër, kur rrihen se gjatë kohës që ishte shtruar në spital, vdiqën gjashtë njerëz të shquar, që ai i donte, i adhuronte. "E di se do ta dal nga spitali i shëruar, shkruan në fjalinë e fundit Cortazar, por gjithsesi do të dal gjashtë herë më pak i gjallë". Më ka mbetur në mendje ky rrëfim i shkurtër i Cortazar-it. Vdekja e njerëzve të dashur na bën më pak të gjallë. Dhe më të vetmuar gjithashtu. Gjatë këtyre pesë viteve të qëndrimit tim në Amerikë kanë shkuar në përjetësi shumë prej miqve të mi, intelektualë, shkrimtarë dhe poetë, me të cilët kam ndarë kohë, mendime, emocione, me kanë lidhur ngjarje dhe histori të ndryshme. Dhimbja për këto ikje të mëdha ngurtësohet në shpirt dhe ti e mbart me vete gjatë gjithë jetës tende. Sot e kësaj dite Tirana më duket më e varfër, më e shkretë, më e mjerë pa mikun tim të hershëm të viteve të rinisë, poetin Bardhyl Londo. Ende ruaj në telefonin tim mesazhet që kemi shkëmbyer në vitet e fundit të jetës së tij, kur unë gjendesha në Amerikë. Dhe në asnjë mesazh të tij

nuk mungonte pyetja: Hë, kur do vish? Dhe pastaj vërejtja shqetësuese: Nuk e di ç'dreçin kërkon andej? Dhe unë që nuk dija t'i përgjigjesha vërtet se çfarë kërkoja në tokën e largët ku kisha ardhur. Se unë nuk kisha ardhur në SHBA as si kërkues floriri nëpër përrenjtë e Kalifornisë dhe as si zaptues tokash të pazëna në hapësirat e Perëndimit të Egër. Por, ndoshta ka një lloj eksplorimi tjetër që e mban njeriun në lëvizje sa ta ketë frymën, një shtysë të brendshme për të mos u ndalur deri në ditën e fundit që na është shkruar të jetojmë. E kam thënë në një nga esetë e mia që dyert që nuk mund t'i hapim i mbyllim me kyç. E tillë është edhe vdekja, një portë e kyçur që as mund ta hapim, as mund të shohim përtej saj. Dhe ne jetojmë më këtë kompromis, pa u bërë peng i tij. Ndoshta pikërisht për këtë arsye vdekjen nuk e mendoj.

**HEJZA:** Gjithnjë e më shumë mbretëron konstatimi se kritika letrare ka ngecur dukshëm, ndaj dhe kemi një vërshim të vlerave të dyshimta. Çfarë duhet bërë që të ringjallet kjo kritikë?

**LAZËR STANI:** Kritika është një institucion i rëndësishëm, që dëshmon pjekurinë e një kulture. Unë lexoj me dhjetëra shkrime që botohen për librat në shtypin letrar dhe në portale, pothuajse çdo javë. Pra, nuk mund të thuash se nuk ka kritikë, por problemi është se sa serioze është kjo kritikë. Kritika në Kosovë ka qenë më profesionale, më e avancuar se sa kritika letrare në Tiranë, e cila kishte një mision të diktuar absurd, atë të patronazhimit ideologjik të letërsisë dhe arteve. Por, edhe pas pluralizmit politik dhe fitimit të disa lirive, prapë kritika letrare nuk ka mundur ta gjejë vetveten, të paktën në ato standarde që priteshin prej saj. Sot ka një larmi të mendimit kritik, nga ajo që i përket shkollës së vjetër, e deri të përpjekjet me një kritikë moderne, por them ende pa mundur të spikasë me zërin e saj të dallueshëm dhe të ndikojë në proceset kulturore. Mua nuk më ka shqetësuar asnjëherë fakti që botohen libra pafund, me ose pa vlerë. Kjo gjë ndodh në shumë kultura të botës, përderisa botimet me vetëfinancim ekzistojnë gjithandej, jo vetëm në Lindje, por edhe në Perëndim. Kështu që ne nuk jemi një përjashtim shqetësues. Ama mungesa e seriozitetit në kritikë është diçka e dëmshme, së pari për vetë autoritetin e kritikës, pastaj edhe të lexuesve. Nëse kritiku nuk kujdeset vetë për autoritetin dhe seriozitetin e vet, nuk ka se si t'i besojë lexuesi dhe aq me pak shkrimtari. Në këto vite kam parë kritikë që vërtetë i kam vlerësuar për punën e tyre të shkruajnë tekste joseriozë për libra të palexueshëm. Kjo e dëmton autoritetin e kritikut, e shndërron atë në një faktor kulturor jo serioz, e bën të papërfillshëm. Ajo që më shqetëson më shumë është qëndrimi pothuajse nihilist i një kaste njerëzish ndaj letërsisë shqipe. Ne sigurisht jemi një vend i vogël, që e krijon letërsinë e vet në një gjuhë të bukur, por që flitet nga më pak se shtatë-tetë milion njerëz, pra shumë më pak se popullsia e Nju Jorkut, apo Stambollit. E megjithatë në me pak se një shekull, në këtë gjuhë është krijuar një letërsi dinjitoze, me autorë seriozë, të mirëpritur edhe nga lexuesi e kritika e vendeve të tjera. Me duket se këtu fshihet edhe një prapavijë politike, sidomos në qëndrimin ndaj letërsisë së krijuar pas shembjes së diktaturës në vitet nëntëdhjetë. Një lloj agresiviteti i fshehtë ndaj autorëve post-diktaturë, që nuk janë lloçoçitur dhe ndotur në kënetën e realizmit socialist. Para disa vitesh kam lexuar në ExLibris tregimin "Gungaçi" të Shqiponja Axhamit. Mbete i mahnitur aq sa nuk po i besoja vetes. Një tregim mjeshtëror, i jashtëzakonshëm, si i shkruar nga ndonjë prej mjeshtërve të mëdhenj të prozës së shkurtër. Që të bindja veten u ktheva dhe e rilexova. Asnjë mëdyshje. Ishte një nga tregimet më të bukur që kisha lexuar viteve të fundit, jo vetëm nga letërsia shqipe, por edhe nga autorë të letërsive të tjera. Dhe unë lexoj jo pak dhe them se kam informacion për letërsinë që shkruhet sot jo vetëm në anglisht, por edhe në gjuhët e tjera. Fenomene të tilla duhet të përcjellë kritika, t'i zbulojë dhe evidentojë para lexuesit, jo të lloçoçitet në ujëra të ndenjura, apo të shqiptojë gjëra të ditura.

**HEJZA:** Fatkeqësisht, ekziston një



pajtuemëri se në qarqet letrare po "lulëzojnë" disa klane të çuditshme, që duan ta kenë në një mënyre monopolin mbi letërsinë. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e më gjerë ka talente, por që nuk mund të vijnë në shprehje, thjeshtë për shkak të faktit se nuk shohin shteg të hapur për të arritur deri te botimi apo prezantimi në opinion. Çfarë pasojë mund të ketë kjo dukuri?

**LAZËR STANI:** Askush në këtë botë nuk mund të ketë monopol mbi letërsinë. Monopoli i vetëm që mund të arrijnë

është ndikimi në dhënien e çmimeve për letërsinë që shpërndahej çdo vit, përfitimet e fondeve të vogla, që jepen nga ministrinë respektive të kulturës, ose ndonjë zhurmë, për botimet e njëri-tjetrit. Asgjë më shumë. Të prirë për të krijuar klane, së pari, janë krijuesit e pasigurt te vetja, që e kërkojnë sigurinë e munguar jashtë vetes, në rrethin shoqëror, në klubin ku bëhen pjesë. Së dyti është një sindrom provincializmi, që ka qenë gjithmonë i pranishëm në realitetin kulturor shqiptar. Në media dhe shkrime të ndryshme, shpesh lexon përcaktime të tilla si



shkrimtari vlonjat, shkrimtari shkodran, shkrimtari korçar, shkrimtari gjakovar apo strugan, që shprehin pikërisht këtë mentalitet lokalit dhe provincial. Mendo të përdornin grekët përcaktimin shkrimtari kretan, Nikos Kazantzakis, apo amerikanët shkrimtari njuxhersas, Philip Roth apo poeti njujorkez, Walt Whitman. Një gjë e tillë as që mund të mendohet. Nuk ka letërsi e Shqipërisë, letërsi kosovare, letërsi e arbëreshëve apo letërsi e diasporës. Ka vetëm letërsi shqipe që është e gjithë letërsia e shkruar në këtë gjuhë, dhe natyrisht autorë shqiptarë që janë të gjithë ata autorë që gjuhën të shkrimit letrar kanë gjuhën shqipe. Ne kemi një mani të dëmshme për t'i bërë gjërat e mëdha të vogla. Më kujtohet se në vitet nëntëdhjetë, shoqërova gjatë vizitës së tij në Shqipëri një shkrimtar rus, Sergei Jesin, që në atë kohë ishte rektor i Institutit Gorki. Vizituam se bashku Muzeun e Gjergj Kastriotit në Krujë, Amfiteatrin e Durrësit dhe qendra të tjera të trashëgimisë historike, kulturore e shpirtërore. Ndërsa qëndronim në Amfiteatrin e Durrësit, në atë kohë i lënë krejt pas dore, ai më tha: "Nuk ju kuptoj juve shqiptarëve që gjërat e mëdha keni maninë t'i bëni gjëra të vogla, kur gjithë bota bën të kundërtën: gjërat e vogla përpiqet t'i bëjë të mëdha." Ne me duket se historikisht kemi vuajtur nga prirja e fragmentarizimit, parcelizimit, copëtimit, klanizimit, kur duhej të ndodhte e kundërta. Sigurisht që klanet krijojnë një klimë mbytëse, sidomos për autorët e rinj, ende të paafirmuar, por herët a vonë, një krijim i mirë letrar do ta shohë dritën e botimit dhe do të gjejë lexuesin e vet. Një shkrimtar serioz as që mund ta mendojë se dikush tjetër e ka në dorë fatin e tij. Natyrisht, të hysh në letërsi nuk është e lehtë në asnjë vend të botës. Po tregoj vetëm një rast të shkrimtarit greko-amerikan Harry Mark Petrakis, i cilësuar nga New York Times, si një nga shkrimtarët më të mirë të kohës tonë. Për dhjetë vite, ai nuk kishte mundur të botonte asnjë tregim në shtypin letrar amerikan. Gjatë këtyre viteve të gjitha gjërat i shkonin keq dhe shpesh ai me të shoqen mbaheshin gjallë me ushqimet që u sillte vjehrra. Siç tregon vete në një nga intervistat e tij të fundit, herë pas here kishte frikë se mos vjehrra e helmonte që të shpëtonte të bijën nga një burrë dështak si ai. Jo pa humor tregon se si festonte me një shishe verë, sa herë që redaktorët i kthenin ndonjë përgjigje inkurajuese. Në Shqipëri, sidomos në këto vite, ka një realitet tjetër, ku gjithçka botohet me një lehtësi të papërbalueshme dhe kjo në radhë të parë dëmton autorët e rinj, sepse i shmang nga kërkimi i shkrimtarit tek vetja. Më kujtohet se në një nga intervistat e saj shkrimtarja italiane, Susanna Tamaro, i këshillonte shkrimtarët e rinj: "Kurrë mos boto një libër me paratë e tua". Por, kjo këshillë nuk zbatohet pothuajse askund. Jo vetëm në Shqipëri, Kosovë apo viset e tjera ku jetojnë shqiptarët, por as në Amerikë, se edhe këtu ka me mijëra botime me vetëfinancim.

**HEJZA:** Sot, si asnjëherë më parë kemi kaq shumë botime, sa që do të na duhej edhe një jetë tjetër për t'i lexuar. Sot mund të botojë kush të dojë me kusht që të ketë lek dhe në këtë drejtim nuk ekziston asnjë pengesë. Sot, fatkeqësisht, gjithandej hapësirave shqiptare, dominojnë "botuesit" abuzues, të cilët botojnë gjithçka që paguhet. Nga ana tjetër, sot si asnjëherë më parë lexohet shumë pak. Si të shpjegohet kjo dëshirë e madhe për të botuar kur prezenca e krizës së leximit është fare e dukshme?

**LAZËR STANI:** Këtu në Nju Jork jetoj në një lagje hebreje prej dy vjetësh. Pas pallatit, është një backyard me stola dhe pemë, një lloj miniparku i izoluar, që rrallëkund gjendet edhe këtu. Nuk kam parë kurrë të dalë një banor i pallatit e të çlodhet në backyard pa një libër në dorë, qofshin këta edhe të moshuar mbi të tetëdhjetat. Nëna me fëmijë, të rinj, burra të pjekur, të moshuar, të gjithë me libra. Kjo ma ka përforcuar bindjen se populli hebre është popull i librit dhe se kanë arritur aty ku janë sot, pikërisht falë kësaj lidhjeje pothuajse gjenetike me librin. Në të kundërt, me duket se shqiptarët, kudo që jetojnë, e kanë humbur edhe atë lidhje të sforcuar që qe krijuar me librin në kushtet e lirisë së munguar, kur leximi i librave ishte e vetmja mënyrë për të gjetur pak liri shpirtërore për veten. Ky është një problem i thellë kulturor, shqetësues sigurisht. Ka të bëjë së pari me familjen, me shkollën, por edhe me institucionet e


librit dhe të kulturës gjithashtu. Shumica e familjeve shqiptare janë katandisur në kushtet e mbijetesës dhe një kryefamiljar që mezi mbijeton e ka mendjen si t'i ushqejë fëmijët më bukë, si t'i veshë e mbathë e nuk ka as kohë as mundësi të vrasë mendjen që t'u sjellë libra fëmijëve në shtëpi. Edhe në familjet e pasura nuk ndodh që fëmijës t'i bëhet dhuratë për ditëlindje, bie fjala, një libër apo një set librash, por mundësisht një iPhone, prodhim i fundit, apo një set veshjesh të shtrenjta. Kjo ka të bëjë me kulturën e konsumit në të cilën jemi përfshirë egërsisht. Në shkolla, ndërkaq, letërsia mësohet shumë keq, që jo vetëm nuk e nxit, por e fashit dëshirën për lexim. Për të mos folur pastaj për politikën kulturore dhe institucionet që ato prodhojnë, të cilat janë krejtësisht të paafat për të sjellë ndonjë ndryshim të prekshëm të realitetit në të cilin jetojmë. Në këtë shekull të teknologjisë së avancuar, kudo në botë ka një rënie të numrit të lexuesve, por jo në përmasa aq shqetësuese. Shoqëria njerëzore kalon nëpër faza të ndryshme zhvillimi, me ulje-ngritje, por mendoj se libri gjithnjë do të mbetet bashkudhëtar i njeriut, si një prani në misterin e ekzistencës së tij. Po, ndërsa, refuzimi i librit është shqetësues, botimet e panumërta nuk përbejnë ndonjë problem kushedi. Në sitën e kohës mbijetojnë vetëm vlerat.

**HEJZA:** Për vuajtjet si pasojë e regjimeve totalitariste më lehtë e kemi t'i citojmë poetët rusë, polakë, çekë, bullgarë, se sa poetët shqiptar. E kemi si rrjedhojë e demagogjisë apo, thjesht, nuk njihemi në mes vete, nuk lexohemi! Ç'vuajtje ka mundur të pësojë më shumë një poet rus se sa një Visar Zhiti, apo një Teki Drvishi, ç'mendim estetik më të madh do të mund të kishte lënë Haveli se sa Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja, Sabri Hamiti, ç'poezi më të mirë do të kishte një disident polak se sa Jusuf Gërvalla etj. Ç'nivel intelektual e kulturor do të ishte njohja e kulturave të huaja ndërsa njohuritë mbi kulturën kombëtare i ke copë-copë?

**LAZËR STANI:** Pas shembjes së regjimeve totalitariste ne gabimisht menduam se do të çudisnim botën, duke dëshmuar tmerret e regjimeve kriminale nën të cilat kishim jetuar. Por, ishim edhe të gabuar, edhe të vonuar. Shkrimtarë si George Orwell, Boris Pasternak, Aleksandr Solzhenitsyn, Joseph Brodsky, Vaclav Havel, Milan Kundera e shumë të tjerë i kishin dëshmuar në veprat e tyre letrare shumë kohë më parë krimet monstruoze të regjimeve komuniste në Europë dhe në Botë. Me librat tanë për diktaturën ne mund të çudisnim veten, por askënd tjetër. Është e vërtetë se Shqipëria ka vuajtur në diktaturë mizore, aq mizore sa nuk lejoi ekzistencën e asnjë lloj arti disident. Autorët që shfaqnin mosbindje estetike, burgoseshin, ekzekutoheshin, veprat e tyre asgjësoheshin. Ne letërsinë disidente e kemi të publikuar në liri. Po të ishin botuar poezitë e Visar Zhitit, të Vilson Blloshmit, romanet e Pjetër Arbnorit, apo kujtimet e At Zef Pllumit në vitet tetëdhjetë, do të kishin një impakt krejt tjetër të lexuesit. Por, i tillë ishte realiteti shtypës shqiptar, disedanca nuk mund të ekzistonte. Nga ana tjetër është një prirje e lindur për të huajën, ashtu siç na pëlqejnë vajzat e fshatit përtej malit më shumë se vajzat e fshatit tonë. Për ne si shqiptarë, natyrisht, parësore është kultura kombëtare dhe krijuesit e kësaj kulture, thelbësore është gjuha që përcakton identitetin tonë. Ndërkaq, lexuesit nuk mund t'i imponohesh me faktin se je autor shqiptar, por me standardin e krijimtarisë tende, me vlerat estetike që përcjell të lexuesit. Dhe në një botë të hapur, në një botë të globalizuar, konkurrenca nuk është me oborin tënd, fshatin apo qytetin ku je lindur, është e përbotshme. Me këtë sfidë duhet të përballët secili krijues. Pikërisht për këtë kohë moderne e kanë bërë edhe më të vështirë suksesin e shkrimtarit.

**HEJZA:** Fatqësisht, kasta artistike shqiptare nuk njihet në mes vete, nuk respektohet, ndërsa nuk duket në horizont asnjë shenjë, asnjë përpjekje për një platformë të përbashkët kulturore që do të ishte si nismë historike për bashkim kombëtar në rrafshin kulturor.


**LAZËR STANI:** Nuk mendoj se elitat kulturore shqiptare nuk e njohin njeri-



tjetrin. Nëse flas për eksperiencën time personale, jo vetëm veprat, por edhe personalisht i kam njohur shumicën e krijuesve shqiptarë të Kosovës e Maqedonisë së Veriut, nga Ramiz Kelmendi, Teki Dervishi, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Jusuf Buxhovi, Adem Gashi e deri tek shkrimtarët dhe poetet e gjeneratës time si Halil Matoshi, Bardh Frangu e Ndue Ukaj, e po ashtu edhe shkrimtarët shqiptarë që jetojnë në Maqedoninë e Veriut, siç jemi njohur edhe bashkë që në fillim të viteve nëntëdhjetë. Dhe të them të vërtetën e kam ndërjerë vetën të respektuar dhe të vlerësuar, si midis miqsh dhe kolegësh të nderuar. Unë mendoj se kultura shqiptare është unike dhe e përbashkuar në gjuhën shqipe. Asgjë dhe askush nuk mund ta ndajë dhe parcelizojë. Respekti apo mosrespekti nuk ka të bëjë me mosnjohjen, por me cmirat, zilitë, atë frymë përçarëse dhe

ditë, pavarësisht se jo gjithnjë në rrugën e duhur. Tek ne ka shumë lëvizje mbrapsht, që shpjen në rrugë pakrye, por që ndoshta nuk është vendi t'i përmend në këtë intervistë.

**HEJZA:** Antologjitë e shpeshta të poezisë shqiptare më shumë shprehin mentalitetin tonë krahinor se sa përgatitjen profesionale për vepra të tilla reprezentative! Botohet "Antologjia e poezisë shqiptare", ndërsa aty nuk përfshihet asnjë poet nga viset e tjera etnike! Për të qenë trishtimi edhe më i madh, mblidhen poetë, demagogë e mediokër dhe e promovojnë si kryevepër shqiptarë! Këto ndasi të qëllimita do të duhej të dënoheshin si tradhti kombëtare! Akoma nuk kemi një shfaqje teatrale të përbashkët, akoma nuk kemi një film të përbashkët, një koreografi, një koncert



provincialiste që vjen nga thellësia e shekujve, aq sa ngjan sikur të gjithë jemi ushqyer që në djep me biberonin e armiqësive të brendshme dhe mosdashjen e tjetrit. Është një e vërtetë e dhimbshme, por të vërtetat duhen thënë ashtu siç janë. Duke gënjyer veten nuk shkohet askund. Sa kohë që nuk e kuptojmë se duke dashur dhe respektuar tjetrin, ne kemi dashur e respektuar veten tonë, do ta kemi të vështirë të bëjmë përpara. Megjithatë diçka lëviz, diçka ndryshon çdo

me instrumentistë e interpretues të përbashkët, nuk kemi akoma një ekspozitë të piktorëve shqiptarë nga të gjitha trevat etnike...

**LAZËR STANI:** Nuk jam ndonjë adhures i antologjive dhe rrallë marr mundimin t'i shfletoj. Vetëm kohët e fundit kam lexuar një antologji me tregimet e para të publikuara nga autorët më të famshëm që kanë shkruar në gjuhën angleze te

titulluar "first fiction"(tregimi i parë). Ajo që më bëri përshtypje në këtë antologji, ishte fakti se me çfarë tregimesh të bukur i ishin prezantuar lexuesit së pari shkrimtarë të tillë si William Faulkner, F. Scott Fitzgerald, Graham Greene, Henry Miller, Joyce Carol Oates, Philip Roth, John Updike, Isaac Bashevis Singer e shumë të tjerë. Një antologji të tillë me autorët shqiptarë do ta shfletojta me kënaqësi. Por, informacionin letrar nuk e kam marrë pothuajse kurrë nga antologjitë. Kryesisht e kam marrë nga faqet kulturore të gazetave si Corriere della Sera, The Guardian dhe sidomos nga gazetat dhe revistat letrare, dikur nga Inostrannaya Literatura, Literaturnaya Gazeta dhe më vonë nga New Yorker, New York Times etj. Nëse një autor merr përsipër të bëjë një antologji, është përgjegjësi e tij se çfarë prezanton para lexuesit. Kur dikush merr përsipër të bëjë një antologji të poezisë shqipe dhe përjashton mbi kritere gjeografike poetet dhe autorët që shkruajnë shqip, ai nuk ka arritur të bëjë një antologji të poezisë shqipe, por vetëm ka firmosur një dështim personal. Megjithatë, mund të them se një antologji e tillë nuk mund të ketë asnjë ndikim në kulturën kombëtare. Shkrimtarët dhe poetët ekzistojnë pavarësisht nëse janë përfshirë ose jo në një antologji të hartuar mbi kriter statist, apo gjeografik. Turp është kur projekte të tilla financohen nga shteti, nga paratë e taksapaguesve. Ndarjet që nganjëherë nxisin qendrat tona kulturore, me gjithë politikën që prodhojnë, megjithatë nuk them se kanë ndonjë ndikim të ndjeshëm të qytetarët. Këngëtarët shqiptarë nga Maqedonia e Veriut apo nga Kosova dëgjohej me po aq endje në Shqipëri sa edhe këngëtarët vendas dhe anasjelltas. Pra, një popull që ka një kulturë e një gjuhë, mund ta copëtojnë pushtimet, kufijtë e dhunshëm, po jo sharlatanët që duan të fitojnë shkëlqim në principata të vogla. Unë mendoj se shkrimtarët kurrë nuk kanë qenë kaq afër njëri-tjetrit sa ç'kanë arritur të jenë në këto tridhjetë vitet e fundit. Dhe kjo jo për meritë të liderëve, politikës, apo intelektualëve largpamës, por thjeshtë se jemi një popull, flasim të njëjtën gjuhë, kemi kulturë dhe trashëgimi shpirtërore të përbashkët. Tani pyetja që shtrohet është: a ka vend për integritet të mëtejshme: sigurisht që ka, sepse sa më të bashkuar që të jemi aq më të fortë dhe më të suksesshëm do të jemi, si bashkësi, si njerëz, si komb.

**HEJZA:** I nderuar, Ju padyshim se konsideroheni si një nga prozatorët e shkëlqyer bashkëkohor dhe çdo botim i Juaj është pritur me kërshtëri të veçantë. Por, ka kaluar një kohë e gjatë që kur nuk kemi botuar asgjë. Çfarë po ndodh në laboratorin krijues të Lazër Stani?

**LAZËR STANI:** Së pari të falënderoj për vlerësimin. Kësaj pyetjeje është vërtet vështirë për t'iu përgjigjur. Në fshatin tim gratë e moshuara, e kishin zakon të mblidheshin bashkë mëngjesve, pinin kafe dhe i tregonin njëra-tjetrës ëndrrat e natës së shkuar. Tregonin vetëm ëndrrat e liga, ëndrrat me tmerre, por kurrë ëndrrat e bukura. Njëra prej tyre, nana Drana, me pati thënë njëherë se ëndrrat e bukura nuk tregohen. Po i tregove, prishen. Edhe unë nuk mund të tregoj se çfarë po shkruaj apo çfarë ëndërroj të shkruaj. Rrëfimi paraprak e zhbën magjinë e krijimit. Historitë që i tregoj me gojë, në përgjithësi, nuk arrij t'i shkruaj. Dhe as historitë e huaja nuk mund t'i shkruaj. Nuk ndodh që unë të dëgjoj diku një histori dhe më vonë, sapo të kthehem në shtëpi, të ulem e ta shkruaj. Gjithsesi, në çdo çast të jetës time jetoj brenda një historie. Historitë janë të ndryshme nga dita në ditë, por secila ditë ka historinë e saj, pavarësisht, nëse ulem në kompjuter ta shkruaj apo jo. Dikush më pati thënë njëherë se ty të ndjekin historitë. Nuk është se më ndjekin, thjesht ndodhin, por unë i përjetoj disi ndryshe, u jap shëmbëllimin e vet të përvetshëm. Është fakt i pamohueshëm se njeriu përjetimet më të forta i ka nga fëmijëria dhe adoleshënca e hershme. Ruajtja e kësaj aftësie përjetuese në të gjitha moshat e tij e dallon shkrimtarin nga joshkrimtari. Historitë arkivohen brenda teje dhe, nëse ato nuk arrijnë të zhbëhen me kalimin e kohës, vjen çasti që ato shkruhen. Kështu ndodh përherë me mua. Them se propë kam histori për të rrëfyer.

Shkrimtar pa leje, Lazër Stani


# KOHË PËR... DHËNDËR

**Lazri nuk bubullon nëpër klube e ekrane. Kështu, jobubullues, ka hyrë edhe në letërsi. Në fund të viteve tetëdhjetë botoi në gazetën Zëri i Rinisë një tregim të rrezikshëm. Në qendër ishte njeriu që dyzohej e mbytej nëpër dosje**

**Nga Mehmet ELEZI**

1. Në fundverë 2008 qeshë ftuar në hapjen e ekspozitës së artistit shqiptar Rafet Jonuzi, në Bregenc, qytet i vogël në perëndim të Austrisë. Prisja që liqeni i përmendur të ishte i errët e me brigje shkëmbore, vorbullues, i tutshëm. Nuk ma kishte nxitur këtë përfytyrim ngjashmëria e alpeve të Austrisë me alpet e Zvicrës. Ma kishte nxitur një tregim tronditës i Lazer Stanit: "Në Bregenc shkohet për të vdekur". Shija e tij më kishte mbetur në shpirt prej dhjetë vjetësh. Siç të mbetet në gojë shija e një kafeje të fortë, të idhët, që pi në imtën (momentin) e duhur. Vdekja në Liqenin e Bregencit lidhej me një kulm dramatik të historisë sonë të re. Intelektuali dhe nëntëdhjetështata, viti aq i mbrapshtë. Intelektualët liberalë, që mendonin djathtas, u gjetën aq keq sa dhe paraardhësit e tyre fill pas 1944-s, dhe u bënë pikë e pesë nëpër udhët e botës. Por kjo arrati e detyruar vetëm sa e tjetërsoi dramën. Ose e transferoi. Nuk e lehtësoi. Fati në aso motesh vrastare mund të përmblihet duke parafrazuar dy vargje të Këngës së Nizamëve të Kadaresë: nga vdekja vijmë, drejt vdekjes shkojmë. Në thelb ky qe tregimi. I shkruar mjeshhtërisht. Po ta lexojë diku tjetër, duke të mbajtur fshehtë emrin e autorit, pa menduar gjatë mund të pohojë se është i Heminguejit. Në kundërshtim me vështrimin e filtruar nëpër këtë lëpë të trishtë, Liqeni i Bregencit u shfaq i shtruar, paqësor e vezullues, si det plazhi. Më kujtoi Liqenin Ballaton në Hungari.

2. Lazri nuk bubullon nëpër klube e ekrane. Kështu, jobubullues, ka hyrë edhe në letërsi. Në fund të viteve tetëdhjetë botoi në gazetën Zëri i Rinisë një tregim të rrezikshëm. Në qendër ishte njeriu që dyzohej e mbytej nëpër dosje. S'i pata thënë asokohe (për mos me e shqetësue), por më vonë po: në Pallatin e Endrrave picërruan sytë keq. Në një zyrë të madhe të katit të tretë më bënë dy pyetje: ç'janë këto që boton "kjo gazeta juaj" dhe ç'është "ky Lazër", nga e keni gjetur? Shumë herë ushtojnë boritë për "art të paangazhuar". Shpesh kjo teori tingëllon si modë njerëzish të lëmuar. Ç'kuptim ka, i thua vetes. Intelektuali është jokonformist në qenien e tij. Artisti aq më shumë. Dhimbja për fatet e vendit, për fatin e Njeriut, bren eshtrat e krijuesit. Lazri dha shenjat e një krijimtari të guximshme. Mes një kohe të muajshme, kur lypej guxim intelektual. A thua vetvetishëm, me një mekanizëm hyjnor, frymëzimi merr vlagë prej kohës, nëpër mijëra kapilarët që e lidhin me të, si enët komunikuese? Nga libri i parë me tregime ("Misteri i Hijeve", Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve,



Tiranë, 1993), deri tek i fundit ("Kohë për nuse", Gjergj Fishta, Tiranë, 2014), janë shtatë. Në tërë këta Lazri shkrimtar më del në tri trajta. Tri trajta që lidhen në të njëjtin bosht.

3. Më del ngarendës i realizmit magjik në tregimin bashkëkohor. Gjinia ku ndihet zot. Nën këtë flamur estetik ka shkëlqyer një mjeshhtëri e madh i prozës së shkurtë, Koliqi. Stilit i përkryer, njohës i thellë i jetës në qytet e në male, herë-herë disi idealizues i kësaj të dytës. Ndryshe prej shkrimtarëve italianë të kësaj shkolle, letërsinë e të cilëve e kishte përthithur me etje, Koliqi duket se tërhiqet disi nga një farë estetizimi i jetës së hershme, me ngjyresa parake, në male. Ia donte koha? Lazri nuk joshet prej akuareleve. Realizmi magjik i tij lëviz nëpër një hije të muzgët. Është "dënesje në dru", po të përdorim titullin e njërit prej tregimeve. S'ka idile, vele hijeshuese. I mbyty drama e brendshme. Në këtë kundrojë më duket se ai dhe Kim Mehmeti njetjetohej herë pas here. Secili nëpër shtegun e vet.

4. Më del heminguejan. (Vetë)vrasja në

Bregenc (gjithsesi vrasësit nuk janë aty, janë larg) takohet me vrasjen e dy poetëve "me sy të fiksuar pas një ylli", mes një përroi gjaku dhe një intrige sa mizore aq të pështirë. Fjali të shkurta, rrëqethëse, si dhimbjet therëse të zemrës. Hapësira mes këtyre dy tregimeve, me varre e kryqe të tjera.

5. Më del tregimtar i shtruar, që nis udhën me fjali të prajta, me ritëm gati "pleqërisht". Është mashtrim. Nën këmbët e rrëfimit ("narracionit") të ngadaltë, ndihet një uturimë, si ujëra të nëndheshme. Lëviz energjia e brendshme, kah mblihet në thellësi. Qielli ende pa ré i rrafshinës së qetë të tekstit pritët nga vetëtima e beftë, paralajmëruese, e ndonjë mendimi të gdhendur, drithëruar: "Në këtë botë ka jo pak vrasës të qeshur". "Jemi po ata njerëz shpellash, që sulmonim njerëzit e shpellave të tjera t'u rrëmbenim gratë, t'u plaçkitnim ushqimet. Kultura është maska që kemi vënë në fytyrë, por jemi të njëjtët". "Kishte lexuar në Bibël se nuk duhej të mendonte me frikë për të ardhmen. Secilës ditë i mjaftonte e keqja e vet". "Njerëzia është kudo njësoj... kqyr dokën, jo kokën". Kjo energji e

grumbulluar shpërthen papritmas, brenda logjikës artistike. Nuk e pret lexuesi atë që do të ndodhë në fund te tregimi "Të magjepsurit". Vështirë e paramendon zgjidhjen absurde, por krejt të besueshme, që ia beh te "Kohë për nuse". Nuk e përfytyron as atë "piano" të çuditshme, me një dashuri tjetërfare, të Linës, me të cilën mbyllet tregimi "Pianisti". Fatin e Daiza Zaharisë e ndien, por prapëseprapë s'e merr kurrë me mend, derisa e prek në fund.

6. Te libri "Kohë për nuse" tregimi të le si dyzash. Sikur s'kënaqesh që mbaroi aty, ndihesh pak zbrazët. Pret me ndodhë edhe diçka, nuk di as vetë çka. Këtu shenjtëria e artit takohet me shenjtërinë e bukës. Të dyja të mbajnë gjallë, njëra trupin, tjetra shpirtin, siç i ka bekuar Zoti. Për shëndetin është gjithmonë mirë me u çue pak i pangimë prej një tryeze me tërë të mirat. Është mirë edhe kur një vepër artistike të ofron shumë e njëherësh të le pak unshëm, me pyetje për autorin dhe për veten. Letërsia e njëmendtë është pak Xhakondë. Çdo kundruesi të saj i duket se Mona Liza po e ndjek me sy pikërisht atë dhe jo dikë tjetër. Çdo kundruesi të saj i duket se po e ndjek me dyshim, dëshirë, ftohtësi, shije... varësisht prej përjetimit që ka ai vetë. Një vepër letrare ka shumë interpretime, ka njëqind fytyra në një. Lexuesi sheh atë fytyrë që i shijon më fort. Përthith atë kurt që i vjen për shtat. Në këtë palimpsest artistik, gjithsecili lexon faqen që i duket se është shkruar për të. Për botën e tij.

7. Libri i fundit i Lazër Stanit titullohet "Kohë për nuse". Pra dhëndri është gati. Çështja është: di letërsia jonë ku i ka "dhëndrat" e vet? Në këtë Atdhe të dashur shpesh nuk janë vlerat ato që bëjnë protokollin e vetë vlerave. Atë protokoll zyrtar që shpërndan dafina, çmime, tituj, komoditete. E njëjta gjë edhe në art. "Në universitet kisha qenë më i miri, por më të mirët dështojnë", thotë tragjikisht personazhi i një tregimi në librin e përmendur. "Dhëndrat" më të mirë të letrave tona disa njihen mirë, disa pak e do të tjerë hiç. Ndryshe nga sa ndodh në jetë, shumë syresh nuk janë në moshën e dhëndërimit. Janë "kolonelë" të pjekur, me talent e energji, të cilëve shpesh "s'ka kush t'u shkruajë". Punojnë në gjysmëhije, në hije ose krejt në terr. Shoqëria, pjesa që ka butonat, i ndëshkon, u pret rrymën. Ju? Për ju black-out! Rrymën që varet prej qenieve të tokës. Rrymën që u dhuron Qielli, s'ua prek dot kush në tokë.

(Nga libri "Shkrimtar pa leje")

## Individualiteti letrar i Martin Camajt


# FIGURA E GJARPRIT

**Krahas madrigalit Gjarpijtë, që është një mitemë e pastër dhe që në titull vjen e shprehur me kuptimin e plotë, janë dhjetëra poezi e madrigale të M. Camajt, në të cilat lexuesi ndesh minisubjektet e plota rrëfimesh me gjarprin si temë qendrore**

### Nehas SOPAJ

Sistemi figurativ i autorit është një. Rugëtimi i tij nga koncepti tradicional kah ai modern, në përshndërrimin e formës së shprehjes, ka baticat e ndryshimit të koncepteve, futjen e elementeve të reja, të natyrshme, që këtu edhe ndryshimin e mitit në mitemë. Në vjershën e parë me derivat të figurës së gjarprit, me titull Gjarpni, autori rrëfen një ngjarje dhe vetëm pastaj krijon vakumin logjik, mbi bazë të të cilit krijohet imazhi i nënkuptuar i figurës, pa fjalë. Figura e gjarprit të vjersha Gjarpni pa fjalë fare e nxjerr autorin në dritë me mesazhin e tij, duke e bërë këtë vetëm përmes vakumit logjik dhe paralogjik, që lexuesin e bën ta përftojë idenë se për çka është fjala. Rrëfimi është ky: Luli me Zanën, bashkë me Baco Plakun, kullosin delet në malësi. Zana e lut Baco Plakun të tregojë ndonjë ngjarje dhe Baca e rrëfen ngjarjen vijues. Dikur moti kishte pas qenë një babë, që e kishte fejuar të bijën për një vezir të pasur. Kur e kupton këtë gjë, të bijës i këputet haja, sepse ajo fshehurazi nga familja ishte besatuar me një djalë tjetër. Me të kuptuar, të rinjtë e dashuruar vendosin të takohen për herë të fundit, atë natë kur vajza do të shkonte nuse. Supozohet se djali s'e dinte se po takoheshin për herë të fundit, andaj ai i thotë vashës se kishte parandjenjë të çuditshme të ndarjes dhe klith: "Si s'delka dheut një gjarpën me na plasë". Si e dëgjon këtë toka, nga dhembja e tyre, prej gjirit të vet e nxjerr një gjarpër dhe ua lëshon në ballë të dyve dhe i helmon. Pastaj i varrosin të dy nën një çarr. I varrosin, por ndaras, sepse "të dy prej bote ishin". Ç'është bota? Në gegnisht bota është lloj dheu i ngjyrosur, një lloj toke e tëholluar e lëmuesht dhe e lagësht. (A mund të nxjerrim ndonjë kuptim tjetër, të fshehtë të autorit, në këtë drejtim? Nëse ka, çfarë mund të jetë ai?) Ky është rrëfimi i Bacës, të cilin ai e rrëfen duke e mbushur kamishin, ndërkohë që dy të rinjtë, Luli dhe Zana, i vështrojnë pikat e ujit që pikojnë. Ky është fundi i poezisë. Figura e gjarprit është mitema. Lexuesit i mbetet të nxjerrë mesazhin dhe taperceptojë figurën e gjarprit. Vakumi poetik flet për një dashuri tragjike. Mitema na shpie te balada popullore Djali gjarpër, edhe pse poezia e Camajt nuk flet për të.

Poezia tjetër, me titull Ledja, është mbase krijimi më tipik i figurës së gjarprit në poezinë e M. Camajt, që në epiqendër ka këtë figurë. Poezia është shkruar në kohën kur autori qëndronte në Itali, ndërsa në të për shumëçka sheshit shihet elementi i De Radës. Edhe pse poezi origjinale me përbërës të tjerë artistikë, ambient e artefakte personazhesh reale e imagjinare, kjo poezi me 104 vargje ika tiparet e vargënit tipik të poetit të madh shqiptar nga Maki i Kalabrisë: vargjet e shkurtra, që rrëfejnë dhe rrëfehen, dialogët lirikë dhe fjala në vetë të parë, po ashtu të heroit lirik, dhe sidomos subjekti i shtjelluar me një mënyrë pakëz më ndryshe nga standardi i autorit, e bëjnë këtë poezi fare të veçantë në poezinë e përgjithshme të M. Camajt. Vjersha, në strukturën e saj, ka një rrëfim me disa referenca epizmi, sado që ajo s'është sall një vjershë lirike. Subjekti i saj shkurtimisht është ky: letrarët tanë (shqiptarë dhe arbëreshë) u flasin të huajve (supozohet italianëve) për natyrën shqiptare. "Ju s'e dini si



vuajnë dherat tona nga vapa e cila hedh zjarr poshtë, zjarr lart." - sikur flet zëri, i cili s'dihet prej nga vjen. Don qiella frymën tonë/ që ta bajë avull me te/ për të ra shi për vise tjera! - kjo është hyrja e poezisë që e hap diagramin e rrëfimit të nënkuptuar... Fillon ngjarja, nisin të flasin në stil të personazheve të De Radës, personazhet e paemëtuara lirike; që supozohet të jenë gratë (shqiptare? arbëreshë?), gjersa papritur brafullon tema e rrëfimit: A e dini punën e Ledies?/ I pyeti letrarët dikush. Ledja, vasha shqiptare, heroina e subjektit, këndon gjersa poeti: rrin krye-peshë mbas gurit/ e veshë e ngjeshë në lëkurë gjarpni... Këtë e rrëfen dikush, këtë e dëgjojnë letrarët, kurse subjekti lirik zhvillohet rreth Mbigjarpnit, i cili: ujë kurr nuk pin/ sall tambël gjiu grueje n'gjumë, sepse: Ora - gjarpën s'pin kurr ujë! Ndërkaq, kur një letrar pyet shokët "pa rregull", pason përgjigja se si një herë Ledja, nis me nga dy xunktha në punë, ecte rrugës shpatit për në shtëpi dhe gjersa ecte i dukeshin molla gjijt, kurse Tokësi-gjarpën mori një lëpushtë gjethi e iu lëpe asaj, ndërkaq: guri n'diell nuk vezullonte dhe askush nga bujqit s'e panë. E pa shqipja si hyri në shtëpi, e pa gjarpëri si hyri në plëng dhe e priti terrin e natës. E pastaj si u fik drita e fundit e kandilit, doli Ora mbi muranë dhe iu var vashës në kraharor. Tregojnë të vjetrit se si dëgjohej një gurgullimë uji lart mbi shkëmb, ndërsa kur burrat ia nxorën gurit zemrën, ushtima u ndal. Kështu gjarpi shëtit pas gjinjve të grave, që këtu edhe pas Ledies, gjersa ajo e pa: derisa helmi idhshëm/ i kulloi nëpër dhëmbë. I ngrihet gjaku Ledies dhe e sheh: si një mbret kunorën/ e hoq Ora gurin e kresë/ e para cikës e uli/ për

t'i pague një gjak! Tremben letrarët e në agim bie një rrufe. Vijnë pastaj tre bujq e njëri rrëfen sesi kish vdekur një vashë edhe një gjarpër në lis: zbritni poshtë e shikonie/ të shkrumuem nën diell. Ky është subjekti, ngjarja ose rrëfimi. Analogjitet me poezinë Gjarpni janë të tepërta, sepse vdekja që i bashkon, sikur i përflet katarset identike. Por, ajo që do ta nënkuptojë lexuesi i kultivuar dhe me kulturë dokumentare menjëherë do ta kujtojë baladën shqiptare Djali gjarpër. Të gjitha artefaktet - Ora e dhenave, Mbigjarpni, Ora-gjarpën, Tokësi-gjarpën, Ora prej Murane ose edhe Ora pa asnjë epitet a shenjë tjetër identifikimi, flasin për figurën mitike shqiptare të metamorfozës, në të cilën ky është një gjarpër që natën kthehet në djalë të pashëm. Por, në fillim rrëfimi e kishte qëllimin gjetiu: njerëzit u tregojnë të huajve hallin se: don qiella frymën tonë/ të të bajë avull me te/ për të ra shi në vise tjera!, sepse kështu do fryma, perëndia, ndaj pason rrëfimi për Ledien dhe balada e gjarprit, që në kulturën tonë morale është e njohur në trajta të ndryshme letrare: si legjendë në vargje, si përrallë popullore, si hartim letrar për fëmijë e të rritur, vepra të ndryshme letrare gjinish dhe zhanresh nga më të ndryshmit me autorë me emër e mbiemër, prandaj edhe si kjo vjershë lirike e poetit tonë. Si edhe vjersha e parë, edhe vjersha e dyta e poetit për strukturë artistike ka zgjedhur rrëfimin me personazhe lirike. Pastaj mësojmë se poeti, në mitemat e tij, është konstant në obsesionin e quajtur gjarpër dhe prej tij do të na rrëfejë më shumë se një artefakt letrar. Lexuesi sheh tani, në këtë vjershë, një mënyrë tjetër të të kënduarit lirik. Elementi i De Radës, i shquar dukshëm

në këtë tekst, nuk na lejon të mendojmë se poeti është nën ndikim pa vlerë. Çdo lexues i kultivuar, që ia di natyrën e vërtetë poezisë së M. Camajt, mund ta dallojë dukshëm vokacionin e tjetërsuar të autorit nga rilindësi ynë, por ja që poeti, për ta begatuar sfondin e tij poetik, në stërvitjet e tij stilistike, nganjëherë bie në këto sprova, që gjithsesi nuk ia ulin vlerën dhe imazhin e artistit autonom, por përkundrazi, vetëm ia shtojnë repertorin e shkrimit që di ndryshe. Virtuoz si përherë, në sprova të këtylla, M. Camaj gjithnjë do të jetë në të njëjtën: brenda motivit folklorik di të këndojë si do vetë. Në vitet e mëvonshme, kur poeti do të piqet dhe do të fillojë t'i njohë ligjet dhe kodet e modernitetit, duke bërë sprovat e para drejt abstraksionit poetik, figura e gjarprit do të jetë artefakti i parë dhe i gjallë me të cilin ai do ta thellojë dhe zhvillojë edhe më shumë kulturën e tij letrare dhe ai s'do ta braktisë asnjëherë atë kulturë deri në fund të jetës, gjersa edhe libri i tij i fundit do ta mbajë titullin Nën hijen e gjarprit.

Janë disa poezitë autorit tonë, të cilat shprehin stadin e veçantë të poezisë së tij me figurën e gjarprit në epiqendër. Poezitë e tjera, që nxirren nga titujt e poezive, në fakt nuk janë të gjitha me temë qendrore me figurën e gjarprit, por janë elementi përbërës i tyre, hija e tyre. Shumica e këtyre poezive, që në titull e kanë elementin e gjarprit, në fakt s'kanë të bëjnë me të, pos si dekor (shih për këtë Si gjarpni nën gur, Në vend të gjarprit), kurse disa të tjera, siç është Si i gjarprit, Gjarpijt e zez, Gjarpni e fëmija, mitemën e ngjeshin në strukturën e këndimit lirik, herë si mini-rrëfim (e para), herë si këngë ritmike (e dyta) dhe si mesazh moralizimi (e treta). Krahas madrigalit Gjarpijtë, që është një mitemë e pastër dhe që në titull vjen e shprehur me kuptimin e plotë, janë dhjetëra poezi e madrigale të M. Camajt, në të cilat lexuesi ndesh minisubjektet e plota rrëfimesh me gjarprin si temë qendrore, në të cilën, ashtu si poezia e vëllimit të parë poetik të autorit, që quhet Gjarpni, figura e gjarprit është motiv dhe temë kryesore e tekstit letrar.

Më shumë sesa figura e gjarprit, M. Camaj në mënyrën më origjinale dhe më abstrakte do të rreket ta krijojë figurën e breshkës. Diçka të ngjashme si edhe Pasqyrat e Narçisit të E. Koliqit, M. Camaj te Dranja arrin ta bëjë kolizionin e një gjallesë të veçantë, siç është breshka, te e cila autori arrin ta derdhë tërë talentin e tij të skalitësit gdhendës mjeshëtor, duke krijuar disa minisubjekte herë reale e herë imagjinative. Në raste të veçanta ai bën konstruktive përzjeresh në dukje artificiale, reale dhe imagjinare, me konstruksione dokumentariteti, që lexuesin e lënë pa gojë. Kjo ia hap mundësinë e pakufishme interpretimit të lirë të këtyre krijimeve, e nganjëherë e lënë pa gojë lexuesin nga pamundësia e interpretimit, për shkak të fluiditetit dhe abstraksionit që kanë me vete ato. Një varg mitemash, që e ndërlihdhin fenomenin e qepjes së gjarprit për kafkullën e breshkës, e bëjnë lexuesin të parashtrijë pyetje të ndryshme nga sfera e fenomenologjisë ose edhe të zoologjisë të transponuar çuditërisht në literaritet.

(Nga libri më i ri i autorit, **TRINOMI POSTMODERN LETRAR SHQIPTAR, botoi Drini, Ferizaj**)



## Kongresi i alfabetit

# NJË GJUHË QË S'SHKRUHET E S'KËNDOHET, NUK ZIHET GJUHË

**Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe qe për shqiptarët një kusht i domosdoshëm për t'u bërë ballë ndikimeve asimiluese të gjuhëve dhe të kulturave të huaja**

**Dr. Asllan HAMITI**

Kongresi i njësimimit të alfabetit të gjuhës shqipe, i mbajtur në Manastir më 1908, është një nga monumentet më të rëndësishme të gjuhës, të historisë e të kulturës shqiptare jo vetëm të fillimit të shekullit XX, por edhe të shekujve të mëhershëm e të kohës së mëvonshme. Përgjithësisht është e njohur se planifikimi gjuhësor përfshin tri faza kryesore: a) alfabetizimin e gjuhës, b) standardizimin dhe c) modernizimin e saj. Në Kongresin e Manastirit (14-22 nëntor 1908) u bë standardizimi i alfabetit të shqipes, hapi i parë i domosdoshëm për të standardizuar atë (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 20-25 nëntor 1972) si dhe për të kaluar në stadin e modernizimit që nuk përfundon kurrë, të cilin e karakterizon përpjekja për ta bërë shqipen të aftë për të përmbushur nevojat e shumëllojshme të shoqërisë sonë dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës. Nëse shpikja e alfabetit merret si një ndër zbulimet më të mëdha të njerëzimit, atëherë Kongresi i Manastirit mund të vlerësohet si një ndër ngjarjet më të rëndësishme të popullit shqiptar. Njësimi i alfabetit çoi në rrugë të drejtë të gjitha zhvillimet e mëvonshme për ngritjen e vetëdijes dhe formimin e kombit, shuarjen e ndasive krahinore e fetare, hapjen e shkollave në gjuhën amtare, botimin e librave si dhe përhapjen e dijes e të kulturës.

**Njësimi i alfabeve, parakusht për bashkimin kombëtar**

Shkrimi dhe lëvrimi i gjuhës shqipe qe për shqiptarët një kusht i domosdoshëm për t'u bërë ballë ndikimeve asimiluese të gjuhëve dhe të kulturave të huaja. "Një gjuhë që s'shkruhet e s'këndohet, - thoshte Samiu, - nuk zihet gjuhë". Të folurit dhe të shkruarit në gjuhën amtare është mjet i domosdoshëm për të mbijetuar një komb. Pajtohem me konstatimin e përgjithshëm se për ne shqiptarët njësimi i alfabetit, njësimi i gjuhës dhe njësimi i kulturës sollën natyrshëm bashkimin e kombit. Njësimi (unifikimi) i alfabeve qe parakusht për bashkimin kombëtar. Përmbledhtas mund të thuhet se Kongresi i Manastirit njësoi shkrimin e shqipes, parapriu njësimin e kombit dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, përcaktoi bazën fonologjike të shqipes standarde, duke vënë gurthemelin e saj; dobësoi përçarjen krahinore dhe politikën asimiluese, zgjoi dhe fuqizoi vetëdijen kombëtare, dëshmoi se jemi një komb, që kemi një histori, një gjuhë dhe një alfabet. Siç dihet, shkrimi i shqipes ka një traditë mbi 550-vjeçare (së paku nga Formula e Pagëzimit, 1462 e deri më tani). Deri para Kongresit të Manastirit, shqipja u shkrua me abc-ë të ndryshme, kryesisht me katër alfabe: me alfabetin latin të përshtatur sipas autorësh e krahinash; me alfabetin arab, me alfabetin grek dhe me alfabetin cirilik. Veriu, përkatësisht shkrimtarët e vjetër përdornin alfabetin latin (të plotësuar me disa shkronja cirilike). Bejtexhinjtë përdornin alfabetin arab (si Muhamet Çami, Dalip e Shahin Frashëri etj.). Në jug përdorej alfabeti grek (Thimi Mitko, Konstantin Kristoforidhi), por



ka edhe pak shkrime shqipe me alfabet cirilik [Gjergj Pula (a Gjorgji Pulevski) e ndonjë tjetër]. Ka pasur raste edhe kur i njëjti autor ka përdorur dy alfabe: bie fjala, Konstantin Kristoforidhi kur shkruante toskërisht përdorte alfabetin grek, ndërsa në shkrimet në gegërisht përdorte alfabetin latin. Alfabeti i Stambollit (1879) që kishte 36 shkronja ishte i përzier (me shkronja latine, greke e disa shkronja të veçanta). Ai u përhap në Shqipërinë Jugore e të Mesme, sidomos nëpërmjet librave të Naimit, Samiut, Vretos etj., por u përdor edhe në kolonitë shqiptare të Rumanisë e të Bullgarisë. Alfabeti i shoqërisë "Bashkimi" kishte për bazë alfabetin latin të plotësuar me disa dyshkronjësia si edhe i shoqërisë "Agimi" me qendër në Shkodër që po këshuto për bazë kishte alfabetin latin të plotësuar me shkronja të alfabetit cirilik e glagolik, por edhe me disa shenja diakritike (shenja plotësuese të vëna mbi ose nën shkronjë). Pati edhe përpjekje për hartimin e alfabeve origjinale, siç ishte ai i Naum Veqilharxhit (prej 33 shkronjash), Hoxhë Tahsinit, Vasil Rusos etj. Përdorimi i disa alfabeve të ndryshme po rrezikonte ta thellonte më tej përçarjen midis shqiptarëve në një kohë kur kishte nevojë për bashkim kombëtar dhe çlirim nga sundimi shumëshekullor osman. Ky shkrim i shumëllojshëm i shqipes përbente problem serioz: veprat e shkruara lexoheshin vetëm nga një grup i kufizuar njerëzish brenda një krahine të caktuar që dinin të këndonin atë shkrim. Procesin e izolimit, të ndarjes krahinore e gjuhësore; të gërshtuara edhe me ndikimet e huaja fetare e kulturore dhe përgjithësisht të përpjekjes për asimilimin e shqiptarëve, po e përshpejtonte edhe larmia grafike e shqipes. Duke e hetuar këtë rrezik të

zhbërjes kombëtare, mendjet e ndritura përgatitën, thirrën e mbajtën me shumë sukses një Kongres mbarëkombëtar në Manastir, me të cilin u ndërpre procesi i divergjencës ndër shqiptarët dhe u fuqizua përgjithmonë procesi i konvergjencës

**Përcaktimi i inventarit fonologjik**

Nismën për mbajtjen e Kongresit e mori klubi shqiptar "Bashkimi" i Manastirit. Kongresi u ftua me moton: "Jo me pushkë e barut, por me penë e me letra!" Bashkimi i alfabeve do të thotë bashkim i kombit. Me këtë themelohet e ardhmja e kombit. Zgjedhja e sistemit të shkrimit është problem simbolik. Shndërrimi i gjuhës në simbolizëm është një detyrë shumë e vështirë. Në shkrimin e gjuhëve, grafemat paraqesin fonemat apo tingujt themelorë të ligjëritimit. Tërësia e fonemave zanore e bashkëtingëllore të një gjuhe përbën inventarin vokalik dhe konsonantik të saj. Inventari i fonemave dhe kundërvëniet (opozicionet) që kanë ndërmjet tyre formojnë sistemin fonologjik të gjuhës përkatëse. Sistemet fonologjike të gjuhëve, dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve dallojnë midis tyre jo vetëm nga numri i fonemave që përfshihen në to dhe nga raportet që vendosen mes fonemave të një sistemi, por edhe nga substanca fonetike e tyre. Inventari i fonemave zanore përcaktohet në bazë të zanoreve në rrokje të theksuar. Siç dihet, fonemat ekzistojnë në formën e varianteve kombinatorë, pozicionale, krahinore, individuale e stilistike. Puna e parë dhe shumë e vështirë për alfabetizimin e gjuhës është përcaktimi i inventarit fonologjik të saj. Hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes me punën e tyre dëshmuar se kanë pasur përgatitje

të lartë gjuhësore (linguistike). Struktura fonologjike e shqipes standarde me 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore u përcaktua në thelb që me alfabetin e Shoqërisë së Stambollit dhe u ruajt me alfabetin e Manastirit. Ata me 36 shkronjat përcaktuan njëkohësisht edhe inventarin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes standarde (36 fonema), prandaj mund të thuhet se njëkohësisht vunë edhe gurthemelin e gjuhës standarde shqipe. Në këtë artikull do të trajtojmë mënyrën e zgjidhjes së drejtë të disa çështjeve fonetike, fonologjike e shkrimore me të cilat u përcaktua baza fonologjike e shkrimore e shqipes standarde. Pra, me standardizimin e alfabetit u përcaktua edhe baza fonetike e fonologjike e shqipes standarde. Kundërvënia fonologjike e gjatësisë së zanoreve të gegërishtes nuk u normëzua, d.m.th. u pranua vetëm gjatësia fonetike e zanoreve, duke e shënuar çdo zanore vetëm me një shenjë, pavarësisht nga gjatësia e tyre. Fonemat zanore hundore (që përdoren në shumicën e të folmeve geqe, për shkak të kundërvënies kuptimore ose gramatikore të zanoreve gojore me gjegjëset e tyre hundore te disa çifte fjalësh) nuk u normuan si veçori fonologjike e standardit, rrjedhimisht edhe nuk krijuan shkronja të posaçme për to. Mbështetje të drejtë gjuhësore u gjet edhe në dallimin ndërmjet fonemave dhe varianteve kombinatorë e pozicionale të tyre. Për fonema u morën vetëm tingujt themelorë që kanë vlerë fonologjike, gjegjësisht vlerë kuptimore ose gramatikore në ligjërim. Në Kongresin e Manastirit u përcaktuan edhe shkronjat <rr> e <h> për të shënuar fonemat /r/, /h/ edhe pse në të folmet e toskërishtes bashkëtingëlloja e parë ishte dhe është zbutur në /r/, ndërsa /h/-



ja ka përdorim të kufizuar; ndërkaq në të folmet e gegërishtes këto dy fonema ruhen mirë.

#### Disa shpjegime dhe arsytimi i tezave

Nuk u krijuan shkronja të veçanta e as shenja diakritike për të shënuar gjatësinë e zanoreve, duke ngritur në normë gjatësinë fonetike të zanoreve. Siç dihet, në pikëpamje fonologjike për nga gjatësia toskërishtja ka vetëm një seri fonemash zanore, ndërsa gegërishtja ka dy seri: zanore të shkurtra dhe zanore të gjata. Në aspektin fonetik, të folmet e Veriut në rrokje të theksuar kanë zanore të gjata, zanore me gjatësi të mesme dhe zanore me gjatësi të shkurtër. Kongresi i Manastirit nuk normëzoi kundërvënien fonologjike të gjatësisë së zanoreve të gegërishtes, d.m.th. u mor për bazë vetëm gjatësia fonetike e zanoreve, duke e shënuar çdo zanore vetëm me një shenjë, pavarësisht nga koha e nevojshme për shqiptimin e tyre. Të kihet para sysh se autorët e Veriut në shkrimet e tyre përdornin shenja diakritike për të dalluar zanoret e gjata nga gjeçjësjet e tyre të shkurtra: ose duke shënuar një vizë mbi zanoren ose duke dyzuar të njëjtën zanore (ā, aa). Të kihet para sysh se të gjitha të folmet e dy dialekteve kanë pasur e kanë bashkërisht një inventar prej 22 fonemash zanore.

Me Kongresin e Manastirit u vendos që gjuha standarde shqipe të ketë vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema, të cilat shkruhen me shtatë shkronja të posaçme njëshe: <a, e, ë, o, i, y, u>. Kur i krahasojmë të folmet e dy dialekteve të gjuhës shqipe vërejmë se të folmet geqe kanë inventar më të pasur fonemash zanore (deri më 19) sesa të folmet toske (prej 6-7), sepse të parat kanë tri seri: zanore të shkurtra, zanore të gjata dhe zanore hundore, ndërsa të dytat kanë vetëm serinë e zanoreve gojore. Në të vërtetë, edhe në të folmet e gegërishtes mbizotëron gjatësia fonetike e tingujve, por në një numër të konsiderueshëm fjalësh ende ruhet gjatësia fonologjike. Gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzjerje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë fonetike.

Fonemat zanore hundore nuk i pranuan rrjedhimisht edhe nuk krijuan shkronja të posaçme për to. Dihet se të gjitha të folmet e të dy dialekteve bashkërisht kanë 22 fonema zanore (8 të shkurtra, 9 të gjata dhe 6 zanore hundore). Në arealet e shqipes numri i tyre sillet prej 6 deri më 17 fonema zanore. Edhe

përkundër kësaj, në Kongres u caktua përmes shkronjave që shqipja letrare të ketë vetëm një seri zanoresh gojore të përbërë nga shtatë fonema. Edhe në sistemin bashkëtingëllor numri i fonemave në të folmet e shqipes është e larmishme, përkatësisht në të folme të veçanta numri i tyre sillet prej 30 deri më 26 fonema. Mirëpo, sipas shkronjave del se në Kongresin e Alfabetit u përcaktua që shqipja letrare të ketë 29 fonema bashkëtingëllore. Zgjidhje të drejtë gjuhësore në Kongresin e Alfabetit pati edhe dallimi ndërmjet fonemave dhe varianteve kombinatorë e pozicionale të tyre. Për fonema u morën vetëm tingujt themelorë që kanë vlerë fonologjike, gjeçjësish të vlerë kuptimore ose gramatikore në komunikim.

Përgjithësisht, në funksionin dallues mbështetemi për të përcaktuar fonemat e një gjuhe. Dy tingujshërbejnë si fonema të ndryshme, nëse dallojnë veshjet tingullore të dy fjalëve të ndryshme; në rast të kundërt, këta dy tinguj janë realizime të së njëjtës fonemë. P.sh. /l/ dhe /ll/ në shqipe janë dy fonema të ndryshme, sepse dallojnë çifte të veçanta fjalësh, si lak ~ llak, plakë ~ pllakë, mall ~ mall etj. Por në gjuhë të tjera [l] dhe [ʎ] janë realizime të ndryshme të një foneme të vetme. P.sh., në anglisht [l] del para zanoresh, si te lake [leik] "liqen", kurse [ʎ] para bashkëtingëlloresh dhe në fund të fjalës: milk [mɪlk] "qumësht", hill [hɪl] "kodër".<sup>2</sup> Edhe në maqedonisht [l] dhe [ʎ] (l) janë variante kombinatorë të një foneme të vetme, sepse [l] përdoret para zanoreve të përparme [e, i] (khs. leto, lesen; list, livada), ndërsa [ʎ] në rrethime të tjera fonetike (përveç para [u]-së ku përdoret [q]), si lamba, lov; por qubov [ljubov]. Duke u mbështetur në kundërvënien fonologjike me të drejtë janë përcaktuar si fonema më vete, rrjedhimisht duke i shënuar me shkronja të posaçme zanoret /i/ ~ /y/, mbështetur në kundërvënien e mungesës ~ pranisë së buzorëzimit në disa çifte minimale fjalësh, të tipit si ~ sy, ti ~ ty, mik ~ myk, rimë ~ rrymë etj. Studimet dialektologjike dëshmojnë se gegërishtja e ruan kundërvënien fonologjike të bashkëtingëlloreve dridhëse /r/ ~ /rr/, ndërsa toskërishtja këtë kundërvënie e ka rrafshuar. Së këndejmi, mund të thuhet se Komisioni hartues i Alfabetit me të drejtë fonemën /rr/ kanë vendosur ta shënojnë me shkronjë të veçantë, duke u mbështetur në statusin e fonemës së veçantë që ka kjo shumë dridhëse në sistemin fonologjik të gegërishtes. Kjo më së miri mund të vërehet në çifte minimale fjalësh, si: ara ~ arra, ruaj ~ rruaj, var ~ varr etj. (Shih hartën 22 të

Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe I, Napoli, 2007). Në të folmet e dialektit Verior [h]-ja dëgjohej mirë, ndërsa në ato të Jugut shqiptohet si më e dobët ose nuk dëgjohej fare. Bashkëtingëlloret glotale, shtegore, e shurdhët [h] dëgjohej mirë në të folmet e gegërishtes (përveç në të folmen e Dibrës e në ndonjë tjetër), ndërsa në të folmet e toskërishtes shqiptohet me frymëzim (aspirim) më të dobët shkallësh të ndryshme ose nuk dëgjohej fare, me gjithë kufizimet në përndarjen e saj (diku nuk shqiptohet në asnjë pozitë të fjalës, diku nuk shqiptohet në fund e diku në mes të fjalës). Pra, edhe shkronjën <h> hartuesit e alfabetit të sotëm të shqipes kanë shumë të drejtë që e kanë përfshirë në sistemin shkrimor të shqipes. Gjuha shqipe për shkrimin e saj përdor alfabetin latin të përshtatur sipas inventarit fonematik vetanak. Alfabeti i latinishtes u bë bazë e alfabeve të shumë gjuhëve. Gjuha e më se 36 popujve të Evropës dhe i shumë të tjerëve jashtë këtij kontinenti shkruhet me alfabetin latin të përshtatur në mënyra të ndryshme. Shkrimi fonologjik bazohet në parimin e bashkëlidhjes së një fonemeje me vetëm një shkronjë, por ky është vetëm ideal, sepse në realizim asnjë sistem konvencional i shkrimit nuk është konsekuent dhe plotësisht fonematik.

#### Përparësitë e ABC-së së shqipes

Në qoftë se vlerësojmë sistemin grafik të shqipes nga pikëpamja e parimeve të përgjithshme, mund të thuhet se ai është nga më të thjeshtët (krahasuar me abc-ën e gjuhëve të tjera) dhe ka zgjedhur mjaft drejt problemin e shkrimit të gjuhës sonë: 36 fonemat e shqipes shënohen me 36 shkronjat e alfabetit, që përbëhen nga 25 shenja të thjeshta, 9 dyshkronjësja dhe dy shkronja me shenja diakritike (plotësuese, shtesë). Po të krahasojmë shkrimin e shqipes me disa gjuhë të tjera, ABC-ja e shqipes ka disa përparësi. Kështu, anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj., kur paraqesin alfabetin e tyre, rendisin 26 shkronjat e alfabetit latin, por kombinimet e grafemave për të shënuar fonema të veçanta nuk numërohen si shkronja më vete. Anglishtja, p.sh. si gjuhë mjaft e përpunuar, në shkrim ka disa mangësi, sepse për të shënuar 40 tingujt themelorë të saj përdor mbi 200 kombinime shkronjash.

Përkundër këtyre mënyrave të shkrimit të ndërlikuar, gjuha shqipe, për t'i shënuar 36 fonema, përdor 36 shkronja. Nga kjo pikëpamje në vija të përgjithshme në hartimin e alfabetit

të shqipes është respektuar parimi themelor i grafisë, që e njëjta fonemë të paraqitet në të gjitha rastet vetëm me një shkronjë të veçantë (të thjeshtë ose dyshkronjës), me disa përjashtime.

Përdorimi i shkronjave dyshe ka të mirat e veta, ngase me një numër më të vogël shenjash, përkatësisht me 27 shenja të thjeshta (kuptohet dhe me 9 çiftet e tyre) paraqiten 36 fonemat e gjuhës sonë. Por, kjo ka edhe të meta, sepse: 1) dyshkronjështat zgjatën tekstin e shkruar; 2) krijojnë mundësi që disa çifte shkronjash të lexohen në dy mënyra, d.m.th. si digrafe dhe si shkronja të veçanta që vijnë njëra pas tjetrës, p.sh. lagje, lagja ose lag'je, lag'ja; rënje, rënja ose rën'je, rën'ja (në rastet e këtilla për t'u lexuar drejt, për fonemën /j/ shkruhet <i>); Mithat ose Mit'hat; meshollë ose mes'hollë, gazhedhës ose gaz'hedhës etj. Për t'u ruajtur shqiptimi i veçuar i pjesëve përbërëse të dyshkronjësive dhe për t'u shmangur leximit të gabueshëm si 354 Studime 26 njëshkronjës, Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe propozon që shkronjat e veçanta të ndahen me apostrof, si: i herëpas'herëshëm, mes'hollë, mos'hapje, mos'hyrje, dis'harmonji; shtat'hedhur; brez'humbur, gaz'hedhëse; Bet'hoven, Et'hem, Mit'hat etj. Në të dyshkronjështat janë numerikisht një e katërta e alfabetit të shqipes. Në dukje kjo është një ngarkesë e madhe. Por sipas studimeve statistikore të nëntë shkronjat zënë 6-7% të tërësisë së shkronjave në një tekst të lidhur; me fjalë të tjera, në çdo njëqind shkronja të një teksti, vetëm 6-7 shenja janë dyshkronjësja.

(...)

Në Kongresin e parë për kodifikimin e alfabetit u përcaktua që shqipja të ketë shkrimin më të përsosur, më të përhapur, më të lehtë e më praktik; pra shkrimin fonetik, më mirë të themi fonologjik. Në këtë lloj shkrimi çdo fonemë jepet me një shkronjë të veçantë, kështu që numri i shenjave është i vogël. Kjo zgjidhje e këtille e grafisë gjen mbështetje edhe në praktikën e shtypshkrimit të tekstit shqip. Alfabeti i thjeshtë latin është omogjen për nga karakteri i shkronjave, i lehtë për t'u shkruar dhe shumë i volitshëm në shtyp. Nuk kërkon shtypshkronja me shenja të posaçme. Me shkronjat e alfabetit tonë u përcaktua edhe baza fonologjike e shqipes së përbashkët kombëtare, dikur që quhej gjuhë letrare e tani shqipe standarde. Alfabeti i përbashkët dhe i ndërtuar drejt hapi rrugën për një emancipim kulturor, për një drejtshkrim të përbashkët dhe për një gjuhë standarde për të gjithë shqiptarët, siç e kemi sot. (Studime)

Vlerësim

# MBI REBELIMIN DHE TRIUMFIN FIKTIV

(Rreth librit "Rrëfimi i një mbreti" (dy monodrama), të autorit Avni Halimi, botuar nga SHB "Drini", Ferizaj, 2024)

**Nga Fehmi AJVAZI**

1. Konteksti shkrimorë i të gjitha gjinive letrare, pas rënies së sistemit komunist në vendet e lindjes komuniste (përfshirë edhe hapësirat shqiptare), u fokusua në ridizajnimin e shkrimit si për nga stili dhe struktura, po ashtu edhe për nga motivet, trajtimet, personazhet etj. Ndërsa ranë maskat komuniste, përtej të cilave shtrihej njëmendësia shoqërore dhe e sistemit politik, u kuptua se po përtej tyre rendi shoqëror dhe qytetar, ishte zhvilluar mbi një rend kaosi brenda të cilit shteti dhe pushteti kishte qeverisur si kishte dashur. Normat e rendit komunist, që prej atij moral e deri te ato ligjore, kishin qenë një fasadë e zhvillimit nën diktat, dhe sipas vullnetit të një pakice bastarde. Krahas kësaj, ndryshimi shoqërorë dhe politik në vendet postkomuniste, ende nuk është i standardizuar në plotëni dhe demokracia si sistem, vuan ende pasojat e ndryshimeve dhe mungesën e energjisë së bollshme për t'i tejkaluar dhimbjet, traumat, dhe pasojat e së kaluarës. Të gjitha këto që i shkoqitëm më lartë, janë kujtesë dhe motive të atyre që si vokacion kanë shkrimin, historinë, artet dhe letërsinë etj. Të konsideruar dhe të njohur si "ndërgjegjja" e shoqërisë, krijuesit e zhanreve të ndryshme vazhdojnë të rikrijojnë "tablotë" e së shkuarës, për të qenë ato jo vetëm dëshmi, por edhe mesazhe të të sotmes dhe të së ardhmes! Mijëra e mijëra vepra të ndryshme artistike, letrare, kinematografike, teatrore etj., janë edhe më tutje fokus i krijimtarisë mendore dhe artistike të autorëve të ndryshëm që vijnë nga vendet post komuniste.

2. Avni Halimi, poet, gazetar, tregimtar, dramaturgetj., është një ngashkrimtarët e njohur që nuk i ka munguar energjia, mjeshtëria dhe guximi për ta shprehur e ndërtuar krijimtarinë e tij, duke pasur si motiv të kaluarën: kujtesën dhe rrjedhën historike të identitetit shoqërorë dhe nacional. I njohur si gazetar dhe poet, mjeshtër i ndërtimit dhe avancimit të kulturës dhe të letërsisë moderne avangardiste, Avniu shquhet edhe si mjeshtër i rrëfimit – tregimit, njësoj edhe i dramës. Nuk ka dyshim prandaj, që konteksti motivues dhe shkrues i tij, buron gjithandej nga sferat e zgjedhura të stilit krijues, tematikës, mënyrës së trajtimit etj. Jo vetëm në poezi, motivet dhe stili e dallojnë atë nga bashkëkohanikët dhe rendi krijues në kulturën dhe letërsinë shqipe. Në sferën e tregimit, Avniu po ashtu, dallohet veçanërisht për mënyrën e gjetjes së temave dhe shtjellimit të tyre! Në krijimet e tij, zë vend të qartë aspekti socio-shoqërorë, struktura e shkëlqyeshme artistike – letrare, si dhe dimensionet psikologjikë e filozofikë.

Pse duhet zberthyer profilin krijues të shkrimtarit, goftë edhe me dy-tri paragrafë? Mendoj se kundrejt veprës së caktuar, janë të duhura pasqyrimet e ndryshme, kjo për të pasur një imazh



më të qartë rreth përmbajtjes së veprës, mënyrës së trajtimit, si dhe rëndësisë së saj. Shkrimi i kthyer në vepër të caktuar, nuk bëhet as nga kushdo dhe as në mënyrë të thjeshtë. Për shembull: mund t'i shkruajë ndokush disa mijëra faqe dhe disa dhjetëra libra, por për nga rëndësia dhe kohezioni, të gjitha mund të jenë zero!

3. Vepra "Rrëfimet e një mbreti", që në vete ngërthen dy monodrama shumë origjinale për nga motivi dhe tejet intriguese për nga trajtimi, kam përshtypjen që si rrallë ndonjë vepër tjetër, shprehë integritetin dhe nivelin e lartë krijues të autorit Avni Halimit. E para, për nga motivi, po ashtu origjinal, që e ka burimin nga një botë më të hershme të njerëzimit ("KHIMI I JUDES") si dhe nga bërthama e njerëzimit që është familja, në rastin konkret, familja shqiptare e luhatur në mes të traditës, fanatizmit dhe manipulimit me namnin tradicional të të parit të familjes ("RRËFIMI I NJË MBRETI"). Dhe e dyta, për nga struktura dhe përmbajtja, këto dy tekste nga zhanri i monodramës, kanë një shtrirje kohore prej skajit të motivit mitik-biblikë e deri te skaji i motivit (pseudo)kanunor. Mbi këto shtylla që e diktojnë kornizën e tërësishme të dorëshkrimit, Halimi

ia ka arritur ta shtjellojë një kohë që ishte e sunduar nga personazhe të cilët, sa ishin autoritar, po aq ishin idiotë, shfrytëzues dhe torturues të individit dhe shoqërisë. Mund të konstatojmë pa mëdyshje se, regjimet autoritare-totalitare, siç ka qenë edhe regjimi komunist, i kanë përdorur levat e sigurisë për të mbajtur të kontrolluar çdo mendim dhe shprehje të lirë, dhe për ta mbajtur të kontrolluar shoqërinë apo edhe familjen si njësi elementare e shoqërisë. Duke i zberthyer pushtetet e këtyllë, madje pavarësisht edhe nga sistemi, Avni Halimi na e zberthen deri në absurd figurën e "individit" idiot, batakçinj, totalitar, pa integritet, pa pikë morali dhe të zhytur deri në fytyrë në botën e interesit personal. Rrallë takon në historinë e shkrimit figurën e një personazhi që është i zhveshur totalisht nga karakteri, nga personaliteti, me një fjalë nga qenësorja si personazhi kryesorë i kësaj vepre, për të cilin flasin si Librat e Shenjtë, ashtu edhe rrëfimet popullore por edhe aktualiteti ynë në botën e deformuar nën thjerrën e disa kodeve pseudo-kanunore.

4. Avni Halimi, krijon skena gjeniale-dramatike në zberthim e sipër të figurës së Judë Iskariotit. Ky, Juda (personazh biblik), në çastet kur duhet t'i kthehet

eshtrave të vet, njerëzimit ia kërkon varrin. Juda nuk pranon të ngelë i vetmi personazh kaq me "famë" ndërsa të mos e ketë varrin në asnjë cep të botës. Me shpejtësi imagjinare, brenda tri ditëve, i bie rreth e rrotull botës dhe, në mesin e njerëzimit sheh lloj-lloj Judash, madje edhe më të rrezikshëm se vetë Judë Iskarioti. Ky, Juda pra, i lutet njerëzimit që tradhtarët e regjur mos t'i quajnë "Judë", sepse, tradhtia e tyre shkon përtej asaj të Judës, i cili, krejt në fund, sipas rrëfimit, përveç që ishte më rebelues në asgjë tjetër nuk dallonte nga dishepujt e tjerë. Ai, thjesht, në rrëfimin fiktiv, nuk pajtohet që deri te liria dhe paqja të arrihet me durim e të pajtohet njeriu me fatin që ia ka caktuar Krijuesi, porse, lirinë ai e sheh vetëm si produkt të rebelimit dhe triumfi mbi imperatorin, me regjimin, mbi pushtuesin, mbi okupatorin! "Të gjithë i bindeshim fjalës së Jezusit. Ai insistonte në respektim të këtij pushteti të brishtë, sepse, së shpejti në mesin e njerëzimit do të vije pushteti i Zotit. Ushtarët e mi e prisnin urdhrin tim, ndërsa unë e prisja urdhrin e Birit të Zotit. Në darkën e fundit, pasi e paralajmëroi çastin e vdekjes së vet, m'u drejtua mua me një ton urdhërues e me plotë pezëm: "Ti, kryeje punën tënde!"

Mësuesit e Ligjit dhe roja e Tempullit kishin vendosur të ngrisin dorën mortale kundër Hyjit. Do me thënë, as që ndërmendeshin për t'iu bindur vullnetit të Zotit. Atëherë, unë u ngrita nga tavolina dhe dola që t'i mbledh njerëzit e mi, të cilët, një për një, ishin të gatshëm të vdesin që në krye të vinte Pushteti i Hyjit."

Në Monodramën "Rrëfimi i një mbreti", Halimi trajton fatin tragjik të shumë brezave që ranë pre e manipulimin në emër të të parit kanunist! Personazhi, Liraku, luhetet në mes dy botëve: në mes çmendisë së vet dhe në botën reale në të cilën gjendet vetëm brena forcës së vet psikike. Liraku, një student i artit dramatik që ka studiuar në Paris, pas një sëmundje kthehet në një lagje provinciale në Shkup, te prindërit, te nëna e vet e rraskapitur dhe te babai që edhe ai jeton në mes dy botëve: në botën e mendjes së tij të sëmurë dhe në botën e lakmisë që e arrijnë duke e keqpërdorur respektin familjar ndaj të parit! Babai është përtej kodeksit moral e familjar të një prindi tradicional shqiptar; i zhytur në botën e vet primitive e të sëmurë. Është i egër e i vrazhdë, i dhunshëm e manjak, në këto sjelle diku Liraku arrijnë kulmin e çmendisë, të cilën e tejkalon sa herë që i kujtohet Zoga, e dashura e tij. Liraku i humb të gjithë, një nga një dhe, vetë përfundon në çmendi. Ka vetëm një afinitet të pazbërthueshëm, është mjeshtër i shahut, ndërsa gjithnjë humb sepse i frikësohen fitoret! "Të gjitha fitoret janë të tmerrshme. Humbjet të mbajnë të gjallë. Të mbajnë pranë atyre që i do e që të duan. Të humburit nuk ju frikohen humbjeve. Jetojnë me shpresa që nuk i kanë fitimtarët. Presin ngritjen. Të ngriturit jetojnë me frikë. Nga lart e shohin fundin. I tmerrshëm është fundi i tyre. Humbja është e mirë. Unë humba gjithçka. Tani pres ditën kur do t'i gjejë të gjithë. Fitimtarët presin ditën kur do të humbin gjithçka."

*Nga Arkivi*

# KRIJUES E STUDIUES NËN LLUPËN E TOTALITARIZMIT

**Gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, sidomos pas vitit 1970, politika gjuhësore kishte një ndikim të madh në formimin e identitetit kombëtar dhe kulturor, sidomos në kontekstin e Kosovës, ku ndikimet nga Shqipëria ishin të pranishme dhe të forta**



## **Nga Avni HALIMI**

Në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore, regjimi komunist nisi të aplikojë një kontroll të rreptë mbi çdo fushë të jetës publike, përfshirë shkencën dhe kulturën. Politikën gjuhësore ishin një mjet për të ruajtur një narrativë të caktuar kombëtar dhe ideologjik, duke favorizuar një version të gjuhës dhe kulturës që ishte në përputhje me parimet soc-realistë. Me Kongresin e Drejtshkrimit si dhe të standardizimit të gjuhës letrare, mbajtur më vitin 1972, u vunë konturat e kësaj politike si dhe tashmë zyrtarisht do të nisë "gjuajtja e shtrigave"! Standardizimi i gjuhës letrare gati se u bë kusht i të gëzuarit të epitetit patriot. Ata që kundërshtonin apo kishin më të vogël pakënaqësi me ngritjen e kësaj politike, sakaq marginalizoheshin, etiketoheshin (në Kosovë) dhe internoheshin apo burgoseshin (në Shqipërinë).

### **"Shtigjet propagandistike" nga Kosova**

Intelektualët që ofronin ide që ishin në përputhje me një linjë më të hapur, të avancuar ose që ishin kritike ndaj politikave zyrtare, ishin shpesh të etiketuar si "avangardë", "hermetikë" ose si figura që vepronin "përtej linjave kombëtare". Kjo ishte një taktikë për të marginalizuar dhe për të përjashtuar ata që mund të sfidonin autoritetin e regjimit, i cili ishte bërë garancë e konkluzioneve nga Kongresi i '72-shit. Duke i dhënë një emër negativ këtyre individëve, regjimi mundohet të minonte autoritetin e tyre dhe të pengonte ndikimin e tyre në opinionin publik. Diskursi për gjuhën dhe identitetin kombëtar ishte shumë i rëndësishëm, sidomos në një kontekst ku shqiptarët e Kosovës përballeshin

me politika asimiluese nga jugosllavët. Intelektualët që argumentonin për një standardizim më të lartë të gjuhës shqipe, që nxinin përdorimin e dialekteve dhe që kërkonin njohjen e diferencave kulturore dhe gjuhësore, shiheshin si kërcënim ndaj unitetit kombëtar të promovuar nga regjimi. Këtë qasje e kishin sidomos ndaj shkencëtarëve gjuhësorë të Kosovës.

Regjimi zyrtar i kohës dëshironte që të forcohej edhe më shumë, duke i mbyllur të gjitha "shtigjet propagandistike" që mund të vinin nga Kosova. Nga ana tjetër, forcimin e vet e shihnin edhe duke e shtrirë ndikimin të shqiptarët e viseve etnike. Me këtë përpjekje si dhe me qëndrimet etiketues ndaj të gjithë atyre që nuk pajtoheshin me frytet dhe vlerat e regjimit, përçohej një mesazh tek shqiptarët përtej kufijve administrativ: të gjithë ata që dëshirojnë të ngelin shqiptarë duhet të pajtohen dhe ta përqafojnë regjimin! Nuk ishin të paktë intelektualët dhe studiuesit që kërkonin të sjellin një qasje më moderne dhe shkencore ndaj politikave gjuhësore, duke u mbështetur në teoritë moderne të linguistikës dhe antropologjisë (Skënder Riza, Arshi Pipa, Martin Camaj, Rxhep Ismaili etj.). Kjo përbente një sfidë për strukturat tradicionale dhe dogmatike të mendimit që promovoheshin nga regjimi. Prandaj, ky lloj intelektualësh u etiketuan nga Sigurimi, u ndoqën e u përndoqën, u shpallën armiq të popullit!

Regjimi komunist shqiptar nuk ishte edhe aq naiv për sa i përket ruajtjes dhe përfortimit të sistemit. Kishte ngritur një rrjet bashkëpunëtorësh, spiunësh e oficerësh dhe tashmë dihej edhe sekreti më i imët në mes të bashkëshortëve. Detyrë e këtij shërbimi, veç tjerash ishte edhe shpërndarja e çdo qëndrim, vendimi e përpjekje shtetërore për ta ndërtuar një identitet bashkëkohor kombëtar

gjithandej viseve etnike, sidomos në Kosovë, dhe, nga ana tjetër, kishte për detyrë që rreptësisht të kontrollohet, të censurohet e të përshtatet çdo gjë që futet nga Kosova në Shqipëri. Intelektualët shqiptarë nuk duhej të indoktrinoheshin nga "intelektualët kosovarë"! Ky ishte qëndrimi i prerë i regjimit!

Pra, informacioni ishte i kontrolluar dhe shpesh herë i manipuluar me qëllim për t'i shërbyer interesave të regjimit. Çdo lëvizje intelektuale që përbente një alternativë, për regjimin ishte potencialisht e rrezikshme dhe prandaj duhej të shënohej, të marginalizohej dhe të neutralizohej si "aktivitet armiqësor".

### **Soc-relizmi si "religjion kombëtar"**

Pra, pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria do të ndërtohet si një shtet komunist që do të dominohet, sidomos në kulturë, nga ideologjia soc-realistë. Politikën kulturore ishin të drejtuara nga një elitë që kontrollonte çdo aspekt të jetës shoqërore dhe kulturore, duke u angazhuar për të ruajtur një narrativë të caktuar ideologjik. Sigurimi i Shtetit, si instrument kryesor i kontrollit, kishte për detyrë të monitoronte, raportonte dhe ndëshkonte çdo lëvizje që mund të dukej si kërcënim për regjimin. Kjo, jo se bëhej aq nga bindjet e paluhatshme të intelektualëve ndaj vlerave të regjimit, por, mbi të gjitha, për ta ruajtur veten, familjen, për t'i ruajtur privilegjet që i gëzonte elita nga regjimi, i cili kërkonte që soc-relizmi të ngrihej në "religjion shqiptar"! Në këtë kontekst, besnikët e Sigurimit luajtën një rol kyç. Ata ishin individë që, nga frika ose ambicia, u angazhuan për të denoncuar çdo aktivitet kulturor që mund të dukej si deviacion nga linjat zyrtare. Ky proces shpesh herë kishte forma groteske, ku intelektualët e njohur

dhe artistët e talentuar ishin subjekt i ndjekjes dhe etiketimit si "elementë subversivë". Ata individë që manifestonin besnikëri të devotshëm ndaj regjimit, ata shtyheshin, ngriheshin, imponoheshin si vlera të padiskutueshme kombëtare! Ka plot syresh që, ndonëse dikur ishin "vlera të shenjta kombëtare", sot jo që nuk njihen por as që i kujton dikush!

"Gjuetia e shtrigave" simbolizonte këtë atmosferë të frikës dhe pasigurisë. Autoritetet dhe besnikët e Sigurimit e shndërruan artin dhe kulturën në një fushë të rrezikshme, ku çdo ide e re mund të përfundonte me arrestimin e autorit. Intelektualët që kërkonin të artikulojnë mendime ndryshe, ose që guxonin të sfidonin normat e vendosura, ishin shpesh subjekt i presioneve dhe ndëshkimeve të ashpra. Politikën e etiketimit ishin të sistematizuara. Intelektualët e etiketuar si "avangardë", apo "hermetikë", apo "përhapës të vlerave imperialiste" ishin të detyruar të përballeshin me pasoja të rënda e antinjerëzore. Shumë prej tyre u izoluan, duke humbur mundësinë për të kontribuar në kulturën kombëtare. Të tjerët, jashtë kufirit të shtetit amë, u etiketuan si "jugosllavë", e "armiq të popullit shqiptar". Ata intelektualë shqiptarë të viseve etnike shqiptare të cilët etiketoheshin nga Sigurimi dhe regjimi shqiptar, me automatizëm konsideroheshin "tradhtarë" nga shqiptarët autoktonë. Kjo krijoi një mjedis ku frika ishte më e fortë se dëshira për t'u shprehur, duke bërë që shprehja kulturore të ishte në një gjendje të censuruar dhe të varfër. Në këtë kontekst, politika gjuhësore dhe etiketimet ndaj intelektualëve në Shqipërinë komuniste ishin një refleksion i një regjimi që kërkonte të kontrollonte çdo aspekt të jetës shoqërore. Duke u përballur me këto sfida, intelektualët që mendonin

ndryshe shpesh ishin ata që përpqeshin të ruanin një identitet të pasur dhe të larmishëm, ndonëse me rreziqe të mëdha për vetveten.

## “Vështrim propagandistik” mbi botimet gjuhësore në Kosovë

Kur ky vlerësim apo etiketim i elitës intelektuale vinte nga ndonjë emër eminent në sferën e artit, letërsisë dhe kulturës, kjo pastaj bëhej “ligj”! Një prej raporteve të kërkuar nga regjimi është edhe raporti i 24 nëntorit të vitit 1980, i titulluar “NJË VESHTRIM MBI DISA NGA BOTIMET KOSOVARE NGA FUSHA E GJUHËSISË DHE PRIRJET QË VËREHEN NË TO”, i përgatitur nga një prej historianëve dhe akademikëve më të shquar shqiptar, Kristaq Prifti! Nga mënyra dhe qasja në këtë raport, shihet se autori ka qenë dhunshëm i angazhuar për një analizë të thuktë të studimeve gjuhësore që lërohen në Kosovë, si dhe t’i nënvizojë të gjitha rreziqet që vijnë nga këto studime kosovare mbi identitetin kombëtar!

Autori është, pa dyshim, njohës i mirë i studiuësve dhe i angazhimeve intelektuale të shqiptarëve të Kosovës, të cilët angazhoheshin që mos të humbin asnjë milimetër nga hapi kombëtar në ngritjen e identitetit kulturor kombëtar. Ndonëse në një Shqipëri hermetikisht të mbyllur, ai di mbi gjithçka që shkruhet e që studiohet në Kosovë, i përmend me radhë të gjitha revistat gjuhësore që botohen në atë kohë, i di të gjitha shkrimet nga fusha e gjuhësisë që botohen nëpër revista, shpreh konsideratë për gjuhëtarët kosovarë që japin kontributin e tyre nëpër revista e konferenca shkencore.

Raportuesi nënvizon se qendrat kryesore të kërkimeve, studimeve dhe botimeve në fushën e gjuhësisë, në lëmin e shkencave albanologjike në Kosovë, janë Instituti Albanologjik dhe Fakulteti Filozofik në Prishtinë. Pjesa dërmuese e studimeve në lëmin e gjuhësisë botohen në revistën “Gjurmime albanologjike”, në “Përparimi”, “Fjala” si dhe në gazetën “Rilindja”, sidomos në të shtunave, raporton akademik Prifti. Më tej, raportuesi i thekson shkrimet, botimet e veçanta, autorët që janë në të njëjtën linjë me politikën gjuhësore të Shtetit Amë. Kështu, raporti sjell botimin e numrit të parë të përmbledhjes “Studime gjuhësore” që u botua më vitin 1978 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Një vit më vonë Instituti do të botojë edhe librin “Onomastika e Kosovës” (628 faqe), përmbledhje kjo e referateve, diskutimeve, kumtesave të mbajtura në simpoziumin kushtuar kësaj fushe më vitin 1977.

Dokumenti në fjalë, i deklasifikuar kohë më parë, ka rëndësinë e vet, sepse raporton për një kohë me aktivitetet të bujshme për sa i përket fushës së gjuhësisë dhe, përgjithësisht, kulturës shqiptare. Evidentohen një sërë aktivitetesh, konferencash e botimesh të cilat raportuesi i vlerëson si mjaft të rëndësishme dhe në harmoni të plotë me linjat e përcaktuara nga regjimi në politikën gjuhësore kombëtare. Raportohet se është botuar “Shenja dhe ide” dhe “Shumësia e tekstit” të Rexhep Ismailit. Pastaj, “E folmja e Shalës së Bajgorës” e Latif Mulakut, “Kërkime gjuhësore” të Idriz Ajetit. Po ashtu, raportohet edhe për angazhimin e gjuhëtarëve kosovarë për të sjellë në shqip botime të huaja që kanë të bëjnë me gjuhësinë, si: “Elemente të gjuhësisë së përgjithshme” i Andre Martinesë, të përkthyer nga Rexhep Ismajli, “Elemente të gjuhësisë së përgjithshme” i F. De Sosyrit, përkthyer nga Rexhep Ismajli, “Drejtimet në linguistikë”, i Milka Iviqit, përkthyer nga Sulejman Drini.

## Punime me gabime shkencore, por pa nëntekste të errëta

Raportuesi vlerëson se një punë mjaft e gjerë në Kosovë është bërë edhe për botimin në formë përmbledhesh të plotë të studimeve dhe artikujve të një varg studiuësish shqiptarë. Përmendet libri “Studime gjuhësore” i prof. Eqrem Çabejt. Po ashtu informohet se janë në botim e sipër edhe disa tituj si “Gramatikat e shqipes” të J. Kastratit, M. Domit, S. Rizës etj. Më tej, Kristaq Prifti, i angazhuar nga organet përkatëse të regjimit për të



raportuar mbi angazhimet gjuhësore si dhe në fushën e albanistikës të autorëve kosovarë, analizon kontributet e tyre në fushën e onomastikës, sidomos angazhimin intelektual që përmes studimeve dhe qasjeve intelektuale në onomastikë t’i kundërshtojnë të gjitha pikëpamjet antishqiptare të shkollës antropogeografike të J. Cvijiqit, nën redaktimit e të cilit u botuan për më se dyzet vjet një koleksion i titulluar “Srpski etnografski zbornik naselja i poreklo stanovnistva” (Përmbledhja etnografike serbe, shpërngulja dhe prejardhja e popujve), ku i botuan veprat e tyre shumë studiues antishqiptar, si S. Stanojeviq, V. Qubrilloviq, A. Uroshevac, I. Tomić, A. Joviçeviq, M. Lutovac etj. Raportuesi nënvizon se teza kryesore e kësaj shkolle është se popullimi i Rrafshit të Dukagjinit si dhe i Kosovës nga shqiptarët paska ndodhur në shekullin XVII-XVIII, me nguljen në masë të malësorëve shqiptarë në momentin kur serbët qenkan larguar së andejmi për t’u vendosur më në veri, pas dështimit të luftërave austro-turke në shekullin XVII. Sipas shkencëtarëve serbë, raporton Prifti, pjesa e popullsisë serbe të islamizuar që mbeti në vend qenka shqiptarizuar! Pra, raportuesi, prof. Prifti, vëren se gati të gjitha shkrimet dhe studimet nga fusha e onomastikës me sukses i rrëzojnë këto teza serbe si dhe provojnë çështjen e vazhdimësisë së etnisë shqiptare në trevat ilire të Drdanisë. Tutje, raportuesi nënvizon se janë për t’u vlerësuar sidomos punimet shkencore të Skënder Gashit, Rexhep Ismajlit, Rexhep Doçit, Muhamet Tërnavës, Mark Krasniqit, Muhamet Pirrakut, Ruzhdi Ushakut etj.

Më tej, raportuesi Kristaq Prifti analizon kontributin e shkencëtarëve kosovar në fushën e dialektologjisë, të cilët studimet e veta i publikojnë në organet “Jeta e Re”, “Përparimi”, “Jehona” dhe “Gjurmime albanologjike”. Konsideratë e veçantë shprehet ndaj botimit të një serie të re të punimeve gjuhësore me titull “Studime gjuhësore” nga Instituti Albanologjik. Autori i raportit nëpër shumë punime vëren mangësi shkencore, por e lumturon fakti që “shkrimet nuk kanë shkarje ose gabime me karakter të thellë, sidomos me nëntekste të errëta” (faq. 8 e dokumentit). Lavdëron punën shkencore të Idriz Ajetit, të Hilmi Aganit, të Latif Mulakut, Mehdi Bardhit, Mehmet Halimit, Abdullah Zyberit, Fadil Rakës, Tafil Kelmendit etj.

Në pjesën e tretë të raportit, raportuesi flet më gjerësisht për problemet për të cilët edhe është angazhuar për një analizë mbi botimet në fushën e gjuhësisë dhe mbi shkencëtarët kosovarë. Tetë vite pas Kongresit të Drejtshkrimit dhe normimit të gjuhës letrare, regjimi kërkon të dijë se sa ia kanë dalë të ndikojnë te kosovarët

për sa i përket normës letrare dhe kulturës së gjuhës shqipe. Raportuesi fillimisht raporton mbi botimet korrekte që kohëve të fundit janë botuar në “Rilindja”, “Fjala”, “Përparimi”, në të cilat haptazi vërehet angazhimi serioz dhe “dëshira për të përdorur gjuhën letrare të njësuar në ballë të gjerë, në çdo fushë të veprimtarisë”. Vlerësohet lart sidomos puna e prof. Idriz Ajetit.

## Akademik Rexhep Ismajli i padëshirueshëm për regjimin shqiptar

Megjithatë, nënvizon raportuesi, “vihet re edhe një prirje që në kuadrin e trajtimeve teorike të problemeve të normës letrare si dhe të përkufizimeve e ripërkufizimeve të saj, të vihen në diskutim jo vetëm ndonjë zgjidhje e veçantë, por edhe të lidhet kryesisht me nëntekst, ideja e nevojës së rishkrimeve e ritrajtimeve të saj”. Prijësin e kësaj “ideje retrogarde”, raportuesi Kristaq Prifti e sheh të Rexhep Ismajli, sidomos pas botimit të shkrimit “Mbi normën gjuhësore” të botuar në revistën “Përparimi”, 1, 1980, faqja 48-66. Prifti thotë se autorin e këtij shkrimi shumë studiues kosovarë e shohin si “gurë të parë që hidhet kundër normës letrare unike e përgjithësisht kundër zbatimit të gjuhës letrare në Kosovë”! Ndërsa vetë raportuesi për Rexhep Ismailin thotë se ai është “promovues i një varg idesh, në të cilat, ndonëse nuk kërkon haptazi të ndryshojë normën letrare të njësuar, synon që të çelë rrugë për një rishikim të ardhshëm të normës së gjuhës letrare shqipe” (faqja 11 e dokumentit). Për këto ide, Rexhep Ismajli bazohet në teoritë e S. Rizës, vlerëson raportuesi, dhe shton: “Rexhep Ismajli hedh mendimin se “baza e gjuhës letrare mbështetet në prestigjin shoqëror të një dialekti në momentin kur vendoset. Me këtë rast ai lë të nënkuptohet se, ajo që u vendos në një moment të caktuar (norma e gjuhës letrare shqipe) për shkak të prestigjit shoqëror, mund të ndryshohet po për këto arsye, d.m.th. kur me zhvillimin e Kosovës të marrë një prestigj më të madh shoqëror gegërishtja.” Duke përfunduar raportimin mbi personalitetin shkencor të Rexhep Ismajlit, raportuesi K. Prifti zbulon arsyen se pse shkencëtari kosovar duhet të linçohet dhe të margjinalizohet! Sipas tij, prof. Ismajli është i rrezikshëm për faktin që në punimet e tij askund nuk citon asnjë autor nga RPSH dhe as nga Kosova!

## Lista e shkrimtarëve “pozitiv” dhe “negativ” të Kosovës

Nga nevoja për të ruajtur një narrativ të caktuar kombëtar dhe ideologjik, regjimi i kohës në Shqipëri, përveç me

gjuhëtarë merrej edhe me shkrimtarët shqiptarë të Kosovës, për të cilët hartonte lista se kush është i dëshiruar e kush është i rrezikshëm. Ky vlerësim, i ndarë midis shkrimtarëve “të dëshiruar” dhe atyre “të rrezikshëm” e “antishqiptarë”, reflektonte një atmosferë të fortë kontrolli dhe manipulimi të kulturës, që kishte pasojat të thella për zhvillimin e identitetit kombëtar. Çuditërisht, në listën e shkrimtarëve të dëshiruar ka plotë emra që kanë qenë të angazhuar në afirmimin e socializmit jugosllav, të bashkim-vëllazërimit si dhe emra që më shumë i kanë kontribuar UDB-së se sa letërsisë shqiptare! Ndërsa, pa dyshim, mungojnë emrat e atyre që ishin therë në sytë e jugosllavëve dhe që përndiqeshin nga sistemi komunist jugosllav. Regjimi shqiptar i kohës promovonte shkrimtarë të caktuar nga Kosova, që vlerësoheshin si persona në përputhje me linjat ideologjike të Tiranës. Këta shkrimtarë, që shquheshin për angazhimin e tyre në përhapjen dhe forcimin e soc-realizmit shqiptar, si dhe që ndihmonin në forcimin e narrativës së unitetit kombëtar, merrnin mbështetje dhe vlerësim nga autoritetet, duke u botuar dhe promovuar në Tiranë si intelektualë të mëdhenj kombëtar.

Në anën tjetër, çdo shkrimtar në Kosovë, sikundër edhe në diasporë, që shprehte ide që konsideroheshin si devijante, kritike ndaj regjimit ose që synonin një qasje më të hapur dhe më të larmishme për identitetin shqiptar, ishin të etiketuar si “të rrezikshëm” dhe “antishqiptarë”. Këta shkrimtarë, që shpesh ofronin një reflektim më të thellë mbi përvojat dhe sfidat e Kosovës dhe të shqiptarëve, u përballën me ndjekje, censurë dhe margjinalizim. Regjimi e shihte këtë lloj të shkrimtarëve “hermetikë” dhe “trebelë” si kërcënim për stabilitetin e tij dhe si një rrezik për narrativën e kombit shqiptar.

Politika e censurës e regjimit i ndalonte shkrimtarët e rrezikshëm të shpreheshin lirshëm, e aq më pakë të botohen e të njihen në Tiranë, duke e bërë kështu artin dhe letërsinë një fushë të kontrolluar dhe të varfër. Nga ana tjetër, “shkrimtarët dekadentë” të Kosovës nga ky linçim komunist shpesh ndjeheshin të vetmuar dhe të izoluar, duke humbur mundësinë për të kontribuar në një dialog të pasur kulturor. Pasoja e kësaj qasjeje ishin të rënda. Shkrimtarët që kishin potencialin për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin e kulturës dhe identitetit shqiptar u detyruan të heshtin, duke shkaktuar kështu një humbje të madhe për trashëgiminë kulturore dhe letrare. Kjo ndarje nuk ishte vetëm e dëmshme për shkrimtarët individë, por gjithashtu dëmtoi mundësinë për një reflektim më të thellë mbi identitetin shqiptar. Një listë të tillë i është kërkuar të përgatisë autorit të “Shota dhe Azem Galica”, Ajet Haxhiut, një nga studiuesit e figurave të ndritura të Rilindjes sonë Kombëtare. Duke kuptuar se çfarë kërkon regjimi, cilët autorë i duhen regjimit dhe cilët i konsideron si armik të popullit, Haxhiu përgatit “Listën e krijuesve nga Kosova, të cilët i kanë shërbyer çështjes kombëtare me veprat dhe punimet e tyre”, si dhe “Listën e krijuesve që me krijimtarinë e tyre janë negativë apo të papërcaktuar”! Në listën e parë renditen krijuesit si: Esat Mekuli, Hasan Mekuli, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Ali Aliu, Agim Vinca, Abdylaziz Islami, Anton Çeta, Arif Demolli, Demush Shala, Din Mehmeti, Dervish Rozhaja, Enver Gjergjeku, Fahredin Gunga, Ekrem Kryeziu, Hasan Hasani, Idriz Ajeti, Jakup Ceraja, Jusuf Buxhovi, Latif Berisha, Lorenc Antoni, Murat Isaku, Muhamet Pirraku, Maksut Shehu, Mark Krasniqi, Nazmi Rrahmani, Qerim Ujkani, Ramiz Kelmendi, Rifat Kukaj, Rexhep Qosja, Rrahman Dedaj, Sabri Hamiti, Syrja Popovci, Shyqyri Galica, Shukri Rrahimi, Vehap Shita, Zejnullah Rrahmani, Zekirja Cana etj. Kurse, në listën e dytë, në atë të “shkrimtarëve negativë” radhiten shkrimtarët dhe studiuesit si: Adem Gajtani, Eqrem Basha, Beqir Musliu, Ibrahim Rugova, Rexhep Ismajli dhe Anton Pashku! Emrat si Adem Demaçi, Teki Dërvishi, Jusuf Gërvalla, Fehmi Agani, Ukshin Hoti, Ymer Shkreli, Mehmet Kraja, Musa Ramadani, Edi Shukriu, Flora Brovina etj. nuk përmenden në asnjë listë!

Shkoqitje


# TRAGJEDIA E PËRSHKALLËZUAR NJERËZORE

(Donika Dabishevc, E gjithkohshmja andërr, botoi Littera, 2024, Prishtinë)

## Zyrafete SHALA

Vëllimi poetik E gjithkohshmja andërr i autores Donika Dabishevc paraqitet si një shtegtim reflektues në kujtesën tonë kolektive, që i jep zë dramës së dhimbshme dhe përvojave traumatike që populli ynë përjetoi në prag të mijëvjeçarit të tretë. Duke i përmbledhur ndjenjat e një kohe të vështirë, ky libër i ofron lexuesit mundësinë të prekë e të ndjejë pranë dhimbjen e atyre që përjetuan humbjen, tmerrin dhe përballjen e afërt me vdekjen. Megjithëse kanë kaluar mbi dy dekada nga ngjarjet që përbëjnë thelbin tematik të vargjeve në këtë vëllim, Donika Dabishevc arrin të sjellë përpara lexuesit imazhe të gjalla dhe prekëse të së kaluarës, duke na rikthyer kështu në atmosferën tronditëse të luftës. Kjo ndërthurje mes diskursit poetik dhe reales, të shtresuar në ndërdijen individuale e kolektive, na çon drejt poetikës së kujtesës, si një fushë që gjurmon dinamikën e bartjes së përvojave të dikurshme në krijimtarinë letrare. Linja narrative që përshkon vëllimin poetik E gjithkohshmja andërr shërben gjithashtu si një catarsis për lexuesin që i ka të njohura këto rrëfime, por që, përmes mekanizmave mbrojtës, mbase përpiqet t'i shtyjë në ndërdije. Nga ky këndvështrim, riprodhimi i situatave traumatike përmes një diskursi të ndërtuar me gjuhë të përditshme dhe përshkrimi i pamjeve të gjalla e tronditëse, të rrënjësura thellë në ndërdijen tonë, përmes përjetimit estetik, shërben gjithashtu si një terapi për eksternalizimin e vuajtjes.

Të katër ciklet në të cilat janë ndarë poezitë e këtij vëllimi: Zanun n'lak, Lakmia me u çmend, N'luftë me korba dhe Dhimta t'ngufatuna n'ofshama t'pazashme, krijojnë një udhëtim të thellë dhe emocional që përçon ndjenjat më të errëta dhe më të fuqishme të përvojës njerëzore. Të organizuara si akte të një tragjedie universale, këto cikle shpalosin një narrative të brendshme që zbulon anët më të fshehta dhe më të dhimbshme të shpirtit njerëzor. Këto cikle na shfaqen në fakt si akte të një tragjedie të njohur, skenat reale të së cilës herë na ofrohen ashtu siç i kemi njohur, herë si sajesa të trishtra të memories traumatike, e herë si ëndrra apo situata surreale. Ndërsa, relacioni mes katër cikleve shpërfaq brenda vëllimit poetik një konflikt që shkon duke u përshkallëzuar, ashtu siç përshkallëzohet dhuna në njërin anë dhe përjetimi intensiv i pasojave të saj. Secila poezi është një rrëfim në vete, që ka konfliktin, ka personazhet e saj dhe që na shfaqet si një sekuencë lufte, ndërsa në kuadër të vëllimit si tërësi, çdo poezi e çon një hap më tutje rrëfimin. Në anën tjetër, secili nga këto (mini) rrëfime për lexuesin është një dritare e tmerrit të përjetuar, prej nga na shfaqen trajtat më të thella të vuajtjes, shkaktuar nga egërsia antropike e gjithkohshme, nga babëzia, apo thjesht nga instinkti i brendshëm njerëzor, me i hangër s'gjalli t'dobëtit – siç thotë autorja. Sekuencat narrative, varg pas vargu e poezi pas poezie, na ofrojnë një tablo të gjithanshme të luftës, ku me sytë e zemrës shohim tek parakalojnë: njerëz të shkullur dhunshëm nga vatrat e tyre; fëmijë që struken në gjokset e



nënave të përgjakura, për të marrë aty ngrohtësinë e fundit amnore; shtëpi të përfshira nga flakët, që bashkë me ëndrrat dhe kujtimet, djegin jetë të tëra të ndërtuara me dashuri; turma që zvarriten nëpër male për t'u strehuar në mëshirën e bishave të egra; njerëz të strukur në bodrumet e errëta; fëmijë që takohen me vdekjen ende pa e njohur jetën; gra të dhunuara, burra të masakruar dhe skena të tjera rrëqethëse që nuk i përkasin Mesjetës, as Holokaustit, por fundshekullit XX dhe vatrës së civilizimit. Absurditeti që i përshkon këto sekuenca zë fill qysh në poezinë e parë, Granatimet, që njëherësh vihet edhe në funksion të prologut. Për të dhënë dimensionet e paqes hyjnore, Dabishevc sjell një peizazh të natyrës së përkryer që duket se jo rastësisht na shfaqet pa njerëz, një peizazh ku zë vend gjithçka mi dhë, rreze dielli, fllad pranvere, lulësa e sytha, bari, ujna të kthjellët, zogj imcak e qiell të paqtë, por jo njerëz, asnjë njeri... mbase nënteksti i këtij imazhi na jep të kuptojmë se njeriu është e vetmja krijesë që në mënyrë të vullnetshme e prish paqen hyjnore. Simbolika e paqes së thyer shpërfaqet në vargjet e mëtejme: Nisën granatimet / Zogjtë u çakërdisën. / Nisën me u rrokë n'njeni –tjetrin, / trumhasun me u ndesh' fluturimeve, / si pa krye – për me pshtue kryet – ku pafajësia vihet në përballë forcave të errëta. Figura e kontrastit mes një paqeje të përkryer dhe shpërthimit të dhunës, përveç që nxjerr në pah absurditetin dhe prirjen destruktive të njeriut, është edhe një apel për reflektim mbi natyrën njerëzore. Në këtë përmbysje të ekuilibrit, ku gjithçka duket e thyer dhe kaotike, shfaqet skena

e një dueli të pamëshirshëm mes jetës dhe vdekjes – një betejë ku çdo çast, është një përpjekje për të mbijetuar dhe çdo frymë bart ngarkesën e ankthit e të shpresës.

Shpalosen më tej motive të panumërta përmes situatave narrative që, megjithëse bartin kaos brenda vetes, ndjekin një rrjedhë logjike kohore: fillimisht ekuilibri natyror, më pas granatimet e papritura, sirenat e bombardimeve, ndjesia e papërballueshme e urisë, ikja e dëshpëruar për t'i shpëtuar vdekjes, fshehja në vende të errëta dhe të ftohta – për të vazhduar më tej me vargun e skenave të njëpasnjëshme, çdonjëra prej të cilave përbën vetëm një hallkë në kalvarin e vuajtjeve pa fund. Kjo rrjedhë e ngjarjeve, me ritëm të ngadalshëm dhe efekt tronditës, dëshmon për organizimin e kujdesshëm të poezive brenda vëllimit; ashtu siç e plotëson secilin varg, vargu tjetër që vjen pas tij, çdo poezi shpalos një pamje të re, gjithnjë e më të errët, një nuancë më të thellë të dhimbjes, duke krijuar kështu të gjitha së bashku një Guernikë kosovare – një imazh kolektiv, pjesë nga i cili bartin ne të gjithë, në çdo hap që hedhim. Mirëpo, krahas dhimbjes shqiptare, në ciklin e dytë, Lakmia me u çmend, Donika sjell edhe disa poezi nga luftëra të tjera, si lufta në Bosnjë, në Palestinë e Ukrainë, me të cilat ofron një perspektivë bindëse mbi universalitetin e vuajtjeve njerëzore në luftë. Duke i pozicionuar këto luftëra përkrah njëra-tjetrës, poetja Dabishevc thekson një tragjedi të përbashkët njerëzore. Ndërsa nxjerrja në pah e modeleve të përsëritura të dhunës, krijon idenë se

njerëzimi ka një prirje të rrënjësuar thellë për dhunë dhe shkatërrim. Kjo e fundit, përveç dëshpërimit mbi natyrën e pandryshueshme të qenieve njerëzore, hedh dyshime mbi mundësinë e arritjes së paqes ose pajtimin të vërtetë, që në mënyrë më të qartë shfaqet në poezinë epilog Gja s'ka ndërrue... Një epilog ky i dhimbshëm, që më tepër se shturje e konfliktit do të mund të kuptohej si një zhvendosje e tij, me lutjen që stuhitë e çmenduna t'insinktojnë primordiale të mos kthehen më: T'tanë janë dëshmitarë / marrëzish t'shpirtnav' t'ligë / e muranave që z'vendësojnë njana – tjetrën! / Gja s'ka ndërrue n'këtë rruzullim!

Njëjtësimi i autores me ndjesitë dhe dhimbjen e secilit personazh, aftësia e saj për ta ringjallur estetikisht çdo situatë tronditëse deri në detajet më të imëta, sensi për të përdorur gjuhën dhe figurat që janë të lidhura ngushtë me botën tonë emotive, kanë bërë që secili lexues t'i pranojë këto poezi si pjesë të qenies së vet. Përdorimi i metaforave të rrënjësura thellë në traditën dhe kulturën shqiptare si: të zanun n'lak, t'u ec me dekën përdore, futëzeza, nënëzeza... luan një rol vendimtar në receptimin e poezive. Në anën tjetër, përshkallëzimi i situatave si: Arnat s'ua mlojnë brinjët. As kockat./Ftyrzbardhemt. Syzgavruem. / Buzëshkrumbuem. Rrashtëkrisun / T'mavijosun. – përmes ngritjes së tensionit dhe frikës, thellon te lexuesi ndikimin emocional, duke e përfshirë atë në atmosferën e ashpër të luftës. Përshkallëzimi i jep lexuesit kohë për të përsiatuar dhe për t'u thelluar në vuajtjet që rrëfehen, duke e bërë më të qartë shkallën e tmerrit dhe efektin që ai ka te njeriu. Kalimi gradual nga skena më pak të dhimbshme drejt skenave më të rënda, shërben gjithashtu për të shprehur humbjen e njerëzores dhe efektin që kanë situatat ekstreme në ndryshimin e njerëzve. Këto zgjedhje stilistike, përveç efektit emocional te lexuesi, sugjerojnë se ashtu siç krijohet shtresimi i dhunës gradualisht, edhe pasojat e saj rëndojnë për një kohë të gjatë në kujtesë.

Duke e vlerësuar këtë vëllim me poezi si dëshmi të së kaluarës, dëshmi të një të vërtete që nuk e shprehin dot të dhënat historike e statistikore, e shohim se elementi narrativ që i përshkon poezitë i ka shërbyer autores Donika Dabishevc si mjet i pazëvendësueshëm në krijimin e një dëshmie poetike, sepse pa rrëfim nuk mund të ketë kujtesë. E gjithkohshmja andërr portretizon në mënyrë unike brutalitetin e luftës, duke i lënë të nënkuptohen efektet psikologjike dhe traumat që lufta ka lënë pas. Si i tillë, ky vëllim poetik shërben për t'i përjetësuar rrëfimet e viktimizeve, por edhe për t'i kundërshtuar narrativat që përpiqen t'i minimizojnë ose edhe fshijnë ato. Nëse siç thotë Walter Benjamin: Kujtesa nuk është një instrument për të eksploruar të kaluarën, por është teatri i saj – atëherë mund të sugjerojmë që kujtesa është një hapësirë ku e kaluara formësohet dhe interpretohet vazhdimisht, por natyrisht që formësimi dhe interpretimi bëhen përmes kujtesës së shkruar, të cilës ne si popull nuk i kemi dhënë rëndësinë e duhur.

Ese

# MNEMOZINA

**Mircea Eliade ka shkruar një skicë mbi mitologjinë greke të kujtesës. Ai na ndërmend që hyjnesha Mnemozina, motra e Kronosit dhe Oqeanit, quhej nënë e muzave. N'akord me Hesiodin, Mnemozina ruante kujtesën për gjithçka që ajo ka qenë**

**Doc. Dr. Agron TUFA**

Kujtesa si organ psikologjik i përjetimit të kohës mbetet e vetmja ndërmjetëse që na garanton unitetin e thelbit të genies, të projektuar në një shkallë vetënjohjeje individuale dhe kolektive. E them në një shkallë vetënjohjeje, sepse kujtesa, siç e thamë, është organ psikologjik dhe se vetë psikologjia njerëzore, individuale qoftë ajo apo shoqërore, gjendet në kushtet e një trysnie të përhershme që e relativizon, e deformon, e transformon apo e çorodit krejtësisht psikikën njerëzore, po të merren parasysh dramet individuale dhe kolektive. Psikologjia është e varur nga psikika, pasi kjo e dyta është tregues i shëndetit të së parës. Rrjedhimisht edhe kujtesa, duke qenë organ psikologjik i përjetimit të kohës dhe shprehje vetidentifikuese e totalitetit organik të genies në kohë, relativizohet, shformohet, manipulohet dhe na prezanton marrtas, në pajtim me thelbin e deformuar të vetes sonë. Kujtesa e manipuluar është një togfjalësh që shpreh reflektimin kritik, të ndërgjegjshëm e oponencial nga pikëpamja e dikujt që zotëron një përvojë krahasimore në lidhje me origjinën e njohjes dhe gjendjeve stadiale të trajtores së kujtesës, prej nga zë fill tjetërsimi dhe manipulimi i saj. Ky proces nuk ka gjë të përbashkët me idiomën e përvojave individuale "më tradhton kujtesa", pasi si akt ndërgjegjësimit, kjo shpreh riaftësimin dhe ripërftimin e po asaj kujtesë vetidentifikuese, për t'u pozicionuar mandej, në masën e vetëdijesimit, për një përballje raportesh me të. Fjala, më konkretisht, është për kujtesën historike apo kolektive, që deri më tash ekziston kryesisht në po ato forma që e mendonin grekët e lashtë, në trajtën e mneme-së, anamnez-isit dhe mnemozinës. Mneme paraqet një aftësi të dhënë fiziologjike të çdo organizmi për ta ruajtur informacionin e ndërkalur në të. "Nga perceptimet ndjesore lind, siç themi ne, aftësia e kujtesës", thotë Arsitoteli. Ndërsa nga ndërmendjet e shpeshta për të njëjtën gjë lind përvoja, sepse një numër i madh kujtimesh përbëjnë së bashku njëfarë përvoje. Nga përvoja pra, nga tërësia e përvojës që ruhet në shpirt, nga përvoja e vetme, e ndryshme prej shumicës, nga përvoja vetjake që paraqitet si identike në gjithë këtë shumësi, e ka zanafillën arti dhe shkenca: arti, nëse kemi të bëjmë me krijimin e diçkaje, dhe shkenca, nëse kemi të bëjmë me thelbin dhe esencën". Anamnezisi - është ndërmendja (të kujtuarit). Ajo e ruan informacionin e futur në të, por e ruan në atë mënyrë, që informacioni gjithmonë përplotësohet dhe

pasurohet me përvojën individuale, duke u realizuar jo rrallë në letërsi në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale - nga rikrijimi artistik i ngjarjeve të kaluara deri tek historiografia, që del jashtë sinoreve të mneme-së (si te Herodoti, Taciti apo Mishlje). Në kulturën europiane, anamnezis-i ka hyrë kryesisht në atë kuptim të saj, siç e pati themeluar dhe përdorur Platoni: "Kur shpirti që ka humbur kujtesën mbi ndjesitë apo dijet, e thërret sërish atë dhe përpiket ta përtërijë në vetvete, atëherë këtë ne e quajmë ndërmendje". Kurse në një vend tjetër, Platoni thotë: "Prit pak, o Sokrat, - e ndërpreu Kebeti, - mendimet e tua na shpien edhe në një përfundim tjetër, nëse është e saktë ajo që ti e përsërit shpesh, se pikërisht dija nuk është gjë tjetër përpos se ndërmendje: atëherë, atë që ne po ndërmendim tani, duhet ta kemi nxënë në të kaluarën, - ja pra se çfarë nxjerrim nga ky konkluzion. Por, kjo do të kishte qenë e pamundur po qe se shpirti ynë nuk do të kishte ekzistuar në ndofarë vendi tjetër, përpara se të lindej në trajtën tonë njerëzore". Në një formë të ndryshuar, përfytyrimi mbi anamnezisin si një fundament i aspektit frymor ka hyrë në kristianizëm: "Pastaj mori bukën, u falënderua, e theu dhe ua dha e tha: Ky është korpi im, që flijohet

për ju. Bëni këtë në përkujtimin tim " (Luka 22. 19). Përjetimi platonian i anamnezisit, që mbijetoi deri në shekullin XX, përbënte bazën e simbolizmit edhe si filozofi, edhe si drejtim letrar, në botën e krishterë. Një ndër poetët dhe teoricienët e simbolizmit rus, Aleksandër Bllok, shprehejse: "Rruga e simboleve është rruga nëpër gjurmët e harruara... rruga e mbërritjes së dijes si ndërmendje (Platoni)". Mnemozina. Mbi këtë nocion qendror të imazhit për analizën tonë na takon të flasim pak më gjerë. Në rendin e numërimit paraprak të atyre mishërimeve kryesore në të cilat ka ekzistuar për grekët e lashtë kujtesa e tyre historike dhe kulturore, mjafton t'u referohemi tipareve të Mnemozinës, siç na paraqitet ajo në të vetmin burim - në veprën "Teogonia" të Hesiodit, ku për grekët ajo është, para së gjithash, nëna e muzave. Mircea Eliade, në njërin prej librave të tij, ka shkruar një skicë mbi mitologjinë greke të kujtesës. Ai na ndërmend që hyjnesha Mnemozina, motra e Kronosit dhe Oqeanit, quhej nënë e muzave. N'akord me Hesiodin, Mnemozina ruante kujtesën për gjithçka që ajo ka qenë, por kishte dijeni edhe për ato që do të ndodhnin. Kur muzat e përndritin poetin, ai bëhet i aftë për dijen e Mnemozinës, njohjen e zanafillave të para. Muzat

këndojnë, tue u nis ç'prej zanafillave ato rrëfejnë për origjinën e zotave dhe njerëzve. Poeti përmes muzave fiton kujtesën mbinjerëzore të Mnemozinës. Por, këto realitete parazanafillore, pikërisht ngase janë të lidhura me burimet, nuk hyjnë në sferën e jetës së tashme, ato janë të pambërritshme për përvojën e përditshme. Prandaj, pra, poeti që ka fituar këtë dhunti mbikujtesore prej duarve të Mnemozinës, shtyhet, si të thuash, prej saj në një botë tjetër, botën e së shkuarës dhe harresës, e cila identifikohet me vdekjen. Lumi i harresës, Leta, që rrjedh në Aid, e shkatërron kujtesën e të vdekurve, duke i shndërruar ata kësisoj në të vdekur. Por, vëren Eliade, me shfaqjen e doktrinës së transmigrimit (rimishërimit) të shpirtave ndryshon edhe mitologjia e kujtesës. "Është e rëndësishme tashmë të mbash mend jo burimet dhe parazanafillat, por jetën paraardhëse të shpirtit, që shënon humbjen e kujtesës së shpirtit në lidhje me ekzistencat e tij pararendëse. Dhe rishmi vdekja në këtë kontekst del si kthim në një botë tjetër, botën e zanafillave dhe mbikujtesës. Vetëm pak të zgjedhurve të muzave dhe profetëve, Mnemozina ua lë kujtesën e ekzistencave pararendëse dhe parazanafillave. Dhe ata përpiqen t'i bashkojnë fragmentet e shkalafitura, t'i përfshijnë ato në një zinxhir të vetëm, që të mbërrijnë kuptimin e fatit të tyre. Sepse ngjitja e fragmenteve të memories së historisë, që s'kanë asnjë lidhje mes veti, do të thotë "lidhja e fillesës me fundin" (Eliade, 1988:156). Këta poetë dhe orakuj, që rrahin të ribëjnë e ringjallin një tekst të lidhur prej fragmentesh të bëra fir në kujtesë, përmbushin punën e kulturës - të shqyer, fragmentare, të shkërmoqur në arkivin e padukshëm heterogjuhësor, por ama janë ata që gjakojnë të përftojnë tërësinë, unicitetin, logjikën. Në thelb, çdocili tekst i bart në vetvete këto fragmente, herë të dukshme e herë të maskuara dhe rreh t'i ndërtojë ato n'akord me logjikën e rrëfimit. Ndër orakujt të cilëve zotat ua ruajtën kujtesën pas vdekjes, spikat njëri ndër më të njohurit - Tiresia. Ç'prej kohës së djalërisë, ai pa rastësisht, tek po lahej cullake në burimet e Hipokrenës, hyjneshën Atena dhe shi për këtë shkak i plasën sytë e mbeti i verbër, por njëkohësisht u pajis me dhuntinë e profecisë. Mandej, duke bredhur nëpër krepat e maleve të Kilenit, ai, po rastësisht, pa shlligat që po ndërzeheshin dhe për disa vite u shndërrua në femër. Ky verban dygjinish u zgjodh prej zotave që të bartë përjetësisht një kujtesë të pashqimur.



Nga këndi im

# PËRSE SHKRUAJ

**A e kam zgjedhur unë shkrimin apo shkrimi më ka zgjedhur mua? Nuk ka filozof as filozofi që e jep përgjigjen në këtë pyetje. Është pyetje 1 milion dollarëshe.**

## Aziz MUSTAFA

Babai im e ka përmendur shpesh një xhaxha të babait të tij, Axhën Ali. E përmendte për një fakt që mua mu ka dukur shumë interesant. Axha Ali kishte qenë bejtexhi. Ai nuk kishte lënë trashëgimtar, por kishte lënë prapa vetes disa bejte, njëra nga të cilatka mbijetuar deri në ditët tona. Ka ardhur deri këtu, në kokën time dhe do të mbetet deri sa të jem unë. Dëgjone:

*"Sallko, Sallko, me një kundër.  
Kcej' pej toke, hipi në kumëll,  
E kthen kryet, po kshyr kah vada,  
Kah po rrehen Xhema e Kada"*

Shtëpia ku kam lindur unë është në truallin e Axhës Ali, i cili prej të gjithë djemve të vëllezërve të tij, më së shumti e kishte dashur tim gjysh, Pajazitin të cilit ia kishte dhuruar e bërë tapi oborrin. Gjithmonë, kam besuar se fryma e bejtexhiut Ali qëndron atje diku lart, në vesën në fletët e dardhës së vjetër, më e vjetër se vjetërsia që shihej nga shtraja kur unë hapja sytë çdo mëngjes.

Përse shkruaj? Nuk e mbaj mend të kem pasur nëpër kokë këtë pyetje, as të kem pasur përgjigje në të kur kam shkruar shkronjën e parë në murin e pasmë të lyer me llaç dhe e mbi të me gëlqere të bardhë të shtëpisë sonë përdhese. Shkronja "A" e madhe e shtypit dhe pastaj tri shkronjat pasuese që formonin emrin tim u patën ngjyrosur menjëherë dhe pamëshirshëm nën qortimet e nënës që mezi kishte arritur të siguronte gëlqerën dhe të lyente vetë shtëpinë. Emri im ka qenë i shkruar me majën e një shkarpe, prandaj nuk njehsohet. Fjalën e parë të cilën e kam hedhur në letër me laps ka qenë përsëri emri im, kësaj here shkruar skajeve të një libri të vjetër me disa vizatime e fotografi që më rrinë ende në memoririn vizuale. Libri ka qenë "Historia" për klasën e shtatë të cilën ma pat falur një kushëriri im i cili kishte kaluar në klasën e tetë dhe atë libër po planifikonte t'ia jepte nënës së vet që fletat e shkoqura ti vendoste mbi njëqind petët e bakllavasë së gatuar, për të mos u djegur gjatë pjekjes. Mendimi se kisha shpëtuar ato figura dhe ato shkronja nga zjarri i furrës, më pat dhënë një kënaqësi, që nga distanca kohore e tashme mund ta quaj si një kënaqësi e rrallë estetike. Aso kohe nuk dija se librat digjen në turra drush si shtrigat e mesjetës, se shkrimtarët burgosen, torturohen dhe vriten, asokohe nuk e kam menduar se kundër një shkrimtari mund të shpallet "Fetwa", dënim me vdekje për shkak të librave të tij dhe se autori i dënuar nga udhëheqësi fetar do të marrë plagë me thikë afër tri dekada më vonë.

Asokohe kam qenë katërvjeçar. Është viti kur Universiteti i Prishtinës kremtonte ditëlindjen e parë. Me librin në dorë pata shkruar në shtëpi dhe babai që ato ditë ishte ardhur nga kurbeti, në skajet e faqes së parë shkroi emrin dhe mbiemrin tim, sepse librit kush e di ku i kishin mbetur kapakët nga përdorimi njëvjeçar. Mandej, emrin e mbiemrin e kopjova skajeve të fletëve të brendësisë, sërish e sërish, deri sa nuk kishte vend të lirë më. Kopjoja si murgjit e mesjetës librat e rrallë dhe hija ime në dritën e qiririt pasqyrohej e zgjatur. Tani, kur shoh dorëshkrime dhe libra të shkruara skajeve të faqeve, çdo herë me patjetër më kujtohet ai libri i parë i shpëtuar nga dënim me djegie, që është dënim më i tmerrshëm, qoftë në këtë jetë, qoftë në jetën tjetër. Edhe kur shoh dokumentarë me djegie publike të librave, domosdo më



kujtohet "Historia: për klasë të shtatë", ani pse atëherë nuk kam ditur gjë për diktaturat, censurat, inkuizicionin dhe auto censurën. Kësaj të fundit, ndoshta më e keqja nga të gjitha censurat, do t'i kthehem një ditë me ndonjë trajtesë fillim e mbarim. Prej takimit të parë me librin, magjia dhe mrekuillia e tij më kanë përcjellë tërë jetën. Ende pa e ditur çka ka thënë JorgeLouisBorghes (HorheLuisBorhes) për librin, magjia e tij ka ardhur te unë e natyrshme, e kam ndërë nën lëkurë si fotonet e diellit që duke vepruar në melancoret e lëkurës, shndërrojnë ngjyrën e bardhë në të bronzte. Po citoj fillimin e ligjëratës së tij të titulluar "Mrekuillia e librit", të mbajtur nëpër universitetet e Argentinës, këtu e tetëdhjetë vite më parë:

"Ndër instrumentet e shumta të njeriut, padyshim libri është më i mahnitshmi. Instrumentet tjera janë zgjatime të trupit të tij. Mikroskopit dhe teleskopit janë zgjatim i shikimit; telefoni është zgjatim i zërit; kemi edhe parmendën dhe shpatën, kuptohet zgjatime të krahut. Por libri është diçka tjetër: Libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës." – fundi i citatit.

Libri është zgjatim i kujtesës dhe imagjinatës. Zgjatimi i mendjes. Cogitoergosum. Mendoj, prandaj jam. Një shkollë e tërë filozofike e përmbledhur në një fjali të RenesDecartes (Rëne Dekart). Leximi është shtysa, është ngjizja e shkrimit. "Lexo!" e kishte urdhëruar engjëlli Profetin në një shpellë të shkretëtirës arabe, për të filluar Zbulesën. Tridhjetegjashtë shkronja shqip, për të cilat është derdhur gjak gjatë shekujve janë 36 simbole, kur kombinohen, si kombinimet gjenetike për të formuar një qenie të gjallë, formojnë fjalë.

"Së pari ishte fjala" – Me këtë fjali fillon Bibla. Kombinimet e fjalëve transkriptohen, transformohen në fjali, në mendim që nëpër rrugën nervore të shikimit, shkon në trurin tonë për të krijuar një engram, një vizion, një shkëndijë që përçon informacion e që nxit informacione të tjera, të fjetura e të shtresuara në kujtime, ëndrra dhe mendime. Bota e një mendjeje të ndritur, me anë të shkrimit dhe leximit ndez një dritëmagjike në një mendje tjetër. Duke lexuar dhe kuptuar atë çka ka shkruar autori, lexuesi hyn në botën e autorit, qan e qesh me të, dashuron dhe urren me të. Të lindur në një tokë me traditë poetike gojore mijëvjeçare, vendin e vetëm ku ende krijohet epika gojore,

që nga epoka homerike e deri më sot, shtysën për të thënë diçka bukur, për të shprehur, për të shkruar sikur e marrim me ajrin që thithim, me qumështin e nënës që na këndon ninulla, shumicën e të cilave i krijon aty për aty. Po flas për të gjithë poetët e shkrimtarët që lexojnë, dëgjojnë, flasin dhe shkruajnë shqip. Një areal ku prodhohet shumë histori, domosdo lindin shumë persona që këto histori duan t'i tregojnë. Nganjëherë më krijohet një përshtypje e gabuar që kemi më shumë shkrimtarë se lexues. Në një mënyrë apo tjetër, secili ka një rrëfim për të treguar. Varet mandej nga talenti i lindur, e pastaj nga ajo sa lexon dhe sa punon për të arritur që atë që ka brenda mendjes e ta shpërfaqë për ta bërë të lexueshme, të kuptueshme. Ta bësh të tillë që njeriu të përjetojë kënaqësinë hyjnore, kënaqësinë e mendjes, mrekuillinë e leximit dhe përjetimit të shkrimit artistik. Nuk besoj se ka një poet a shkrimtar që nuk ka derdhur lot kur ka lexuar diçka të dhembshme, edhe pse e ka ditur se është rrëfim i trilluar, është fikcion. Nëse ka të tillë, ta lenë shkrimin e letërsisë artistike në këtë moment. Përse shkruaj? Shkrimtari dhe kritiku i njohur francez Eric Faye, ka bërë një intervistë me Ismail Kadarenë. Intervista është e bërë në tri kohë të ndryshme, që të krijon idenë e së kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes. Pyetja e parë e pjesës së parë të intervistës është:

– Ismail Kadare, përse shkruani?

– Sepse jam prej racës së shkrimtarëve, që është krijuar për të shkruar... Është instinkt race, të cilit i bindem – është përgjigja.

Unë nuk di ende a jam prej kësaj race. Ndoshta është më mirë ta thonë të tjerët, por për një gjë jam i bindur: si Migjeni me "Këngët e pakëndueme", edhe unë, edhe secili prej jush që shkruani, të gjithë ne kemi brenda nesh një botë që çdo herë është më e bukur se kjo botë në të cilën jetojmë, se brenda nesh kemi një "Alter ego" që gjithmonë është më i mirë se vetja që jemi vërtetë, që është vetja jonë ideale, e ndritur, e lartësuar. Nuk po them hyjnore, por nëse ka diçka hyjnore te njeriu, atëherë për mua është momenti i frymëzimit, i shkrimit, i krijimit. Pra, shkruaj sepse shkrimi është fryma. Frymëzim. Shkruaj sepse duke shkruar zbuloj botë të reja, krijoj karaktere, personazhe që u jap frymën

time, ju jap fjalën time, ashtu sikur Krijuesi që na ka dhënë mendjen dhe në librat e tij na ka mësuar të bëjmë mirë, të duan njëri-tjetrin, të ndihmojmë, të luftojmë të keqen. Shkruaj sepse prej të gjitha profesioneve, ai i shkrimtarit është më trunori. Pa nënçmuar asnjë profesion: bujku prodhon drithin që bukëpjekësi e bën bukë; mësuesi mëson nxënësit, profesion shumë fisnik, mjeku fashit dhembjen, pastruesi i rrugës na zbukuron ambientin, polici na krijon sigurinë; secili që punon në profesionin e vet është i çmuar dhe duhet të respektohet jo për çka është, por si dhe sa me ndershmëri dhe përkushtim e kryen punën e tij. Inxhinierët, shkencëtarët, teknologët e informatikës, krijuesit e IA, IT e shumë profesione të tjera që na bëjnë më të lehtë jetën kanë rëndësinë e vet, por shkrimi i poezisë, romanit, krijimi e veprave të mirëfillta letrare është veprimtaria më fisnike. Dhuntinë e të shkruarit nuk e kanë të gjithë. As atë të leximit. Jemi dëshmitarë sa analfabetë dhe sa dislektikë na rrethojnë. Hyni në rrjetet sociale dhe lexoni komentet. Prandaj, ata që kanë dhuntinë e shkrimit, të krijimtarisë artistike letrare, e kanë për borxh të shkruajnë, të mundohen, të provojnë, të vdesin duke provuar. Kohëve të fundit po e parafrazoj shpesh Sartrin që ka thënë se intelektualit është përgjegjës për atë çka ka ndodhë në të kaluarën, çka po ndodhë sot dhe çka do të ndodhë në të ardhmen. A ka nevojë të trumbetohet se këtë fjali secili intelektual duhet ta përsërisë tri herë në ditë, në vend të lutjeve? Edhe diçka: krijimtaria letrare artistike është një proces vetmitar. Jo se shkrimtarët janë njerëz të mbyllët dhe asocial, por nga se qetësia e vetmisë është kusht i domosdoshëm për një punë të mirëfilltë krijuese letrare. Prandaj, të shkruash është sfidë. Përse shkruaj? Sepse i dua sfidat. A e kam zgjedhur unë shkrimin apo shkrimi më ka zgjedhur mua? Nuk ka filozof as filozofi që e jep përgjigjen në këtë pyetje. Është pyetje 1 milion dollarëshe. Thjesht nuk e di përgjigjen. Por një e di me siguri: nuk mund të shkruash po të mos kesh një krah. Një krah të fortë. Për mua, ky krah është gruaja ime dhe tre fëmijët e mi, të cilët i falënderoj publikisht për faktin se më kanë toleruar deri këtu. E gjithë koha e shkrimit tim, ka qenë kohë që nuk ua kam kushtuar atyre, e që është dashur t'ua kushtoja, qoftë si bashkëshort, qoftë si prind. Është kohë e vjedhur. Koha e punës në profesionin primar ka qenë më e gjata, më e rënda dhe më e mundimshme, kur unë në vend që të pushoja e të rrija me familje pas punës, unë jam mbyllur në bibliotekë dhe kam lexuar ose shkruar. Eremiti i shpellës. Ky jam unë. Ky është shkrimtari që rri brenda meje. Një shpellë që nuk është Altamira, shpella ku njeriu parahistorik ka vizatuar në mur të shpellës bizonin që ka ëndërruar ta gjuajë dhe me të ushqejë familjen dhe fisin e tij, nuk është shpella e gjumit treqindvjeçar të atyre djemve të versetit kuranor, nuk është as shpella e diktatorit MaoCeDun, aty ku futej për t'u mësuar me aromën e dheut që do ta mbulojë pas vdekjes. Është thjesht një studio e një shkrimtari, aty ku ai krijon botët dhe krijesat e tij. Është një dhomë ku një dritare rri hapur për ndonjë flutur të vonuar a për një xixëllonjë pa adresë. Është një dritare ku një qiri vezullon e bën dritë gjithmonë, si një yll që nuk shuhet kurrë...



Botime të veçanta


# RRUGËTIMI SI SAKRIFICË NË SHKALLËZIMIN ARTISTIK

(Elife Podvorica, "Dy botë në unison", libër biografik për dirigjentin e kompozitorin Baki Jashari)

Në shumë raste, përfytyrimi për një ngjarje shenjëzohet dhe ka një kuptim determinues, madje pa e privuar asnjëherë semantikën e fjalës dhe kjo është fotografia. Duke shfletuar biografinë e Baki Jasharit, në librin "Dy botë në unison" të zonjës Elife Podvorica, sikur ndjehemi shumë më të përmbushur me fakte të fotografive që flasin me një ndjenjë të sigurt, dhe krijojmë një imazh për një rrugëtim interesant e me nuanca më të ndryshme. Këto nuanca reflektojnë sakrificën individuale që natyrisht përfshihet tërë familja e deri tek rezultatet që të bëjnë të ndjehesh mirë.

Rrugëtimin e Baki Jasharit në shkallëzimin artistik, autorja e vë në dy shtylla. E para është ndjenja për të përballuar trysinë emocionale, kur një i ri shkëputet nga një ambient patriarkal dhe ballafaqohet me një realitet të logjikës së një ambienti artistik e urban, siç ishte Lubjana përkatësisht Sllovenia. Dhe e dyta, ndjenja për të mos ikur nga fryma autentike me të gjitha dimensionet, qofshin ato emocionale e deri tek ajo kur krijohet dilema: Cilën rrugë ta zgjedhë!? Atë të karrierës nën çatinë e metropoleve, apo tjetrën nën çatinë kur ende vendit i vije era urnë dhe era shkrum! Në rrugët e tilla të ballafaqimeve, artisti ndjen frymëzimin për të qenë më afër realitetit të hidhur, siç do të thoshte poeti brilant Din Mehmeti me poezinë: "Pakëz në ëndërr e pakëz në zhgandërr", që më vonë bëhet realitet artistik dydimensional poetiko-muzikorë, në notat e kompozuar për kor e solist e recitator nga Bakiu. Zhgëndrra e Bakiut, brumoset edhe më dendur kur fillon punën në Radio, dhe ballafaqohet me ndjenjën e demolimeve të incizimeve për të shkatërruar memorien kombëtare nga ata që vunë masat e dhunshme dhe përjashtuan frymën shqiptare nga institucionet arsimore, informative, kulturore e të të gjitha fushave të jetës sonë. Por, nga rruga nuk u tërhoq, sepse çdo ndalesë krijonte avari më të madhe

se sa që ishte. Radha erdhi tek puna me institucionin më kredibël artistik, siç ishte puna me Filarmoni. Ky ballafaqim ishte edhe sfidë, edhe ndjenjë, edhe frymëzim. Një përvojë e bartur funksionoi, sepse qëllimi ishte më i fortë se sfidat e të gjitha formave. Kuptimi i ngritjes së një institucioni thelbësor të jetës artistike, siç është jeta koncertale, përmes Filarmonisë dhe Korit profesional, erdhi në një kohë, kur vendoseshin themelet e një shteti me të gjitha institucionet e veta. Unë nuk do të flas për detajet e punës së Bakiut, sepse në librin autobiografik "Dy botë në unison", përshkruhen më së miri. Është një dimension tjetër që nuk mundesh ta anashkalosh! Bartja e frymës artistike evropiane në Kosovë, përmes ardhjes së emincencës së këtij profile. Po të numërohen këto, janë gjithësi shumë. Madje, i çuditshëm mbetet fakti, se paraqitjet brilante të tyre shfaqen në ambiente që nuk ofrojnë as për së afërmi nivelin çfarë duhet të jetë. Por, këta artistë kulmorë rikthehen prapë dhe disa herë me radhë. Shtrohet pyetja se cila është arsyeja? Kam bindjen se është shpirti i këtij populli që me sinqeritet e pret mikun, ndonëse kushtet janë modeste. Po të shikohen programet që përshfaqen në këtë libër, ato tregojnë rritjen institucionale, ndonëse ngadalë e me vështirësi të shumta. Nga format e Divertimentove që shfaqeshin në fillimin e punës, sot orkestra luan me pasion Malerin, nga veprat vokale dy e tri pjesore, sot Kori luan veprat më bashkëkohore të literaturës korale dhe nga veprat skenike të formës koncertale, sot inskenohen me të gjitha parametrat artistike, operat kombëtare dhe ndërkombëtare, madje nga kuadri ynë. Dhe në fund si një sublimim i tërë këtij formësimi artistik, mbetet recepti i quajtur publik i cili është edukuar dhe nuk i shqitet koncerteve, duke përcjellë me interesim, madje në numër që është inkurajuese për të ardhmen e ndritshme të jetës muzikore te ne.



Elife PODVORICA

DY BOTË  
NË UNISON

Profile: George ORWELL

## SHKRIMTARI QË EKSPLORONTE PJESËT MË TË VARFËRA TË LONDRËS

**Orwell mund të ketë qenë i pari që përdori termin «luftë e ftohtë» për t'iu referuar gjendjes së tensionit midis fuqive në Bllokun Perëndimor dhe atë Lindor që pasoi Luftën e Dytë Botërore në esenë e tij «Ti dhe bomba atomike», botuar në «Tribuna», më 19 tetor 1945**

**Përgatiti: Xhahid BUSHATI**

Duke imituar Xhek London-in, shkrimet e të cilit i admironte, filloi të eksploronte pjesët më të varfra të Londrës. Për një kohë "u nis" në vendin e tij, duke u veshur si një endacak, duke marrë emrin P. S. Burton, por duke mos bërë asnjë lëshim ndaj zakonëve dhe pritjeve të klasës së mesme; regjistroi përvoja e tij të jetës së ulët për t'i përdorur në "The Spike", eseja e tij e parë e botuar në anglisht dhe në gjysmën e dytë të librit të tij të parë, "Down and Out in Paris and London" (1933). Në fillim të vitit 1928, u transferua në Paris. Jetonte në lagjen e 5-të. Tezja e tij, Ellen Kate Limouzin, gjithashtu, jetonte në Paris me esperantistin Eugène Lanti. Ata


i dhanë mbështetje sociale dhe, kur ishte e nevojshme, edhe financiare. Orwell filloi të shkruante romane. Më i suksesshëm ishte si gazetar. Botoi artikuj në gazeta, revista politike-letrare. Në dhjetor 1929, pas gati dy vjetësh në Paris, Orwell u kthye në Angli dhe shkoi në shtëpinë e prindërve, në Southwold, një qytet bregdetar në Suffolk. U njoh me shumë banorë vendas. Nga gushti deri në shtator 1931 i vazhdoi eksplorimet e tij të realitetit të varfërisë. Mbante ditar për përvojat që pa e që ndeshi, dhe u bë dëshmitar e personazh. George takoi gruan e tij të ardhshme Eillen O'Shaungnessy. U martua më, 9 qershor 1936. Ftoi disa kolegë e studentë në këtë festë të paharrueshme. Kishte

filluar të shkruante komente për "The New English Weekly". Më 31 janar 1936, Orwell u nis me transport publik, por edhe në këmbë, dhe arriti në Mançester. Njëri prej tyre, zyrtari i sindikatave Frank Meade, i sugjeroi Wigan-in, ku kaloi gjithë muajin shkurt. Në Wigan vizitoi shumë shtëpi për të parë se si jetonin njerëzit, mori shënime të hollësishme të kushteve të strehimit dhe pagave të fituara, zbriti në minierën e qymyrit në Bryn Hall, përdori bibliotekën lokale për të konsultuar të dhënat e shëndetit publik, si dhe raportet mbi kushtet e punës në miniera. Në shtator 1943, Orwell dha dorëheqjen nga posti në BBC që e kishte prej dy vjetësh. Filloi ta shkruajë veprën "Ferma e kafshëve". Me 24 nëntor 1943,

gjashtë ditë para ditës së tij të fundit të shërbimit, u transmetua përshtatja e tij e përrallës "Rrobat e reja të mbretit" të Hans Christian Andersen. Në nëntor 1943, Orwell u emërua redaktor letrar në "Tribune", ku ndihmës pati mikun e tij të vjetër, Jon Kimçhe. Orwell ishte në staf deri në fillim të vitit 1945, duke shkruar mbi 80 recensione librash. Me 3 dhjetor 1943 filloi rubrikën e tij: "Si të lutem", zakonisht duke trajtuar tre ose katër tema. Orwell u kthye në Londër në fund të vitit 1946. Filloi, përsëri, gazetarinë e tij letrare. Tashmë ishte një shkrimtar i njohur dhe ishte i mbytur nga puna. Përveç një vizite në Jura në Vitin e Ri, ai qëndroi në Londër në një dimër të ftohtë britanik. Smogu i dendur nuk e ndihmoi shëndetin e tij.

Orwell kishte kërkuar që të varrosej në përputhje me ritin anglikan në varrezat e kishës më të afërt, kudo, që të vdiste. Varrezat në Londër nuk kishin hapësirë. E veja e tij u bëri thirrje miqve të tij për të parë nëse ndonjëri prej tyre dinte ndonjë kishë me hapësirë në varrezat e saj. David Astor jetonte në Sutton Courtenay, Berkshire; organizoi që Orwell të varrosej në oborrin e kishës së Gjithë Shenjtorëve. Guri i varrit të Orwell mban epitafin: "Këtu qëndron Eric Arthur Blair, lindur më 25 qershor 1903. Vdiq më 21 janar 1950. Në gurin e varrit nuk përmendet emri i tij i famshëm.

Disa vlerësime për veprat e Orwell-it. - Historiani John Rodden e quajti atë një "ikonë kulturore"; - Ben Wattenberg deklaroi: "Shkrimi i Orwell-it shpo hipokrizinë intelektuale kudo që e gjente"; Sipas historianit Piers Brendon: "Orwell ishte shenjtori i mirësjelljes së zakonshme...", etj.



Orwell ofron gjashtë rregulla për shkrimtarët: - Asnjëherë mos përdorni një metaforë, shëmbëlltyrë ose figura të tjera të të folurit, që jeni mësuar t'i shihni në shtyp.; - Asnjëherë mos përdorni një fjalë të gjatë, një fjalë të shkurtër është më e mirë.; - Nëse është e mundur të ndash një fjalë, fshije gjithmonë atë.; - Asnjëherë mos përdorni pasivin, ku mund të përdorni aktivin.; - Asnjëherë mos përdorni një frazë të huaj, një fjalë shkencore ose një fjalë zhargon, nëse mund të mendoni për një ekuivalent të përditshëm në anglisht (shënim: ose në gjuhën tuaj).; - Thyeni ndonjë nga këto rregulla më shpejt se sa të thoni ndonjë gjë të plotë barbare. Orwell mund të ketë qenë i pari që përdori termin "luftë e ftohtë" për t'iu referuar gjendjes së tensionit midis fuqive në Bllokun Perëndimor dhe atë Lindor që pasoi Luftën e Dytë Botërore në esenë e tij "Ti dhe bomba atomike", botuar në "Tribuna", më 19 tetor 1945.

## Botime: "Vargnim Gjakove"

# MOZAIK I BUKUR INDIVIDUALITETESH LETRARE

**Një nga aspektet më të rëndësishme të "Vargnim Gjakove" është pasqyrimi i diversitetit të autorëve që kanë kontribuar në kulturën letrare të qytetit. Libri përfshin 100 poetë, paraprirë nga disa poezi të përfaqësuesve fetarë, që dëshmojnë për lëvrimin e artit të krijimit të vargjeve në shekuj më parë**

### Musa KURHASKU

Trashëgimia kulturore e një qyteti nuk matet vetëm nga monumentet e tij, por edhe nga librat që dokumentojnë historinë dhe kulturën e atij vend. "Vargnim Gjakove" nga Migena Arllati është një thesar i tillë, që i jep jetë historisë letrare të qytetit të Gjakovës dhe kontributit të shkrimtarëve të tij. Ky libër nuk është thjesht një përmbledhje biografike, por një sofër e madhe për një shekull letërsi dhe kulturë që përfaqëson një pjesë të rëndësishme të identitetit shqiptar. Rëndësia historike dhe letrare e titulluar aq artistikisht: "Vargnim Gjakove" ka një rëndësi të jashtëzakonshme historike dhe letrare, duke përshkruar periudha sfiduese për kulturën shqiptare, veçanërisht në Kosovë. Libri dokumenton përpjekjet e shkrimtarëve të Gjakovës, të cilët, që nga shekujt e mëhershëm, u përballën me sfida të mëdha për të ndërtuar dhe ruajtur një platformë kulturore të qëndrueshme. Sidomos nga dekadat e vështira të shekullit XX, në kushtet e represionit politik dhe të censurës, letërsia nuk ishte vetëm mjet artistik, por një formë rezistence kulturore. Veprimtarët/shkrimtarët e Gjakovës përdorën fuqinë e fjalës për të sfiduar padrejtësitë dhe për të frymëzuar brezat e ardhshëm. Ky libër na kujton se letërsia ishte dhe mbetet një formë e fuqishme për të ruajtur gjuhën, identitetin dhe lirinë e kombit.

### Diversiteti i shkrimtarëve

Një nga aspektet më të rëndësishme të "Vargnim Gjakove" është pasqyrimi i diversitetit të autorëve që kanë kontribuar në kulturën letrare të qytetit. Libri përfshin 100 poetë (që përveç poetë janë edhe shkrimtarë ose prozatorë, dramaturgë, eseistë deri te kritikë letrarë), paraprirë nga disa poezi të përfaqësuesve fetarë, që dëshmojnë për lëvrimin e artit të krijimit të vargjeve në shekuj më parë. Secili prej tyre sjell një zë të veçantë dhe një stil unik, duke pasuruar më tej letërsinë shqiptare. Vihet re si një gjetje e rrallë përfshirja në paragrafë të figurave të disa klerikëve, myderrizëve e shenjtores, në këtë rast Nëna Terezë, e cila përveç si humaniste e madhe paraqitet edhe si një poete e mëshirës dhe e humanizmit, me dashuri të pamatë për njerëzit, e po ashtu për atdheun e saj. Në libër prezantohen më tej poetët "rebelë" si:

Teki Dervishi që gjithmonë dhe në mënyrë të hapur është shprehur kundër sistemeve të atëhershme, Ali Musaj me vargun "shigjetues", por edhe Agim Mala, poet dhe politikan i moderuar, Besim Bokshi - studiues i thekur i indoeuropianishtes, Din Mehmeti - bacloku i poezisë, Halil Haxhosaj - i urti dhe punëtori i pafjalë, e shumë e shumë poetë të tjerë të brezave të ndryshëm, e deri te brezi më i ri i paraluftës ku spikasin poetë të rënë nën breshërinë e armëve: dëshmori Gaspër Karaqi dhe gjimnazistja Yllka Domi. Kjo tregon se prof. Arllati prezanton ruajtjen e frymës së vazhdimësisë në letërsinë gjakovare, ku të gjithë në tërësi dhe secili në veçanti, paraqiten si diversitet i reflektimit të pasurisë intelektuale të qytetit. E gjithë brendia e librit dëshmon jo thjesht për zhvillimin e artit të letërsisë nga autorët e Gjakovës por edhe për ndikimin që ngjarjet

historike kanë pasur në krijimtarinë e tyre. Nga poezitë me vlera të spikatura e me tematikë nga vendlindja dhe areali i saj, e deri te shkrimet filozofike, "Vargnim Gjakove" na tregon se letërsia e këtij qyteti është një mozaik i bukur idesh dhe stilesh.

### Sfida e të bërit art

Edhe pse Gjakova me shkrimtarë të shkëlqyer, që bënë letërsi dhe emër të bujshëm në të gjitha trevat shqipfolëse e ndonjë prej tyre deri në nivelet botërore, siç është rasti i Ali Podrimjes - poet me famë ndërkombëtare e i përkthyer në dhjetëra gjuhë, mungon vetëdija për të çmuar dhe vlerësuar sa duhet këtë pasuri të trashëguar, pasuri që madhështon emrin e Gjakovës përtej kufinjve të saj. Një nga propozimet më të rëndësishme që vjen nga kjo analizë është përfshirja

e krijimtarisë letrare të shkrimtarëve të Gjakovës në kurrikulat shkollore. "Vargnim Gjakove" dhe veprat e tjera të shkrimtarëve lokalë duhet të bëhen pjesë e programit mësimor në Gjakovë dhe më gjerë. Duke njohur veprat e këtyre autorëve, nxënësit jo vetëm që mësojnë për letërsinë, por edhe për historinë dhe kulturën e qytetit të tyre. Shumë nga ta ishin prijtarë në procese të rëndësishme për kohën, sikurse ishte Anton Çetta - prijës i procesit masovik të pajtimit të gjaqeve, Rexhep Hoxha - doajeni i letërsisë për fëmijë, Myrteza Xajë Nura - i kalitur në burgje për veprimtarinë e tij "irredentiste", Agim Gjakova - i dëbuar nga vendlindja etj., etj. Përfshirja e këtyre veprave në shkolla do të krijonte një ndjenjë krenarie dhe përkatësie tek të rinjtë, duke i lidhur ata më ngushtë me trashëgiminë tonë kulturore.

### Një thirrje për veprim

Autorja Arllati është kujdesur më së miri që kjo përmbledhje të jetë e një niveli të lartë jo vetëm si përmbajtje por edhe si formë artistike, dhe si e tillë është një realizim elitari. Dashuria e saj për artin dhe mirënjohja për krijimtarinë vendase, të rrahur në kohërat e veprimeve dhe pësimeve të vështira, dëshmojnë për shpirtin e saj të lartë fisnik e të paqtë. Librarsi "Vargnim Gjakove" nuk janë thjesht antologji letrare por pasuri kombëtare që duhet të ruhen dhe të promovohen me kujdes. Shoqëria dhe institucionet duhet të jenë më të përgjegjshme ndaj trashëgimisë kulturore duke vlerësuar përgatitjen dhe shpërndarjen e këtyre veprave. Do të ishte mjaft e arsyeshme që shkollat e mesme dhe filloret të përfshijnë një program të veçantë për njohjen e historisë dhe letërsisë vendore. Përmes këtyre programeve, brezat e rinj do të kenë mundësinë të mësojnë për autorët që kanë formuar identitetin kulturor të qytetit të tyre dhe të ndihen krenarë për trashëgiminë e tyre. Në përfundim, bëj thirrje që libra të tillë të mos mbeten vetëm në bibliotekat apo në dorën e lexuesve të veçantë, por të bëhen pjesë integrale e edukimit kulturor për të gjithë qytetarët e rinj. Ky veprim do të inkurajojë një rilindje kulturore në Gjakovë dhe do të nxisë të rinjtë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej traditën e tyre letrare dhe kulturore.

## Poezi

## LIRIKA ME BUISJE METAFORIKE

Arif Bozaxhi, "Prushi i gurit", poezi, botoi SHB "Lena Grafik", Prishtinë 2022.

## Sadik KRASNIQI

Poeti Arif Bozaxhiu vjen para lexuesve të vet me librin e tij më të ri, të dhjetin, me poezi, "Prushi i gurit". Katërdhjetë e tri poezitë e librit "Prushi i gurit" janë "shkreptima lirike" siç do t'i quante Arshi Pipa, që i shkojnë përshtati bukurisë së stilit eliptik të këtij autori. Introspektiviteti i tij ka një kreshento përndritëse me përmasa kozmogonike. Fantazia imagjinative e lirikës së tij transcendencohet përmes një figurativiteti poetik me një unikaliteti idiomatik. Struktura vargore e këtij libri është ndërtuar në variantin e gnomës sentenciale. Dendësia kuptimore e këtyre poezive, me pak fjalë e vargje, ka tiparin e haikut. Figurshmëria e poetikës së librit "Prushi i gurit" bëhet përmes kontrastivës metaforike gjegjësisht oksimoronit metaforik. Te ky libër, vetë titujt janë simbole me intencë të shndërrimit të tyre në konstruktë të ligjërit metaforik. Krahas titujve të emëruar me simbole si milingona, fryma, dallëndyshja, flutura, kemi edhe titujt me sintagmave metaforike si: prushi i gurit, biblioteka yjesh, shehi i yjeve, dielli peshon kaltërsi, qielli i rinisë, planeti i dashurisë, xhelozia e peshqve etj. Arif Bozaxhiu poetikën e ligjërit lirik e ndërton nga simboli si titull duke e përzgjeruar në sentencë të thukët si tekst metaforik, metonimik e oksimorik si p.sh.

## Milingona

*Një milingonë erdhi te syri im  
ec më tha  
se liria është një greminë e fshehur  
pas diellit (f. 21)*


Poetika e këtij libri është tërësi e një vistër metaforash të bukura si: prushi i gurit, biblioteka yjesh, ëndërr e zjarrtë, ëndërr e gjinkallës, kurmi i natës, arka e vetmisë, pesha e gurit, grusht hi, mallkim i heshtjes, puthje e fluturës, adresa e dallëndyshes, sheshi i yjeve, gjak i yjeve, puthja e diellit, xhelozia e peshqve etj. Këto metafora i shërbejnë tematikës, motivit e idesë të poetit për ta shfaqur ligjërimin e tij lirik. Lirikën e Arif Bizaxhiut e karakterizon insistimi në pulsimin e metaforave impulsive që shfaq interspektiven autoriale. Në këtë libër ka disa simbole dhe metafora të përndritur, si : diell, yjet, drita, kallje, prushi i gurit, ëndërr e zjarrtë, që heroit lirik i japin konturë të Prometeut mitik. Madje, edhe librin e fillon me në gjakim flijues, duke u djegur për liri:

## Prushi i gurit

*po digjem  
po digjem  
në prushin e gurit  
si zogu në ëndërrën e vet  
syçelë për liri (f. 5)*

Arif Bozaxhiu është mjeshtër i krijimit të abstraksioneve dhe absurditeteve imagjinative si poezia:

## Prrockë këngësh



## Në ëndërrën e gjinkallës

*Kënga u thur si rrytë merimange (f. 9)*

Por di të krijojë edhe imazhe vizuale që reflektojnë me një metaforë befusuese me nuance oksimoroni:

## Lejlelku

*Në lumin Majn  
një lejlek, pinte diellin! (f. 10)*

Si në të gjithë opusin lirik të këtij autori, edhe në këtë libër, gruas i këndohet me një pietet dhe adhurim. Gruaja e ka bukurinë e përsosmërisë fizike, dinjitetin e paprekshëm, është mitike e mistike si e tillë është një qenie kozmike e adhuruar deri në kult.

## Grua

*I vetmi planet  
Ku lulëzojnë yjet (f. 16)*

Në këtë lirikë gjejmë edhe një epifani të bukur në formë epitafi onirik:

## Ëdrra

*vetëm zogjtë  
mund të dinë  
peshën e gurit  
mbi varr (f.209)*

Arif Bizaxhiu shfaqe pikëpamje diskursive edhe për poezinë, përmes një imagjinate me elemente kozmike:

## Poezia

*Poezia është gjak  
i yjeve  
që e shtrydh  
për t'i bërë dritë  
imagjinatës (f.38)*

Poetika e Arif Bozaxhiut, ndërtohet përmes një stili të lartë deri në estetizëm, që këtë krijues e bënë të jetë poet precizoist. Poezia e tij lexohet gjithnjë e më vëmendshëm nga lexuesit që e duan dhe e çmojnë poezinë elitare. Arif Bozaxhiu me lirikën e tij të të veçantë të një identitet superior ka hyrë në orbitën e plejadës më të sukseseshme të poezisë shqipe e që po i kalon suazat e saj me përkthime të herëpashërme në gjuhë tjera. Edhe libri më i ri "Prushi i gurit" hynë në vazhden e librave me shenjë prurjeje në poezinë shqipe dhe që e gëzon lexuesin e poezisë së bukur.

## Poezi: Dori CAMAJ

**KISH DAL NJI HAN' \*\*\*  
E BUKUR**

Kish dal një Han' e bukur,  
drapën,  
e re, Mari...  
M'i muer syt'  
e natën,  
t'amël shtroi...  
Ja nisa me i fol për ty,  
për dertin tand,  
që flen n'mue...  
Lamsh u ba malli,  
e muer rrokullimë  
n'dy pika lot..  
Hana, për çudi  
m'u qesh,  
e m'ktheu faqen tjetër..  
E diti,  
se po i flet,  
një zemër  
e dashurueme....

\*\*\*

Prej se ty  
nuk t'pëlqen me m'pa mue  
tuj qendis,  
me gjilpan n'duer,  
un' krejt ojmet  
i treta,  
t'bardha,  
pa shkue n'to  
as një fill boje t'jetës.  
Prej se ty  
nuk t'pëlqen me m'përçaf,  
pa i pa t'derdhuna  
flok e mi n'supe,  
un' kurr një fjango  
mà n'krye  
s'e kam vnue..  
Prej se ty  
t'treti nata e ngrat'  
e pshtjellun n'gji t'saj je shkue,  
kurr një rreze s'mujti me e ça  
nj'at terr t'nântoks  
qi zemra shtroi n'mue...

E tash....  
Tash qendis,  
do fjango t'vjetra,  
me një diell midis,  
qi kurr s'ka me ba drit....

\*\*\*

Edhe Mjellmat qajnë...  
Mendova se pika që ra  
mbi fytirën e ngrirë të liqenit,  
rrodhi prej faqes sime,  
por jo!  
Ish Mjellma...  
Nuk di a kish ndjerë ndonjëherë  
klithmë zemre njeriu,  
ajo flet veç me Hënën...  
E kam kundruar gjatë,  
tek fshihet nën shelgje,  
e ndjek rrugën e qumshit të saj..  
Madje kam menduar  
se ashtu dhe dashuron,  
me Hënën mbi krye..  
Por sonte  
u ndal pranë meje,  
ashtu e bardhë,  
e paqtë,  
e brishtë,  
qafën gjysmëzemre harkuar..  
Sy më sy'  
buzëqeshje e mekur  
ndër lot,  
rrahu krahët,  
e mbi valë klithi...  
:-Hej, dhe un' kam dashuruar!..

Duhet të ikja...  
Dhe hëna atë natë  
kish lindur së prapthi.  
Nën këmbë,  
s'pluhroste udh',  
veç rridhnin djersë  
qiejsh febrilë,  
të pa zogj...  
Këmbishë e ngjyer,  
trupit lëpirë,  
si rëra,  
këmbëve zbathur brigjeve...  
S'shoh udh' sërishit,  
veç iki..  
E kurmet e pemëve,  
lidhën lëkurët e shprishura  
mendimeve të mija  
flokëgjatë...  
Pritmë botë,  
me një këpucë mbathur...  
se tjetra  
fle tek ai prag...

\*\*\*

Ç'muzg!...  
Mekur mbi degë  
që zhveshin lëkurë  
e nginjen rrëkeve...  
Një natë flokprishur,  
molepsur supesh,  
si alga  
bregtërbuara...  
Ç'njeri jam!  
Me kryqe që kërcasin  
si monedha të harruara  
diku,  
në ndonjë torbë kujtimesh...  
Ç'njeri!...  
I mbetur zbathur,  
me një grusht shpirt  
e dymbëdhjetë qindarka trishtim...  
Duhet të ketë një gabim...  
Diku mes numrash,  
ku data e lindjes  
e zezë qëndron mbi të bardhë...  
Jam krijesë e shiut  
se ndryshe  
nuk do vdisja në cdo pikë,  
në çdo gjethë që bie,  
në çdo simfoni,  
në çdo erë dheu  
që shiun përpin...  
Ç'muzg!...  
I pa veshur,  
cullak...  
E un',  
mbulohem  
me lëkurën  
time...

\*\*\*

Nji grrumbull gjethesh  
asht ky qytet...  
Nji përçafim n'gji  
t'ndaluem..  
Nji pëshprim e mekun  
n'vesh t'shurdhuem..  
Nji marak i dergjun  
n'sy t'plakun..  
Nji buzëqeshje e dliërë  
n'erna tretun..  
Nji rrug e emën  
njeriu t'panjohun..  
Nji got pa fun'  
e një shishje t'thyeme..  
Nji britëm vetmie  
me zá pa tingull...  
Nji shpi e madhe  
me dyer sa një bir...  
Nji tryezë e mbushun  
pa mysafir...

Nji dashni lumejsh  
qi detin s'e njohin..  
Nji virgjresh e motshme  
fmijësh prenin mblue...  
Nji trotuar si duna  
hapash shtrue..  
Nji dhimbje qi shekujsh  
s'tmyt,  
e errsinës,  
t'len me lëngue...

Un'...  
Nji gjethe ma shum'..  
Nji gram frym...  
Nji xham i thyem...  
Nji dekek jet'  
e viteve t'mia...

\*\*\*

Ti njejt ke më fjet,  
midis stinësh  
mblue e shplue,  
e nân jestek  
dora i zen frymën andrrës..  
Dritaren pllamb hapun,  
sall për me ndie  
fletët që nisen n'shtegtim,  
nji gjinkall që këndon,  
tokën,  
ka shuan etjen n'litar t'shiut,  
a borën,  
që hapat i qet  
sikur nuset fustanbardha...  
Njejt ke me fjet,  
tuj randue mbi zemër,  
për mos me ja ndie britmën,  
prej se gjysmake asht mbet...  
Njejt ka me fjet dhe ora,  
e sa her' që syt' ke me i çel,  
gjith' ka me qen' aq'..  
Aq sa për me t'kujtue,  
se duhet me u kthye n'krah tjetër,  
për me t'u ngroh ftyra  
n'frym tik -takesh,  
që zemra...  
veç zemra,  
din me e kurdis...



*Conceição Lima, poete nga të São Tomé dhe Príncipe*

# ASNJË ZOT NUK JETON KËTU

**Lima i përket linjës së shquar të poetëve dhe intelektualëve afrikanë që luftuan kundër kolonializmit dhe për pavarësinë e vendeve të tyre**

Conceição Lima u lind në vitin 1961, në São Tomé, ishulli më i madh që përfshin kombin e vogël afrikan perëndimor të São Tomé dhe Príncipe. Ajo studioi në Lisbonë dhe në Londër, ku gjithashtu punoi për shumë vite si gazetare dhe producente për BBC-në. Pas kthimit në vendin e saj, ajo ishte një nga themelueset e Unionit Kombëtar të Shkrimtarëve dhe Artistëve Santomean dhe vazhdoi të punonte si gazetare duke shkruar dhe botuar poezi. Sot, Lima është poetja më e rëndësishme santomeane e brezit të saj dhe një nga shkrimtarët më të rëndësishëm bashkëkohorë nga vendet afrikane ku portugalishtja është gjuhë zyrtare. Deri më sot, Lima ka botuar katër përmbledhje me poezi dhe një me kronika - tregime të shkurtra, jofiktive. Librat e saj janë përkthyer në gjermanisht, italisht dhe spanjisht dhe ajo ka marrë pjesë në antologji të shumta në vendin e vet, në Portugali, Brazil dhe Mbretërinë e Bashkuar. Në SHBA, disa nga poezitë e Lima-s janë shfaqur me "Fjalët pa kufij" dhe "Afro-ishullimi" i saj, përkthyer nga Shook, ishte një nga dy fituesit e konkursit 'Poems in Translation' (poezitë në përkthim) 2021, bashkë-sponsorizuar nga WWB dhe Akademia e Poetëve Amerikanë. Megjithatë, Lima është ende kryesisht e panjohur në Shtetet e Bashkuara, por ky botim dygjuhësh i kuruar me kujdes, i përkthyer bukur, sigurisht që do të ndihmojë në sjelljen e veprës së saj për një lexues më të gjerë. Vëllimi "Asnjë Zot nuk jeton këtu" përfshin poezi nga të gjithë librat e autores, të paraqitur në mënyrë kronologjike dhe të ndjekur nga një

përzgjedhje e poezive të fundit. Kështu, lexuesi mund të vlerësojë evolucionin e zërit të saj poetik, si dhe disa tema dhe imazhe të dallueshme të përsëritura. Veçanërisht, një dashuri e thellë dhe e fortë për vendin e saj, informon poezinë e Limës dhe poezitë e saj mund të lexohen si një seri këngësh lavdërimi për gjeografinë, historinë dhe kulturën santomeane. Shumë nga poezitë janë përpjekje për të kuptuar identitetin e kombit dhe për rrjedhojë, për të kuptuar veten e vet poetike, pasi ato janë të ndërthurura pazgjidhshmërisht. Nga poema e hapjes "Mëmëdheu", e tutje, São Tomé dhe Príncipe del si tema kryesore, duke u shfaqur jo si një nocion abstrakt, por si një personazh kryesor, një entitet i mishëruar, një dashnor ose edukator i humbur dhe gjithmonë i kërkuar:

*Dua të jem zgjuar  
nëse kthehem në gjirin e shtëpisë  
për të prekur gjysmën e ditës  
të mureve të saj për të rjetuar,  
në lëkurën e gishtave të mi,  
butësinë e ditëve nëntokësore,  
çaste të shkuara.*

...

*Dhe nëse pyes veten,  
është për të kuptuar ty  
rrjedhën e dhimbjes ujëvarë zemërimi  
që nga shiu zgjat  
dhe obô\* trishton në mesditë.*

...

*Një hap bazalti del nga deti  
dhe në vallen e hardhive  
unë rihy në tempullin e trupit tënd të*

*dashur...*

Lima i përket linjës së shquar të poetëve dhe intelektualëve afrikanë që luftuan kundër kolonializmit dhe për pavarësinë e vendeve të tyre, si Agostinho Neto, Mário de Andrade (të dy nga Angola) dhe Amílcar Cabral (Guinea-Bissau), për të cilët Lima shkroi poemë epike "Të gjitha vdekjet e Cabral dhe një mal". Dy poetë të shquar santomean ishin gjithashtu pjesë e atij grupi: Francisco José Tenreiro dhe Alda do Espírito Santo, të cilët Lima i vlerëson si një ndikim të drejtpërdrejtë në punën e saj. Ndërsa paraardhësit e saj shpesh shkruanin për betejat e vendeve të tyre për pavarësi, Lima ngjall në poezinë e saj zërat e tyre dhe të tjerë më të largët: ardhjen e kolonistëve, skllëvërve dhe të robëruarve; jeta e kaq shumë burrave dhe grave që vdiqën në plantacione dhe e atyre që luftuan kundër skllavërisë dhe fuqive koloniale - të gjithë ata "Heronj":

*Në bazën e sheshit nën shtizën e flamurit,  
eshtra të dukshme, të rënda, pulsuese.  
Zogjtë e panikuar lëshojnë boritë e tyre  
dhe statujat tërhiqen në heshtje drejt  
peizazheve të largëta.  
Të vdekurit që vdiqën pa pyetje  
kthehen ngadalë me sy hapur  
duke kërkuar krahët e tyre të kryqëzuar.*

Poezia e Limës rishikon (ripërshkruan) peizazhin santomean dhe të kaluarën e tij, por gjithashtu kremton pan-afrikanizmin, si në "Kënga e errët për rrënjët e mia", në të cilën ajo flet për "kushëririn e saj kokëfortë" Alex

[Haley] dhe për origjinën e tyre të largët. Së fundi, "izolimi" është një temë themelore në punën e saj, një lajtmotiv në letërsinë e Sao Tomé dhe Príncipe dhe të Kepit, jo vetëm për shkak të pozicionit të tyre gjeografik si kombe ishullore, por veçanërisht për shkak të historisë së tyre të shfrytëzimit dhe izolimit nga fuqitë koloniale, një gjendje e përshkruar në mënyrë elokuede në "Afro-ishullimi" e saj e vlerësuar me çmime.

Poezitë në këtë vëllim janë të mbushura me intensitet dhe mprehtësi, qofshin ato të shkurtra si "Arkipelag" ("Enigma është diçka tjetër - Asnjë Zot nuk jeton këtu / Vetëm njerëz dhe deti, trashëgimi e paluajtshme") ose poema epike të gjata, si "Kënga e errët e rrënjëve të mia" dhe të tjerë të përmendur më lart. Në përgjithësi, ata e vendosin autoren përkrah gjigantëve të poezisë botërore, si Pablo Neruda dhe Maya Angelou dhe kanë gjetur te Shook një përkthyes ideal, i aftë të ndërthurë delikatesën, respektin dhe kreativitetin që kërkon poezia e Limës. (Marrë nga: [www.worldliteraturetoday.org](http://www.worldliteraturetoday.org))

---

\* "Obô" është një shprehje e përdorur në disa kultura afrikane, veçanërisht në jorubisht, që do të thotë "mirëseardhje" ose "përhëndetje". Mund të përcjellë ngrohtësi dhe mikpritje.

(Solli në shqip: Fitim Nuhiu)



Tregim

# ASAJ MUSHKE I KISH DALË NAMI I KEQ

**Ramiz GJINI**

- Im shoq, do të më vrasë! - më pati thënë Zulma Bruneti.

I thashë që të ikte sa më parë të ishte e mundur. Të largohej për të mos u kthyer kurrë më pranë tij. Ajo heshti pak sekonda e përhumbur një qind copash, u mbush thellë me frymë, pastaj frymën që mori e nxori lot për sysh.

-Gjithsesi, ai prapë do të më vrasë, - tha, teksa fshinte lotët.

M'u dhimbs Zulma, ndaj ia ktheva: - Nëse është kështu, vrite ti, para se të të vrasë ai ty.

Këto qenë fjalët që unë dhe Zulma Bruneti, shkëmbyem gjatë atij takimi të shkurtër në një nga rrugët e fshatit. Kur ishim fëmijë dhe shkonim në shkollë, duke filluar nga klasa e parë, deri në të pestën, pata qenë ulur në një bangë me Zulmën. Pastaj, atë e hoqi nga shkolla i ati, një tip bjerraditësi ky; i papërgjegjshëm në gjithçka thoshte e bënte. E la Zulmën të kullose lopën dhe t'i ndihmonte së ëmës në punët e shtëpisë.

"Mjafton që tashmë, din të shkruash dhe mban mend tabelën e shumëzimit", i pati thënë ai. "Nuk të duhet për më shumë shkollë".

Po ajo, edhe pse i ati e hoqi nga shkolla, vazhdonte të lexonte ç't'i binte në dorë. Lexonte libra me poezi, romane dhe tregime që, në shumicën e herëve ia jepja unë, e që ajo m'i kthente, sepse ishin libra që i merrja në bibliotekën e shkollës.

Ditën që u takuam, Zulma po shkonte të lidhte mushkën me një litar të gjatë në arën e mbjellë me jonxhë, për të cilën, mbaj mend që tha, se i qe shpifur mitili i verdhë. Gjatë atij takimi, vura re që Zulma i kishte të thyer dhembët e parë dhe qe dobësuar shumë. Që nga ajo ditë, ende më kumbojnë në vesh fjalët që Zulma pati nxjerrë nga goja. Dhe, kurrë nuk do të më shqitet nga kujtesa, imazhi i syve të saj të bukur të mbushur me lot, ku pasqyrohej gjithë vuajtja e një shpirti gruaje shpresëhumbur.

Gjatë ditëve që pasuan pas atij takimi, nisa të vras mendjen dhe të kuptoja që i kisha dhënë Zulmës një këshillë të pavend. A

thua se nuk e njihja mirë Zulmën! Zulmën që u rrit nën tutelën prej despoti të të atit, i cili e martoi pa dëshirën e saj me Goci Kupecin, shumë vite më i madh se ajo. Ose më mirë të themi që Goci e kobiti të atin e saj. Ia bëri mendjen ujëm me rragatje fjalësh, derisa e bindi që ta këmbente Zulmën me tre dylm tokë që në fakt, nuk ishte e Gocit. I gjithë fshati e dinte që ajo tokë ishte e Pal Letit, i cili, ngase vetëm vraponte, kish pas qenë njohur si, "Pal Këmbëshpejti". Pali kishte braktisur shtëpi e tokë dhe ia kish mbathur për Amerikë qysh para shumë vitesh, ku qëndroi atje derisa u plak dhe shkoi te të shumtit.

Fundja, sido që të ishte historia e Zulmës me të shoqin, në një shtet ligjor, askush nuk ka tagër për të treguar me gisht, kush duhet të vrasë e cili duhet të vritet. Ndaj, vendosa ta takoja sërish Zulmën që t'i kërkoja të falur, sepse më vinte turp nga vetja për çfarë i pata thënë gjatë atij takimi. T'i thoja që, atë ditën kur i thashë të vriste të shoqin, isha nxituar nga dhembshuria që ndjeva për të dhe nga urrejtja që mu ngjall për Goci Kopecin; t'i thoja që duhej të bënte durim dhe t'i jepte vetes kohë për një zgjidhje më të mirë. Po nuk munda ta takoja dot, sepse ajo u mbyll brenda shtëpisë, ku e dëgjuan të qante për ditë të tëra; dhe u shfaq në sy të gjindjes vetëm pasi u hap fjala, se i vrau mushka të shoqin.

Gjithsesi, edhe pse në këtë histori hyri mushka e tyre e prapë, unë ende nuk jam çliruar nga ndjenja e fajit për atë çfarë i thashë Zulmës. Më përhitet para syve një skenë e llahtarshme, për të cilën, shpresoj të mos ketë ndodhur. E shikoj Zulmën se si, teksa mban sëpatën në duar, i ka zënë pritë të shoqit, pështetur për murit në errësirën brenda ahurit. Dhe, ndërsa ai futet aty me një krah jonxhë të thatë për mushkën, ajo i hov me tunin e sepatës në kokë me sa fuqi ka. Dhe Goci Kopeci shembet në tokë si një thes i madh lini i mbushur plot me të keqen e vet. Pastaj, përfytyrimi im vjen e shkimet, pasi kujtohem që, asaj mushke i kish dalë nami i keq qysh para katër vjetësh, kur

një ditë si gjithë të tjerat, teksa Goci po i vendoste samarin në shpinë, mushka e shkëlmoi fort në kraharor. Dhe ai përfundoi në spital, ku qëndroi dy javë, sepse sa herë merrte dhe nxirrte frymë, ndjente shumë dhimbje.

Kur doli nga spitali, Goci Kopeci vendosi ta shiste atë mushkë në pazar. Atë mushkë të rrallë për nga madhësia dhe forca për punë, por që nuk kishte ç'e donte, sepse ishte e prapë, e pabindur ndaj tij dhe e rrezikshme mu si një egërsirë. Sado të përpiquej Goci, ajo mushkë, nuk mund të zbutej e shtrohej për së mbari. Po Zulma bëri çmos që i shoqi të mos e shiste. I tha se nuk ia vliente të merrte mundimin për të shkuar kot në pazarin e gjësë së gjallë; kot, sepse ndodheshin në prag të dimrit; dhe se në atë stinë, askush nuk do t'i jepte çmimin që ai donte.

"Kush na qenka ai që blen me çmim të shtrenjtë një kafshë samari, për ta mbajtur e ushqyer pesë muaj, nga dhjetori në prill, pa i bërë të zotit asnjë punë?!", i pati thënë Zulma.

Prandaj, ajo i tha që, ishte më mirë të priste stinën e verës, kur t'ia behnin aty ciganët dhe të ngrehnin çadrat te Rrafshja e urithëve, ku gjendej edhe një burim me ujë të pakët. Në fakt, ky burim nuk bënte për të pirë, sepse i vinte era e brakës që ndodhej në rrafshnaltën sipër; ama rriste dhe mbante gjallë shelgjishten që zgjatej përposhtë gjer në përrua. Me thuprat e këtyre shelgjeve, ata thurnin shporta në pishë të vapës, mbushnin krahët dhe bridhnin për t'i shitur katundeve, duke thirrur e trokitur derë më derë. Edhe ujit të burimit që binte erë brakë, ata ia kishin gjetur anën si ta pinin: Ia hidhnin dhallit që lypnin gratë katundeve dhe, kësisoj, i humbiste ajo tashmë e rendë.

"Vetëm ciganët janë aq të zotët sa ta zbusin e shtrojnë për së mbari mushkën tonë", i pati thënë Zulma. "Edhe nëse nuk ta blejnë me çmimin që don ti, mund ta bësh tramkë me ndonjë kalë të urtë; sepse kali do të na duhet për të punuar tokat".

Kështu i foli asokohe Zulma të shoqit, të cilin, ç'është e vërteta,

për shumë arsye që ajo grua e marrshme mu si një çupëlinë gjithmonë i fshihte, nuk donte ta shihte të shoqin gjallë. Tani, që Goci Kopeci vdiq i goditur, siç u tha, nga shkëlmi i mushkës, më bëhet sikur ajo përpjekja e Zulmës për të mos e shitur mushkën deri në behar, bie erë. Ndaj, në përfytyrimin tim, i kthehem sërish asaj skenës së krimit, ku Zulma, pasi e godet të shoqin me tunin e sepatës pas koke, ai shembet menjëherë kruspull; pastaj, shtrihet në shpinë ku e mbërthejnë konvulsionet me shkulma të shkumbueshme që i dalin prej goje. Trupi nis t'i dridhet, t'i tundet e shkundet me shpinën për toke, si të donte të gërryente për të hapur me shpatulla varrin e vet. Sëfundi, si tendoset një herë fort për të nxjerrë nga hunda gjakun e shprishur, Goci Kopeci rehatohet që të bëjë gjumin e madh. Pasi bindet që Goci kishte vdekur, Zulmës i bëhet sikur do të vdesë edhe vetë. Sikur do të vdesë, pikërisht, nga goditja që i dha të shoqit; ndaj instinktivisht, e trembur nga vetvetja, ajo e hedh sëpatën. Pastaj, kthehet e nis të dalë jashtë duke çapitur anamendas, pa ditur se ku duhet të shkojë. Befas, te pragu i derës së ahurit, dëgjon t'i flasë zëri i të shoqit. Atëherë, kthehet dhe shikon e llahtarisur se si, pranë kufomës, qëndron në këmbë hija e gjallë e të vdekurit. Teksa shkund me duar pluhurin e mëkateve, hija i kujton Zulmës se duhet të marrë sëpatën që ajo pati hedhur në tokë menjëherë pas vrasjes. I thotë ta çojë e ta vendosë diku, nën strehëzën rrëzë murit të avllisë, pranë turrës së druve, ku e mbanin gjithnjë.

"Duke filluar prej sot, do të të duhet t'i presësh e çash vetë drutë e zjarrit", i thotë hija e Gocit.

Zulma kapet gafil nga kjo harresë e saj në lidhje me sëpatën. Ajo e din mirë që, nëse ia gjenin pranë kufomës, do t'i sillte një pasojë fatale. Ndaj, merr sëpatën, shkon dhe e lë nën strehëzën pranë murit të avllisë dhe kthehet sërish në ahur për t'u siguruar që, ajo hije, nuk kish qenë tjetër, veçse një fanitje. Dhe ndjehet disi e lehtësuar kur gjen aty brenda ahurit vetëm kufomën e të shoqit. Në mungesë

të hijes, tashmë kufoma nuk i ngjall asnjë frikë, asnjë keqardhje dhe asnjë pendim për çfarë ka bërë. "Pra, ajo hije, paskësh qenë veçse një fanitje", thotë me vete ajo.

Por, në përhitjen time, ndodh që Zulma Bruneti, përballet sërish me të, teksa po hynte brenda në shtëpi, ndërsa hija e të shoqit po dilte me një torbë të mbushur plot me të zezen e vetë hedhur kurrizit. "Po dal një shëtitje kodrinave, sepse pashë që edhe hëna doli", - i thotë Zulmës. - "Jam kurioz të di, çfarë do të më thotë për vdekjen që më ndodhi, pëshpërimita e fierit të thatë që dridhet nga era kodrinave të zhveshura! Gjithashtu, më është ndezur një dëshirë e madhe që të provoj të pres në grusht yllin tim kur të bjerë nga qielli".

Ia thotë i qetë e pa pezëm këto fjalë Goci; pa atë përsheqjen që në të gjallë i shfaqej në fytyrë, sa herë i fliste Zulmës. "Mbathja nga të duash"! - ia kthen ajo pa e vështruar. "Për pesë vjet martesë, që në fakt nuk ishte e tillë, veçse ke nguc për të bërë kapicë të zezen tënde. Të zezen që tani po e merr me vete". "Unë nuk t'u qava!" - thotë hija e gjallë e të shoqit të saj të vdekur.

Dhe vërtet, përse t'i qajë?! Tashmë, Zulma e kishte zhveshur, jo vetëm nga detyrimet që pati në këtë jetë, - që ai gjithnjë kërkonte t'u shmangej, - por edhe nga ajo peshë mëkatesh që e truste për ta zhytur çdo ditë e më shumë në një grope të thellë. Për ta zhytur në gropën ku varrmihësi Drago Petani, bashkë me ndihmësin e tij, do të nisin t'ia hapin nesër, me të zbardhur dita e re. Do të kishte qenë më mirë, sikur Zulma, të bënte që Gocit, t'i pushonte zemra para se ai t'i thyente asaj dhëmbët me sqepar; para se t'i shponte me cfurk mollaqet e t'i digjte gjinjte me cigaren e ndezur për çdo herë që, përkundër dëshirës së saj, i lëshohej si një predator duke e ndjekur nëpër shtëpi. Pastaj e kapte dhe ia zhvishte me forcë të gjitha rrobat; e shtrinte cullak përtokë kudo që të gjendej; dhe, duke i lëshuar në fytyrë atë hukamën e tij kutërbuese, ia bënte atë punë me një epush e kënaqësi prej sadisti. "Ti nuk pate fare zemër që të rrihte në kraharor", i thotë Zulma Bruneti. - "Gjakun tënd e pomponte urrejtja. Vdiqe, sepse të rrodhën e t'u sosën ditët".

Hija nuk flet. Ndoshta, hijeve të botës ku Goci tashmë, sapo ka hyrë, nuk u vlejné mendimet, fjalët jo e jo. Ndaj Zulma e shikon se si nis e largohet ngadalë nëpër natë si një fjollë e vetmueme mjegulle, duke çapitur nën dritën e zbehtë të hënës, drejt kodrave të zhveshura nga pemët, ku do të dëgjojë t'i pëshpërisë në vesh fieri i thatë që e rrëqeth era. Largohet e largohet, duke mbajtur me një dorë thesin mbushur plot me të zezen e vetë që ka hedhur kurrizit; dhe duke tërhequr zhakthi me dorën tjetër fjalët që i tha Zulma. Pastaj, më përhitet dita e nesërme. Dita kur kasapi Ndue Shtoj, sipas një tradite të mefshtë, para se ta



varrosin, i çan kufomës barkun me thikën që ai përdorte për të therur derrat, sepse ia don puna që t'i heqë rropullitë e barkut. Dhe, për çudinë e tij, brenda zgafellës së kraharorit të Goci Kopecit, në vend të zembrës, ai gjen diçka që ngjan si një thithlopë e rrumbullt, e mbushur plot me gjak të zi.

Kur gjindja mblidhet për ta varrosur, nisin hickëlitjet vesh me vesh e hundë për hundë, derisa hedhin mbi të vdekurin lopatat e fundit të dheut. Pastaj largohen në heshtje secili në punë të vetë, duke varur gjatë ecjes gardheve të oborreve aty-këtu, ndonjë pikëpyetje si dekor.

Pas shumë vitesh i larguar nga fshati, rastisi të kthehesha e të takohesha sërish me Zulmën. I kishte pas vdekur i ati nga një sëmundje e rëndë; dhe ajo, qe kthyer në shtëpinë e prindërve që të kujdesej për nënën e saj, tashmë e shtyrë në mote. U gëzova shumë kur pashë që kishte ndryshuar për mirë. Nuk ishte më ajo Zulma që pati qenë më parë. Kishte rregulluar dhëmbët që i pati të thyer dhe i qe rikthyer sërish ajo buzëqeshja e saj e ëmbël, që të grishte për t'i qëndruar pranë. Veç kësaj, qe veshur plot sqimë, me rroba të bukura që i kishin hije. Kishte marrë pamjen e atyre

grave dukane që, ndonëse jeta i ka përplasur me plot andrralla, i vuajtje e mundime, fakti që kanë tipare të këndshme dhe jetë të qetë, i bën të ndjehen në fill të mirë. Sapo më hodhi sytë u çel në fytyrë. U përqaftua dhe u kapëm për duarsh kyç më kyç si të ishëm për duarsh kyç më kyç si të ishëm vëlla e motër. Teksa më fliste e më vështronte e qeshur e gjithë mirënjohje, ia ndjeja me gishta pulsën që i rrihte për çdo sekondë në kyçet e duarve. Pulsin e Zulmës, me rrahje të forta si trokthi i shtruar i mushkës që ajo kurrë s'e shiti.

## Film

# “BRAVEHEART”, NJË LUFTË E PËRGJAKSHME PËR LIRI

**Mel Gibson fitoi pikët maksimale si aktor e regjisor, duke interpretuar Zemërtrimin skocez Uilliam Uolles. “Braveheart” i prodhuar në vitin 1995, është një epikë historike e drejtuar dhe e interpretuar nga Mel Gibson. Ndërkohë ky, i mbushur me luftime, vrasje e gjak, u kthye në një nga filmat më të njohur të viteve ‘90, që ka lënë gjurmë të thella në kinematografinë botërore...**

## Leonard VEIZI

Nuk dihet shumë për Uilliam Uolles, i njohur si Braveheart apo Zemërtrimi, përveç se sipas një poeme të vjetër epike, ai bashkoi klanet e Skocisë dhe fitoi beteja të famshme kundër anglezëve përpara se të kapej, torturohej dhe ekzekutohej si tradhtar.

Filmi, i frymëzuar nga një poemë epike gati 12,000 rreshtash për Uilliam Uolles-in nga Harri Menstrëll dhe i filmuar kryesisht në Irlandë, shkaktoi një rritje të interesit për historinë skoceze, megjithëse u tha se përmbante pasaktësi dhe anakronizma të shumta historike. Kritikët vlerësuan veçanërisht skenat e betejës me skena masive dhe ekstravagante të dhunshme.

## Filmi

Kinematografia është një nga arritjet kryesore të filmit. Filmimet e peizazheve skoceze janë të mrekullueshme dhe i japin filmave një ndjesi madhështie. Luftimet janë të përshkruara me detaje të sakta, të dhunshme dhe intensive, që përforcojnë atmosferën brutale të kohës. Mel Gibson në rolin e Uilliam Uolles -it paraqet një figurë të vendosur dhe pasionante, duke ofruar një performancë të fuqishme emocionale që ka tërhequr shumë shikues. Personazhi i tij përshkruhet si një lider që mishëron shpirtin e lirisë, një burrë me ideale të forta që është i gatshëm të sakrifikojë gjithçka për kauzën e tij.

Ndërsa Braveheart bazohet në ngjarje të vërteta historike, ai ka marrë shumë kritika për pasaktësitë historike. Në film ka elemente të ngjarjeve dhe personazheve që janë ndryshuar ose shtuar për qëllime dramatike, si për shembull përfshirja e romancës së Uolles -it me princeshën Isabelle. Gjithsesi, këto ndryshime janë bërë për të theksuar aspektin dramatik dhe për të shtuar emocionin e tregimit, duke krijuar një heroizëm epik që rezonon me audiencën.

Një nga temat kryesore është lufta për lirinë, një dëshirë universale që prek çdo shikues. Në të njëjtën kohë, filmi eksploron sakrificën dhe pasojat e luftës, si dhe idenë e të qëndruarit besnik ndaj parimeve edhe përballë vdekjes.

## Vlerësimi

“Braveheart” është nderuar me çmime të rëndësishme, përfshirë çmimin “Oscar” për Filmin më të Mirë dhe Regjinë më të Mirë. Pavarësisht kritikave për pasaktësitë historike, ai vazhdon të vlerësohet si një film epik i fuqishëm që paraqet një histori



inspiruese dhe vizualisht tërheqëse. Në fund, “Braveheart” qëndron si një film që, përmes forcës dhe ndikimit të tij vizual dhe emocional, na kujton rëndësinë e lirisë dhe guximit për të sfiduar padrejtësitë.

## Ngjarja

Filmi tregon historinë e skocezit Uilliam Uolles -it, një kalorës që udhëhoqi rebelimin kundër pushtimit anglez në shekullin e 13-të. Ky film përmban elemente dramatike, aksion dhe romantizëm të ndërthurura në mënyrë epike për të krijuar një rrëfim emocionues mbi lirinë dhe sakrificën. Në 1280, Eduard I i Anglisë, i njohur si “Longshanks”, pushton Skocinë pas vdekjes së mbretit skocez, i cili nuk la trashëgimtar. I riu skocez Uilliam Uolles është dëshmitar i pasojave të ekzekutimit të disa fisnikëve skocezë nga Longshanks, më pas humb babanë dhe vëllanë e tij kur ata i rezistojnë anglezëve. Pasi babai dhe vëllai i Uilliam Uolles vriten në betejë

kundër anglezëve, Uolles dërgohet në Evropën kontinentale për t’u arsimuar. Ai rritet nga xhaxhai i tij, Agajll. Uilliam Uolles kthehet në Skoci si i rritur - i cili interpretohet nga Mel Gibson - dhe martohet me të dashurën e fëmijërisë, Murron - që interpretohet nga Kathrin MekKormak. Kur ushtarët anglezë përpiqen të përdhunojnë Murron, Uolles e shpëton atë, por ushtarët bëjnë një përpjekje të dytë dhe ajo kapet dhe ekzekutohet. Uolles pastaj drejton klanin e tij në masakrën e garnizonit anglez dhe ai vazhdon të luftojë për të dëbuar anglezët nga Skocia, duke fituar një numër gjithnjë e më të madh ndjekësish ndërsa historitë e bëmave të tij përhapen. Ai drejton radhët e tij të pakta drejt fitores në Betejën e Urës së Stirling, dhe më pas ai pushton Anglinë dhe pushton qytetin e Jorkut. Mbreti anglez Eduard Longshanks - që në film interpretohet nga Patrik MekGohan - dërgon Princeshën Isabele, gruan e djalit të tij, për të

negociuar paqen me Uolles, por ajo magjepset prej tij dhe bëhet aleate e tij. Ajo paralajmëron Uolles për një pushtim të afërt anglez. Uolles kërkon mbështetjen e fisnikërisë skoceze në luftën kundër anglezëve, por fisnikët hezitojnë.

Luftëtarët skocezë shtypen nga një ushtri e udhëhequr nga mbreti Eduard në Betejën e Falkirk, pasi anëtarët e fisnikërisë skoceze tradhetojnë Uolles. Uolles i kalon disa vitet e ardhshme duke u angazhuar në luftën guerile kundër anglezëve. Ai më vonë pranon të takohet me pretendentin për fronin e Skocisë, Roberti Brus në Edinburg, por Robert dhe fisnikët e tjerë e kapin Uolles-in në kurth. Në ekzekutimit të tij të gjatë dhe të mundimshëm, Uolles refuzon të nënshtrohet për të fituar mëshirë dhe në vend të kësaj thërret në mënyrë sfiduese, “Liri!” Në 1314, Roberti, tani mbreti i Skocisë, përballet me anglezët në Banekbërn dhe u lutet njerëzve të tij që të luftojnë me të siç bënë me Uolles. Në një epilog, Robert Brus udhëheq skocezët drejt fitores ndaj anglezëve në Betejën e Banekbërn.

## Historia

Në historinë britanike thuhet se ka disa dëshmi se Uolles shkoi në Francë në vitin 1299 dhe më pas u kthye në Skoci për të vepruar si një udhëheqës i vetmuar gueril, por nga vjeshta e 1299 asgjë nuk dihet për aktivitetet e tij për më shumë se katër vjet. Kryengritja që ai kishte udhëhequr vazhdoi megjithatë deri në vitin 1304, në të cilën pikë shumica e fisnikëve skocezë iu nënshtuan Eduardit. Se sa kjo rezistencë e vazhdueshme ishte për shkak të ndikimit të Uolles është e pasigurt, por Uolles ishte i vetmi lider të cilit Eduardi nuk do t’i ofronte kurrë asnjë kusht kapitullimi dhe të cilin ai u përpoq me këmbëngulje ta kapte. Më 5 gusht 1305, Uolles u arrestua pranë Glasgout nga Sir Xhon Menteith dhe, sipas dy kronikanëve të hershëm, nga tradhtia. Ai u dërgua në Kështjellën Dumbarton dhe më pas në Londër, pasi ndoshta e sollën para mbretit Eduard gjatë rrugës. Më 23 gusht 1305, Uolles u dërgua në sallën “Westminster”, ku u padit dhe u dënua me vdekje. Nuk pati gjyq sepse u shpall tradhtar i mbretit; Uolles e mohoi prerazi këtë akuzë, pasi ai kurrë nuk ishte betuar për besnikëri ndaj Eduardit. Po atë ditë ai u var, u hoq nga zorrët dhe më në fund iu pre koka dhe u nda në Smithfield. Koka e tij ishte vendosur në Urën e Londrës dhe gjymtyrët e tij u ekspozuan në Njukasëll, Berik, Stërlling dhe Perth. Në 1306 Bruce ngriti rebelimin që përfundimisht fitoi pavarësinë për Skocinë.



NUMRI I ARDHSHËM MË 30 NËNTOR

# HEJZA

15 Nëntor 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala - Shala & Rexhepi**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000